


Studim për Qasjen në Drejtësi në Shqipëri



STUDIM PËR QASJEN
NË DREJTËSI NË
SHQIPËRI

Autorët

Dr Stefanie Lemke

Besmir Gjokuta

Erion Fejzulla

Elira Jorgoni

Prof. Asoc. Dr. Nadia Rusi

Ekipi kërkimor dhe kontribuesit

Instrumentet kërkimore u hartuan nga Dr. Stefanie Lemke dhe Besmir Gjokuta.

Puna kërkimore cilësore është mbikëqyrur nga Entela Lako dhe Vilma Çobani dhe është kryer

nga Erion Fejzulla, Besmir Gjokuta, Elira Jorgoni dhe Prof. Asoc. Dr. Nadia Rusi.

Puna kërkimore sasiore është mbikëqyrur nga Dr. Stefanie Lemke dhe Besmir Gjokuta dhe është kryer nga një ekip i përkushtuar intervistuesish dhe mbikëqyrësish vendorë nga Universiteti “Marin Barleti” (UMB) dhe “Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike” (AIPA), përfshirë Arishela Abdi, Irisi Asa, Enxhi Bilali, Kostandina Bile, Entela Bitri, Glerisa Çika, Melisa Dushku, Frida Gjonaj, Xhejzi Harizi, Mariana Lleshi, Mei Loci, Naim Meçalla, Dejzi Muskaj, Denada Peca, Noemi Pjetra, Danjel Qafoku, Klevisa Salla, Flutura Shabani, Eryjola Osmani, Adhurim Shyti, Lisana Subashi dhe Klejdi Toska.

Falënderime

Falënderojmë partnerët e UNDP-së në Shqipëri, Andia Dragoj (Ministria e Drejtësisë), Ergys Qirici (Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas), Klejda Poçi, Patricia Pogace dhe Suela Qevani (Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas), Rezarta Abdiu (Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë), Matilda Fetau (Gjykata e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Elbasan), Brunilda Kadi dhe Donald Xhelili (Gjykata e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë), Engert Pëllumbi (Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar), Erinda Ballanca (Avokate e Popullit), Robert Gajda (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi), Aurela Bozo dhe Klea Cahani (Qendra për Nisma Ligjore Qytetare), Franc Terihati (Qendra për Fuqizim Ligjor), Denada Selimi dhe Klaudina Kuci (Shoqëria e Ndihmës Juridike Tiranë), Mariana Meshi (Të Ndryshëm dhe të Barabartë) dhe Mirela Arqimandriti (Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim) për kontributin e tyre në hartimin e këtij raporti.

Dëshirojmë të falënderojmë edhe të gjithë të intervistuarit e anketës sasiore dhe pjesëmarrësit në studim të cilët na kushtuan kohën e tyre duke marrë pjesë në këtë studim.

Heqje dorë nga përgjegjësia

Ky studim u hartua si pjesë e projektit “Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” që zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri dhe u financua nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë vetëm të autorëve dhe kontribuesve të tij dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim apo donatorit dhe partnerëve të tij.

Design & Illustrime

HL Banding

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesat	7
------------	---

Përmbledhje ekzekutive	9
------------------------	---

PJESA I: HYRJE	14
----------------	----

A. Qëllimi i raportit	16
-----------------------	----

B. Metodologjia	17
1. Instrumentet e kërkimit	17
1.1 Anketa e familjeve	17
1.1.1 Përmasa dhe procedura e kampionit	18
1.1.2 Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave	18
1.2 Sondazhi përmes internetit	19
1.3 Intervistat me Persona Kyç	19
1.4 Diskutimet në Grupe Fokusi	20
2. Sigurimi i cilësisë	20
3. Konsiderata etike	21
3.1 Barazia gjinore	21
3.2 Miratimi i informuar	22
3.3 Mbrojtja e të dhënave	22
3.4 Kompensimi	22
3.5 Pilotimi	22

C. Konteksti	23
1. Rëndësia e qasjes në drejtësi	23
2. Detyrimet ndërkombëtare	23
3. Situata aktuale e ofrimit të ndihmës juridike në Shqipëri	25
3.1 Administrimi dhe organizimi i ndihmës juridike	25
3.2 Procesi i aplikimit për ndihmë juridike	26
3.3 Sfidat në sistemin e NJF-së	27

PJESA II: REZULTATET E FAZËS KËRKIMORE SASIORE	30
--	----

A. Anketa e Familjeve	32
1. Përbërja e kampionit	33
2. Botëkuptimi dhe perceptimet për ndihmën juridike dhe sistemin e drejtësisë	39

3. Përvoja me sistemin e drejtësisë	46
4. Përfundimet kyçe nga anketa e familjeve	58
B. Sondazhi përmes Internetit	59
1. Përbërja e kampionit	59
2. Ndihma juridike parësore	61
3. Ndihma juridike dytësore	74
4. Përfundimet kyçe nga sondazhi përmes internetit	79
PJESA III: REZULTATET E FAZËS SË STUDIMIT CILËSOR	82
3.1 Qasja dhe pengesat	84
3.1.1 Pengesat që hasin përfituesit kur i qasen ndihmës juridike	84
3.1.2 Pengesa të tjera të sistemit	86
3.1.3 Vështirësitë që lidhen me kuadrin dhe instrumentet aktuale	89
3.2 Disponueshmëria e shërbimit	92
3.3 Përshtatshmëria e ofrimit të shërbimit	94
3.3.1 Autorizimi dhe financimi i OSHC-ve që ofrojnë ndihmë juridike	94
3.3.2 Sfidat e lidhura me burimet e NJF-së	95
3.3.3 Vështirësitë që lidhen me kapacitetet e ofruesve	96
3.3.4 Cilësia e bashkërendimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve	97
PJESA IV: PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KYÇE	100
4. Gjetjeve kyçe	102
4.1. Besimi, Ndërgjegjësimi dhe Qasja	103
4.2. Kufizimet e Burimeve Njerëzore dhe Financiare	104
4.3. Kapacitetet dhe Sfidat Burokratike dhe Procedurale	105
4.4. Bashkërendimi dhe Sigurimi i Cilësisë	106
4.5. Kuadri Ligjor dhe i Politikave	107
PJESA V: REKOMANDIME	108
5. Konkluzionet dhe rekomandimet	110
5.1. Besimi, ndërgjegjësimi dhe qasja	110
5.2. Kufizimet e burimeve njerëzore dhe financiare	111
5.3. Kapacitetet dhe sfidat burokratike dhe procedurale	113
5.4. Bashkërendimi dhe sigurimi i cilësisë	114
5.5. Kuadri ligjor dhe i politikave	115
Shtojcë	116
Fjalorth me terma të shpeshtë	117
Referencat	119

SHKURTESAT

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
CAPI	Intervistë Personale me Ndhmën e Kompjuterit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
KDPAK	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KiE	Këshilli i Evropës
CEPEJ	Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë
MKRDHF	Mekanizmi i Koordinimit për Rastet e Dhunës në Familje
DN	Nuk e di
Dok.	Dokument
Etj.	E të tjera
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
DGF	Diskutime në Grupe Fokusi
NJF	Ndihma juridike falas
GPS	Sistemi i Pozicionimit Global
AF	Anketa e Familjeve
ICCPR	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile
TI	Teknologjia e informacionit
IPK	Intervistat me Persona Kyç
LGBTQI+	Lesbique, gej, biseksualë, transgjjinorë, queer dhe interseks
MD	Ministria e Drejtësisë
N	Numri i kampionit
NA	Nuk zbatohet
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

OJF	Organizatë Jofitimprurëse
NR.	Numër
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lart të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Para.	Paragraf
NJPK	Njësia Parësore e Kampionimit
PPP	Probabiliteti Proporcional me Përmasat
REZ	Rezolutë
SPSS	Paketa Statistikore për Shkencat Sociale
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
TV	Televizion
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim paraqet një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale të qasjes në drejtësi dhe efektshmërisë së shërbimeve të ndihmës juridike në Shqipëri, duke u përqendruar te grupet e cënueshme në veçanti. Studimi vlerëson mënyrën se si zhvillimet e reja në kuadrin e ndihmës juridike që prej anketës së fundit të zhvilluar në vitin 2017, kanë trajtuar nevojat përkatëse dhe kanë përmirësuar qasjen në drejtësi. Vlerësimi përdor të dhëna sasiore dhe cilësore të mbledhura përmes anketës kombëtare të familjeve, një sondazhi në internet me palët e interesit që përfshin ofruesit e ndihmës juridike dhe profesionistë të tjerë, intervistat me aktorë kyç informues dhe diskutimet në grupe fokusi. Gjetjet synojnë identifikimin e vështirësive kryesore të lidhura me drejtësinë, vlerësimin e ndikimit të reformave të ndihmës juridike të ndërmarra rishtazi, dhe propozimin e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit me qëllim garantimin e qasjes së barabartë dhe të papenguar në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Qasja në drejtësi

Qasja në drejtësi është aspekt themelor i shoqërive demokratike dhe i shtetit të së drejtës, që u mundëson qytetarëve të kërkojnë zgjidhje për ankesat e tyre dhe t’u respektohen të drejtat. Rezultatet e vlerësimit theksojnë ndikimet pozitive të miratimit të Ligjit Nr. 111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti” (Ligji për NJF-në) që prej miratimit të tij në vitin 2017, lidhur me përmirësimin e efektshmërisë dhe mbulimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas. Ligji për ndihmën juridike ka përfshirë kategori përfituesish shtesë dhe ka ngritur mekanizma për ofrimin e shërbimit të cilët sigurojnë qasje më efikase në sistemin e drejtësisë, veçanërisht për individët e cënueshëm. Që prej vitit 2019, hapja e Qendrave të Ndhimës Juridike Falas ka përmirësuar më tej qasjen në këto shërbime jetike, dhe numri i qendrave është shtuar nga tetë në vitin 2021 në njëzet të tilla në vitin 2023. Ofrimi i shërbimeve është përforcuar përmes organizatave jofitimprurëse (OJF) të autorizuara dhe klinikave ligjore. Gjithsej, deri në fund të vitit 2023 janë autorizuar 15 OJF dhe 12 klinika ligjore për ofrimin e shërbimeve në qarqe të ndryshme. Partneriteti i strukturuar ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë ka shtuar ndjeshëm numrin e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, duke përmirësuar më tej kapacitetet dhe cilësinë e ndihmës juridike.

Ndërkohë që në sistemin e ndihmës juridike në Shqipëri ka pasur përparim për t’u vlerësuar, qasja në shërbim dhe cilësia e tij nevojitet të përmirësohen më tej, në bashkërendim me palët përkatëse të interesit. Progresi pozitiv i viteve të fundit ka hapur rrugën për

qasje më të mirë në drejtësi për të gjithë individët, veçanërisht individët që janë pjesë e kategorive të cënueshme. Përpjekjet e vazhdueshme për trajtimin e vështirësive aktuale do të ndihmojnë në fuqizimin e mëtejshëm të sistemit dhe do të sigurojnë përfitime të barabarta nga këto shërbime të rëndësishme. Një prej fushave që kërkon më shumë vëmendje është ndërgjegjësimi i mëtejshëm lidhur me shërbimet e ndihmës juridike, veçanërisht i grupeve të cënueshme si gratë, vajzat, banorët e zonave rurale dhe personat me aftësi të kufizuara. Shpesh këto kategori u kërkojnë ndihmë organizatave të shoqërisë civile, të cilat sigurojnë qasje më të mirë dhe janë më të specializuara në punën me këto grupe. Qasja në drejtësi pengohet edhe nga kufizimet financiare. Shpesh individët që janë në vështirësi ekonomike, dhe veçanërisht personat që vijnë nga familje me nivel të ulët të ardhurash, nuk mund të përballojnë shpenzimet e përfaqësimit juridik. Vështirësitë e lidhura me qasjen vijnë gjithashtu edhe nga kërkesat e ndërlikuara të dokumentacionit për kualifikim për ndihmë juridike falas, çka pengojnë edhe më tepër individët në vështirësi ekonomike. Distanca gjeografike është një tjetër pengesë lidhur me qasjen në drejtësi. Banorët e zonave rurale dhe të thella duhet të përshkojnë distanca të mëdha drejt qendrave të ndihmës juridike ose gjykatave, çka kërkon kohë dhe është e kushtueshme. Harta e re gjyqësore, e cila ka hyrë në fuqi në shkurt 2023 dhe ka pakësuar numrin e gjykatave, ka ndërlikuar më tej pengesat gjeografike për qasjen në drejtësi.

Një tjetër faktor që ndikon drejtpërsëdrejti qasjen në drejtësi është besimi tek sistemi i drejtësisë. Grupet e cënueshme, si pakicat, personat e papunë dhe familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara janë më të prirur të kenë një mungesë më të theksuar besimi. Shpesh, kjo mungesë besimi i ka rrënjët te perceptimet e pandjeshmërisë së gjyqësorit ndaj nevojave të komuniteteve të cënueshme, si personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetin LGBTQI+, si dhe vonesat e procesit dhe pengesat burokratike. Pavarësisht përmirësimeve të shumta gjatë viteve të fundit, shumë qytetarë ende zgjedhin avokatë privatë, sepse besojnë se ata ofrojnë shërbime me cilësi më të mirë se ofruesit e ndihmës juridike falas. Ky perceptim vazhdon të ekzistojë pavarësisht disponueshmërisë së avokatëve të kualifikuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas. Gjetja se vetëm 13% e të intervistuarve kanë kërkuar informacion juridik gjatë pesë viteve të fundit, tregon se shpesh qytetarët mbështeten në burime jo zyrtare për marrjen e informacionit juridik. Kjo mund të lidhet me elementë kulturorë të shoqërisë, ku individët tradicionalisht i drejtohen miqve dhe të njohurve për informacion në vend të burimeve zyrtare, gjë që mund të çojë në këshilla të papërshtatshme ose të pasakta. Ndër personat që kanë kërkuar informacion juridik, 60% vijuan më pas me veprime juridike, ku 52% bënë përpjekje për zgjidhje të drejtpërdrejtë me palën kundërshtare përpara se t'i drejtoheshin gjykatës. Pavarësisht nivelit të lartë të kënaqësisë me shërbimet e ndihmës juridike (61%), shumë të anketuar (74%) kanë përjetuar stres në proceset gjyqësore, ndërsa 33% patën probleme shëndetësore, humbje të vetëbesimit, ose dëmtim të marrëdhënieve familjare. Shtrirja e qendrave të ndihmës juridike dhe veprimtarive ndërgjegjëse ka kontribuar për rritjen e konsiderueshme të numrit të qytetarëve që kanë përfituar ndihmë juridike falas. Pavarësisht kësaj, qytetarët nuk arrijnë ende të kuptojnë plotësisht ndihmën juridike falas, veçanërisht në zonat rurale ku normat kulturore dhe paragjykimet në komunitet shkurajon kërkimin e ndihmës nga qytetarët. Ndërgjegjësimi më i mirë i qytetarëve lidhur me shërbimet e disponueshme të ndihmës juridike, veçanërisht tek

grupet e cënueshme, kërkon më tepër vëmendje. Qasja e kufizuar në informacion shpesh rezulton në mungesë informacioni lidhur me disponueshmërinë e shërbimeve të ndihmës juridike tek personat me aftësi të kufizuara. Autoritetet vendore dhe OJF-të kanë luajtur një rol themelor në shpërndarjen e informacionit rreth shërbimeve të NJF-së dhe për referimin e rasteve, veçanërisht në bashkitë ku qendrat e ndihmës juridike sapo janë hapur. Krahës kësaj, ligji për ndihmën juridike falas nuk njihet ende gjerësisht, çka thekson nevojën për nisma ndërgjegjësimi të synuara për kategori të ndryshme përdoruesish.

Përqendrimi tek kategoritë e cënueshme

Raporti identifikon pengesat konkrete të hasura nga komunitetet e marginalizuara dhe të cënueshme sa i përket qasjes në drejtësi. Individët me të ardhura të pakta përballen me vështirësi kur i qasen drejtësisë për shkak të kufizimeve financiare dhe procesit të ndërlikuar të përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm. Aktualisht, për të përfituar nga ndihma juridike falas, individët që përballen me diskriminim duhet ta vërtetojnë këtë diskriminim përmes një vendimi të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), çka krijon pengesa të konsiderueshme ligjore. Viktimat e dhunës në familje duhet të marrin urdhër mbrojtjeje përpara se të përfitojnë ndihmë juridike, çka përbën pengesë pasi shumë prej viktimave i druhen përshkallëzimit të situatës. Komunitetet rome dhe egjiptiane shpesh nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm, dhe niveli i tyre arsimor që në përgjithësi është i ulët, vështirëson qasjen e tyre në sistemin e drejtësisë. Personat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të konsiderueshme për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme dhe mungesës së teknologjive ndihmëse në proceset gjyqësore. Në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas informacioni nuk mund konsultohet lehtësisht nga të gjitha kategoritë, veçanërisht nga personat me vështirësi në shikim. Gjithashtu, individët LGBTQI+ hasin pengesa për shkak të paragjykitimit dhe stereotipizimit, ndërsa të moshuarit hasin vështirësi për shkak të mungesës së informacionit ose vështirësive lidhur me qasjen në teknologji.

Kufizimet e burimeve njerëzore dhe financiare

Burimet e pamjaftueshme njerëzore përbëjnë sfidë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike. Shumica e qendrave të ndihmës juridike (16 nga 20 gjithsej) funksionojnë vetëm me një punonjës. Kjo ndikon në aftësinë e qendrave për të administruar në mënyrë efikase ngarkesën e tyre të punës, si dhe kufizon kapacitetin e tyre mundësitë e tyre për përgatitjen e fushatave të mbulimit dhe ndërgjegjësimit. Kjo ndikon në aftësinë e qendrave për të menaxhuar në mënyrë efikase ngarkesën e tyre të punës dhe kufizon kapacitetin e tyre për të zhvilluar fushata për ndërgjegjësim dhe informim. Për më tepër, Drejtoria e NJF-së ka gjithashtu burime të kufizuara njerëzore për monitorimin e këtyre qendrave. Këto vështirësi përshkallëzohen më tej

nga kufizimet financiare. Buxheti për ndihmën juridike falas është i kufizuar dhe si pasojë kufizon aftësinë e qendrave të ndihmës juridike lidhur me shtrirjen e mëtejshme të shërbimeve dhe organizimin e fushatave të nevojshme të ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve. Sistemi i ndihmës juridike falas vijon të varet nga mbështetja e donatorëve me qëllim kompensimin e këtij kufizimi. Ndërkohë, janë identifikuar edhe një sërë problematikash burokratike. Procesi i kërkesës së ndihmës juridike është i ndërlikuar dhe kërkon dokumentacion shterues nga ana e kërkuësve, çka përbën pengesë sidomos për grupet e cënueshme dhe individët me nivel të ulët të ardhurash. Këta individë hasin vështirësi për verifikimin e statusit të tyre ekonomik për shkak të kriterëve të ndërlikuara për dokumentacion, plotësimi i të cilave kërkon kohë. Këto pengesa burokratike bëhen edhe më të theksuara nga vonesat në caktimin e avokatëve, përfshirë edhe vonesat në qasjen e ndihmës juridike dytësore dhe shqetësimet lidhur me korrektesën e sistemit të rotacionit. Për më tepër, qytetarët shkurajohen me tej nga të kërkuarit drejtësi edhe si pasojë e kostove të larta për shërbimet e ekspertëve.

Kuadri ligjor

Sa i përket kuadrit ligjor për ndihmën juridike janë hedhur hapa të konsiderueshëm përpara, veçanërisht pas miratimit të Ligjit Nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”. Zbatimi i këtij ligji deri në momentin e hartimit të këtij studimi nxjerr në pah nevojën e rishikimit të tij me qëllim harmonizimin e proceseve që lidhen me dokumentacionin, financimin e OJF-ve, decentralizimin e verifikimit dhe miratimin e kërkesave për ndihmë juridike falas, si dhe lidhur me garantimin e njëtrajtshmërisë së shërbimit në mbarë vendin. Gjetjet e punës kërkimore theksojnë nevojën e rishikimit të kriterëve për statusin ekonomik në kuadër të përfitimit të ndihmës juridike falas me qëllim përfshirjen e kategorive të tjera të cënueshme. Nevojiten edhe ndërhyrje ligjore për të përmirësuar qasjen dhe kriteret e pranimit, përfshirë njohjen e romëve dhe egjiptianëve si kategori të veçanta me të drejtë përfitimi nga ndihma juridike falas. Një tjetër çështje me rëndësi ka të bëjë me nevojën për trajnim të specializuar për ofruesit e ndihmës juridike, gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë përkatës. Shpesh, ofruesve, përfshirë edhe avokatëve, u mungon ekspertiza në fusha specifike, veçanërisht në trajtimin e çështjeve të ndërlikuara dhe delikate, që përfshijnë individë nga grupe të cënueshme, si viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe fëmijët.

Së fundmi, gjetjet e vlerësimit theksojnë nevojën e vënies në funksion të formularëve të vlerësimit dhe mekanizmave të ankesave me qëllim marrjen e informacionit nga përdoruesit e shërbimit dhe identifikimin e fushave ku ka nevojë për përmirësime. Proceset aktuale të mbledhjes manuale të të dhënave kufizojnë monitorimin dhe raportimin e efektshëm, duke vështirësuar prodhimin e statistikave të sakta dhe hartimin e raporteve. Udhëzimet aktuale për raportimin përjashtojnë rastet e trajtuara përmes telefonit ose internetit, çka sjell nënraportimin e shërbimeve të ofruara nga qendrat e ndihmës juridike dhe OJF-të.

Krahas kësaj, shpeshherë OJF-të ofrojnë ndihmë të menjëhershme nëpërmjet avokatëve të brendshëm pa aplikim zyrtar, me qëllim shmangien e pengesave burokratike, por ligji nuk e njeh këtë ndihmë si ndihmë juridike dytësore. Vlerësimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i shërbimeve të ndihmës juridike vështirësohet nga mangësitë lidhur me vlerësimin e përvojës së përfituesve dhe mekanizmat e raportimit.

Rekomandimet e përmbledhura në raport synojnë përmirësimin e qasjes në drejtësi duke i bërë shërbimet e ndihmës juridike falas më përfshirëse dhe me qasje më të mirë, veçanërisht për grupet e cënueshme si komuniteti rom dhe ai egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët. Këto rekomandime janë hartuar me qëllim informimin e politikëbërësve dhe nxitjen e përmirësimeve përmes ndryshimeve të politikave. Shërbimet e ndihmës juridike duhet të përshtaten për individët me vështirësi në shikim dhe dëgjim, ndërkohë që ka nevojë për programe që përmirësojnë aftësitë digjitale të të moshuarve dhe atyre që kanë qasje të kufizuar në teknologji. Decentralizimi i verifikimit të kërkesave për ndihmë juridike do të pakësonte ngarkesën e gjykatave lidhur me këtë aspekt. Një prej rekomandimeve të raportit ka të bëjë me rishikimin e ligjit për NJF-në me qëllim përfshirjen e komuniteteve rom dhe egjiptiane si kategori të veçanta, harmonizimin e dokumentacionit, dhe ofrimin e ndihmës së menjëhershme viktimave të dhunës në familje në diskriminimit. Përmirësimi i procedurave të dokumentacionit, rishikimi i kriterëve ekonomike dhe shfrytëzimi i instrumenteve digjitale për verifikimet janë elemente thelbësore për arritjen e efikasitetit. Përhapja e informacionit dhe mbulimi me shërbime të ndihmës juridike përforcohen përmes partneritetit me OJF-të, kështu që thjeshtimi i procesit të autorizimit dhe financimit të tyre, konsiderohen si elemente me rëndësi. Për më tepër, edhe publikimi i historive të suksesit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike, përmirësimi i transparencës gjatë raportimit, dhe organizimi i fushatave përfshirëse të ndërgjegjësimit janë elemente thelbësore për rritjen e besimit të publikut. Përpjekjet për përmirësimin e shërbimeve të ndihmës juridike duhet të mbështeten nga burimet të përshtatshme njerëzore në qendrat e ndihmës juridike dhe nga shtrirja e vazhdueshme e shërbime në mbarë vendin. Gjithashtu, shërbimet e ndihmës juridike falas duhet të integrohen më mirë me sistemet e mbështetjes sociale dhe mekanizmat vendorë të referimit, me qëllim nxitjen e përgjigjes së bashkërenduar nga të gjithë aktorët përgjegjës. Është e nevojshme të vihen në zbatim programe të specializuara trajnimi për avokatët dhe mekanizma të sigurimit të cilësisë me qëllim garantimin e standardeve të larta të shërbimit. Disa elemente që do të mbështesnin më tej përmirësimet e vazhdueshme të ofrimit të këtij shërbimi do të ishin sigurimi i fondeve buxhetore për ndihmën juridike, vlerësimi i kapaciteteve të Drejtorisë së NJF-së dhe harmonizimi i kriterëve për ndihmën juridike dytësore. Së fundmi, zbatimi i nismave të përshtatshme dhe rishikimi i tarifave për ofruesit e ndihmës juridike janë pika kritike për ruajtjen e cilësisë së shërbimit dhe motivimin e ofruesve të ndihmës juridike.

Këto rekomandime do të ofrojnë informacion të mëtejshëm për përmirësimin e politikave me qëllim përforcimin e efektshmërisë dhe përfshirjes së sistemit të ndihmës juridike në Shqipëri.



PJESA I
HYRJE

A. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport synon të vlerësojë gjendjen aktuale të qasjes në drejtësi në Shqipëri, veçanërisht sa i përket efektshmërisë së sistemit të NJF-së në Shqipëri dhe nevojave të grupeve të cënueshme. Synimi është ofrimi i mbështetjes për institucionet kombëtare të administrimit të ndihmës juridike, për profesionistët e sistemit të drejtësisë, si dhe për ofruesit e NJF-së për të garantuar qasje më të barabartë dhe pa pengesa në drejtësi. Kjo është veçanërisht kritike në kontekstin e reformës së kohëve të fundit në sistemin e drejtësisë të Shqipërisë, hartës së re gjyqësore, dhe statusit si vend kandidat i BE-së.

Ky raport është vlerësimi i dytë i qasjes në drejtësi të Shqipëri, pas raportit të UNDP-së të vitit 2017¹. Ashtu si raporti i mëparshëm, raporti i vitit 2024 përmbledh gjetjet e instrumenteve sasiore dhe cilësore të kërkimit. Ato përdoren për të verifikuar nevojat dhe përvojat e popullsisë që jeton në Shqipëri lidhur me drejtësinë, pa e kufizuar fokusin e raportit në institucione apo grupe të veçanta.

Raporti është i ndarë në pesë pjesë:

- Një hyrje që përmbledh qëllimin, metodologjinë dhe kontekstin e raportit (Pjesa I);
- Pjesën e dytë dhe të tretë që paraqesin analizën e gjetjeve kryesore të fazës së kërkimit sasiore (Pjesa II) dhe fazës së kërkimit cilësor (Pjesa III);
- Pjesën e katërt që përfshin një përmbledhje të gjetjeve kyçe të të dyja fazave të kërkimit (Pjesa IV);
- Pjesën e pestë me rekomandime të qarta dhe specifike (Pjesa V).

Gjithashtu, raporti përmban citime dhe një fjalorth termash kyçe për të ndihmuar lexuesin.

1. Anketë për Qasjen në Drejtësi në Shqipëri UNDP (2017) (Tiranë, UNDP).

B. METODOLOGJIA

1. Instrumentet e kërkimit

Të dhënat u mbledhën në kuadër të një procesi me katër hapa që kombinoi metoda sasiore dhe cilësore kërkimi, me qëllim krijimin e një panorame më të saktë të situatës së qasjes në drejtësi dhe ofrimit të ndihmës juridike në Shqipëri. Të dhënat u mbledhën në periudhën shkurt-prill të vitit 2024. Këto metoda përfshinë një anketë të familjeve, një sondazh në internet, intervista me persona të intervistuar dhe grupe fokusi. Këto metoda synuan popullsinë e përgjithshme që jeton në Shqipëri, mbi moshën 18 vjeçare, ekspertë juridikë dhe jo juridikë, si zyrtarë publikë, gjyqtarë, avokatë, prokurorë, punonjës socialë, përfaqësues të OJF-ve dhe organizatave profesionale, si dhe përdoruesit e shërbimit të NJF-së.

Ky raport ndjek raportin e vitit 2017 të UNDP-së për vlerësimin e qasjes në drejtësi. Në vitin 2017, UNDP-ja hartoi raportin e saj të parë që hulumtonte nevojat e paplotësuara të popullsisë për drejtësi në pesë bashki të Shqipërisë (Mat, Përmet, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë). Gjatë asaj periudhe, ligji i ri për NJF-në ishte miratuar, por nuk ishte ende në zbatim të plotë. Si pasojë, raporti i vitit 2017 i UNDP-së u përqendrua në çështje më të përgjithshme të qasjes në drejtësi pa vlerësuar me hollësi sistemin e NJF-së. Raporti i vlerësimit të qasjes në drejtësi për vitin 2024 përdor të njëjtën qasje nga poshtë-lart, si edhe raporti i vitit 2017. Në mënyrë të ngjashme, bazohet në një sërë instrumentesh sasiore dhe cilësore kërkimi (anketë familjare, intervista me të intervistuar kyçë dhe grupe fokusi), por gjithashtu përdor edhe një sondazh në internet. Edhe anketa e familjeve e vitit 2024 përdor pyetësor të ngjashëm me atë të raportit të vitit 2017. Shumë prej pyetjeve të pyetësorit janë të njëjta, por pas zbatimit të ligjit për NJF-në, pyetësori i vitit 2024 përqendrohet më shumë në ofrimin e ndihmës juridike. Gjithashtu, anketa e familjeve e vitit 2024 përdor një kampion më të vogël, duke u lejuar vetëm individëve në moshë madhore të marrin pjesë në anketën e familjeve, ndërkohë që u administrua në mbarë vendin.²

1.1 Anketa e familjeve

Anketa e familjeve u ndërmor me qëllim mbledhjen e provave sasiore lidhur me kuptimin e popullsisë për, besimin në, dhe kënaqësinë me sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

2. Në anketën e familjeve të vitit 2017 morën pjesë 1.758 të intervistuar mbi moshën 16 vjeç. Në kuadër të raportit të vitit 2024, në anketën e familjeve morën pjesë 46% të intervistuar më pak (1206 individë) dhe vetëm persona mbi moshën 18 vjeçare.

1.1.1 Përmasa dhe procedura e kampionit

Anketa përdori metodën e Intervistimit Personal me Ndihmën e Kompjuterit (CAPI), që përdor intervista ballë për ballë, të cilat u kryen nga 15 intervistues vendorë. Përmasat e kampionit të përcaktuar ishin 1.200 intervista, që u konsiderua e përshtatshme për mbledhjen e rezultateve të vlefshme në popullsinë e shërbyer nga gjykatat shqiptare, që vlerësohet të jetë 4.399.026 individë bazuar në të dhënat e regjistrit civil të vitit 2023. Përmasa e kampionit u përllogarit duke marrë në konsideratë kriteret minimale të përllogaritjes së kampionit me nivel besueshmërie 95% dhe marzh gabimi +/-3%. Gjithsej u kryen 1206 intervista. Metoda e kampionimit ishte metodë kampionimi grupi e shtresëzuar dhe me shumë faza, që përdori zonat gjeografike të rrugëve si Njësi Parësore të Kampionimit (NJPK). Qasja e Probabilitetit Proporcional me Përmasat (PPP) përcaktoi numrin e intervistave dhe NJPK-ve për secilën prej juridiksioneve të 13 gjykatave rajonale. Shtresëzimi u bazuar në zona (juridiksionet e gjykatës rajonale/bashkia/njësia administrative), ndërkohë që për secilin rajon u mor në konsideratë raporti ndërmjet kampionit urban dhe rural. Përzgjedhja e NJPK-ve në secilën njësi administrative ishte rastësore duke përdorur funksionin uniform RV të programit kompjuterik të Paketës Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS). Në shtojcë është përfshirë një listë e të gjitha bashkive të përzgjedhura. Përveç kësaj, intervistuesit u udhëzuan të trokasnin tre dyer më poshtë pas një interviste të suksesshme, ose në derën vijuese pas një interviste të pasuksesshme me qëllim futjen në një elementi rastësor shtesë.

1.1.2 Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave

Pyetësi i përfundimtar i anketës ë kodua në një aplikacion anketimi në pajisje inteligjente të lëvizshme me anë të programit kompjuterik “Kobo-Toolbox”, një platformë mbledhjesh të dhënash e bazuar në Android. Kjo lejoi ngarkimin e të dhënave drejtpërsëdrejti në server.

Anketa u krye fizikisht nga data 20 shkurt 2024 deri më 28 mars 2024. Intervistuesit u ndanë të tre grupe dhe u trajnuan në Tiranë, ku mësuuan rreth procedurës së kampionimit, si t'i qaseshin pjesëmarrësve për intervistë, rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave, dhe mbledhjen e të dhënave duke përdorur pajisjet inteligjente të lëvizshme. Secili grup intervistuesish u monitorua në terren nga një mbikëqyrës, me mbështetjen e koordinatorit vendor dhe specialistit të të dhënave. Si koordinatori vendor, ashtu edhe specialisti i të dhënave ishin përgjegjës për sigurimin e cilësisë së të dhënave dhe trajnimin e vështirësive të hasura gjatë procesit të intervistimit dhe zbatimit të metodologjisë së projektit. Ecuria u diskutua në mbledhje javore me përfaqësuesit e çdo ekipi dhe në prani të drejtuesit të ekipit, koordinatorit vendor, specialistit të të dhënave dhe mbikëqyrësve. Pas përfundimit të punës në terren dhe proceseve të verifikimit, të dhënat iu nënshtruan pastrimit dhe përpunimit të thelluar. U konsiderua e nevojshme

të kryhej një ponderim statistikor për korrigjimin e mospërputhjeve demografike. Analiza statistikore u krye përmes programeve kompjuterike SPSS dhe Stata. Rezultatet përfshinë një raport gjithëpërfshirës frekuence dhe një raport për tabulimin e kryqëzuar të të gjitha variablave të anketës krahasuar me tregues kyç socio-demografik. Të dy këto raporte u dorëzuan më 5 prill 2024. Programi kompjuterik Microsoft Power BI u përdor për paraqitjen pamore të të dhënave (shihni grafikët më poshtë).

1.2 Sondazhi përmes internetit

Nga data 5 shkurt deri më 5 mars 2024 u organizuar në sondazh në internet për mbledhjen e të dhënave sasiore nga palët e interesit të angazhuara në ofrimin e shërbimeve të NJF-së. UNDP-ja ftoi palët e interesit të NJF-së nga të gjitha bashkitë të merrnin pjesë në sondazhin në internet me anë të emailit. Ftesat u bënë sipas listave dhe detajeve të kontaktit të përgatitura nga ekipi kërkimor. U synuan ofruesit e NJF-së dhe zyrtarët qeveritarë, përfshirë koordinatorët vendorë të dhunës në familje, njësitë e mbrojtjes së fëmijës, punonjësit socialë dhe administratorët socialë. Teknika e kampionimit “ortek” u përdor për zgjerimin e mbulimit të sondazhit dhe shtimin e normës së përgjigjeve: pas plotësimit të sondazhit pjesëmarrësit nxiteshin t’ia referonin pyetësin kolegëve dhe pjesëtarëve të tjerë të rrjetit të tyre. Platforma “Kobo Toolbox” u përdor për mbledhjen e të dhënave. Në sondazh morën pjesë 139 individë gjithsej, kryesisht punonjës socialë.

1.3 Intervistat me Persona Kyç

Në periudhën 4-8 mars 2024 u organizuan 20 Intervista fizike dhe në distancë me Persona Kyç (IPK) me një sërë palësh interesi të NJF-së, përfshirë zyrtarë qeveritarë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, agjenci të zbatimit të ligjit, përfaqësues të OJF-ve, si dhe përdorues të sistemit të NJF-së. Si referencë për përcaktimin e planit të intervistave u përdorën udhëzues të intervistave. Intervistat gjysmë të strukturuar i siguruan ekipit kërkimor mundësinë të mbledhin informacion të thelluar lidhur me arsyet në bazë të gjetjeve kryesore të anketës së familjeve dhe sondazhit në internet.

Intervistat u organizuan në Tiranë dhe përmes platformës Zoom me zyrtarë të Drejtorisë së NJF-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorisë, Gjykatës së Posaçme të Apelit, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Intervistat u përqendruan tek politikën, vështirësitë e zbatimit dhe ato operacionale me të cilat përballlet sistemi i NJF-së. Intervistat e përdoruesit e sistemit të NJF-së, sidomos nga grupet e cënueshme, synuan të regjistrojnë përvojat personale dhe ndikimin e shërbimeve të NJF-së që u ishin ofruar atyre.

1.4 Diskutimet në Grupe Fokusi

Përveç IPK-ve, u organizuan edhe shtatë Diskutime në Grupe Fokusi (DGF) me qëllim verifikimin e gjetjeve të anketës së familjeve dhe të sondazhit në internet. DGF-të u organizuan në periudhën 20-29 mars 2024. Ato synuan të mbledhin informacion në lëmin e qasjes në drejtësi, dhe përfshinë këndvështrimet e pjesëmarrësve për informacionin dhe mbulimin, qasjen në shërbim, cilësinë e tij, dhe pengesat e hasura si nga ofruesit e shërbimit, ashtu edhe nga përdoruesit e sistemit të NJF-së. Diskutimet u mbështetën nga ekipi kërkimor, i cili përdori lista kontrolli si referencë për planin e intervistave. Çështjet e identifikuar gjatë DGF-ve u sqaruan përmes intervistave vijuese me pjesëmarrësit. Për secilën prej seancave u hartuan raporte përmbledhës të diskutimeve.

Pjesëmarrësit përfshinë përfaqësues të qendrave të ndihmës juridike, klinikave ligjore në universitete, qeverisjes vendore, kancelarë dhe avokatë të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të NJF-së. Gjithashtu morën pjesë edhe përfaqësuesit e OJF-ve që punojnë me grupet e cënueshme.

Shtatë DGF-të kishin përbërjen e mëposhtme:

- Një DGF me përfaqësues nga zyrat e NJF-së;
- Dy DGF me përfaqësues të qeverisjes vendore përfshirë koordinatorët e dhunës në familje, barazisë gjinore, ekspertët e grupeve të cënueshme, njësitë e mbrojtjes së fëmijës dhe administratorët socialë, që janë përgjegjës për bashki të vogla dhe të mëdha, si dhe zona urbane dhe rurale;
- Dy DGF me OJF-të që punojnë me komunitetet e cënueshme (një DGF me ofrues të autorizuar të NJF-së dhe një tjetër me OJF që mbështetin komunitetet rome dhe egjiptiane, komunitetin LGBTQI+, të mbijetuarit e dhunës në familje, si dhe personat me aftësi të kufizuara); dhe
- Dy DGF me kancelarë dhe avokatë të caktuar nga gjykata, të autorizuar për ofrimin e shërbimeve të NJF-së.

2. Sigurimi i cilësisë

Me qëllim garantimin e cilësisë së mbledhjes së të dhënave, u zbatuan masat e mëposhtme:

- Të gjitha instrumentet e mbledhjes së të dhënave u hartuan në këshillim të ngushtë, duke përfshirë rishikimet dhe vërejtjet e ekipit kërkimor përgjatë një sërë raundesh shqyrtimi.

Për anketën familjeve:

- Intervistuesit duhet të plotësonin kriteret minimale.
- Për intervistuesit u organizua trajnimi i detyrueshëm që përfshiu seanca simulimi.
- Pyetësi i anketës u pilotua me qëllim eliminimin e paqartësive dhe për t'i lejuar intervistuesve të njihen me pyetjet.
- Momenti i nisjes dhe përfundimit të intervistës u regjistruan automatikisht për të kontrolluar kohëzgjatjen e saj dhe njëtrajtshmërinë e raportit të mbikëqyrjes.
- Koordinatat GPS u regjistruan automatikisht për secilën intervistë për të kontrolluar zbatimin e metodologjisë dhe përputhshmërinë me NJPK-të.
- Mbikëqyrësit ishin të pranishëm gjatë punës në terren për të kontrolluar nëse intervistuesit po kryenin detyrat e tyre.
- Specialisti i të dhënave kreu vazhdimisht kontrole në prapavijë për të identifikuar mungesa të dhënash dhe gabime.
- U kryen kontrole rastësore cilësie duke i telefonuar pjesëmarrësve që dhanë numrin e telefonit, nga një ekip me tre intervistues të pavarur dhe të jashtëm.
- Çdo grup intervistuesish i dorëzoi drejtuesit të ekipit përkatës raporte të shkurtra javore me qëllim kontrollin e ecurisë.
- U organizuan mbledhjeve javore në distancë për diskutimin e ecurisë, vështirësive të hasura gjatë procesit të intervistimit dhe/ose zbatimit të metodologjisë.

Për IPK-të dhe DGF-të:

- Mbledhja e të dhënave cilësore u krye nga një ekip kërkimor me përvojë dhe aftësi në analizat kërkimore tematike cilësore. Gjetjet kryesore të IPK-ve dhe DGF-ve u përmbledhën në raporte të shkurtra.

3. Konsiderata etike

3.1 Barazia gjinore

Barazia gjinore ishte objektiv i qëllimshëm kyç i këtij vlerësimi. Për anketën e familjeve, u mbledhën të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë për të siguruar ekuilibër gjinor. Në terren, intervistuesit kërkuan të intervistojnë individë të gjinisë së kundërt me atë të individit të intervistuar me sukses më parë duke synuar kështu raportin 50% me 50% në rang kombëtar me qëllim pasqyrimin e raportit gjinor në popullsinë e Shqipërisë. Çështjet e lidhura me gjininë, si dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i qenieve njerëzore, luajtën gjithashtu rol madhor përgjatë vlerësimit, me pyetje mbi këto tema të përfshira në pyetësor dhe lista kontrolli, si dhe me anë të ftimit të një sërë ekspertëve për të drejtat e grave të merrnin pjesë në sondazhin në internet, në IPK dhe në DGF. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm intervistuesish ishin femra (13 nga 15), ashtu si edhe pjesëtare të ekipit kërkimor (4 nga 6).

3.2 Miratimi i informuar

Përpara kryerjes së anketës së familjeve, sondazhit në internet, intervistimit të personave kyç dhe diskutimeve në grupe, ekipi kërkimor u siguria që vetëm të rriturit të merrnin pjesë në vlerësim, si dhe mori pëlqim me gojë nga pjesëmarrësit. Formularët e pëlqimit ishin pjesë përbërëse e pyetësorëve dhe listave të kontrollit dhe pjesëmarrësve iu dha orientim i qartë lidhur me pëlqimin e informuar përpara nisjes së diskutimit. Vetëm ata që pranuan të marrin pjesë në vlerësim u intervistuan. Pjesëmarrësit ishin të lirë të mos i përgjigjeshin pyetjeve, pa pasur nevojë të japin arsye.

3.3 Mbrojtja e të dhënave

Ekipi i kërkimit u siguria që vlerësimi, gjatë zbatimit si dhe pas përfundimit të tij, të ishte në përputhje me rregullat evropiane për mbrojtjen e të dhënave. Intervistuesit u trajnuan për mbrojtjen e të dhënave. Emrat e pjesëmarrësve nuk janë bërë publik në asnjë dokument. Mbledhja e të dhënave ishte anonime dhe nuk u regjistrua asnjë emër. Për fazën e studimit sasior, çdo pjesëmarrësi iu caktua një kod unik. Ky kod u lidh me një listë që lidhte kodin me informacionin e identifikueshëm të pjesëmarrësit.

3.4 Kompensimi

Për pjesëmarrësit në këtë vlerësim nuk u ofrua kompensim apo rimbursim.

3.5 Pilotimi

Anketa e familjeve u pilotua nga intervistuesit në zonat e afërta dhe pas përshtypjeve të tyre, pyetësi u ndryshua në disa pika.

C. KONTEKSTI

1. Rëndësia e qasjes në drejtësi

Qasja në drejtësi është element thelbësor i procesit demokratik dhe një prej parimeve themelore të shtetit të së drejtës. Ky koncept trajton gjithçka është e nevojshme që individët të kenë mundësi të kërkojnë zgjidhje të ankesave të tyre dhe që t'u zbatohen të drejtat. Si pasojë qasja në drejtësi duhet t'u garantohet të gjithëve, pavarësisht gjendjes së tyre financiare. Qasja në ndihmë juridike është element kyç për sigurimin e qasjes në drejtësi.³ Ndihma juridike mund të ndihmojë persona përkatës që të dëgjohen dhe të ngushtojë hendekun e drejtësisë ndërmjet atyre që mund të përballojnë të paguajnë një avokat dhe atyre që nuk munden. Në praktikë, zbatohen masa dhe politika të ndryshme për të ndihmuar qeveritë të sigurojnë qasje në ndihmë juridike. Këtu përfshihen procedurat e thjeshta dhe të qarta të aplikimit për ndihmë juridike, numër minimal të mjaftueshëm profesionistësh të ndihmës juridike për ofrimin e saj, praninë e barabartë të ofruesve të ndihmës juridike në mbarë vendin, informacionin e mjaftueshëm rreth ndihmës juridike në dispozicion të publikut, dhe sigurimin e informacionit për ndihmën juridike në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme nga të gjithë. Me fjalë të tjera, çdokush duhet të dijë saktësisht se ku të drejtohet nëse ka një çështje juridike, çfarë mbështetjeje u ofrohet atyre dhe nëse kanë nevojë, ku të marrë informacion.

2. Detyrimet ndërkombëtare

Në praktikë, shumë sisteme të ndihmës juridike dështojnë në lidhje me grupet e cenueshme duke i anashkaluar ato, ose duke mos i trajtuar në mënyrë të mjaftueshme nevojat e tyre të veçanta.⁴ Termi 'grupe të cenueshme' i referohet veçanërisht personave të cilët marginalizohen si pasojë e praktikave negative sociale, ekonomike dhe kulturore të pranishme në shoqëri. Këtu përfshihen personat me aftësi të kufizuara, gratë, komuniteti LGBTQI+ dhe pakicat etnike.⁵ Në përgjigje të këtyre situatave, traktatet ndërkombëtare dhe rajonale nxisin të drejtën e qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë, dhe shumë prej këtyre

3. Relatori i Veçantë i OKB-së për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve (2013) "Ndihma juridike, e drejtë më vete". OHCHR. <https://www.ohchr.org/en/press-releases/2013/05/legal-aid-right-itself-un-special-rapporteur>.

4. Shihni për shembull Lemke Stefanie (2022) "The Role of Legal Technology to Strengthen the Access to Justice for Disadvantaged Groups: [Roli i Teknologjisë Juridike në Përforcimin e Qasjes në Drejtësi për Grupet e Disavantazhuara:] An Overview of Best Practices from Asia and Europe" [Panoramë e Praktikave të Mira nga Azia dhe Evropa], në: Shoqata për Monitorimin e të Drejtave të Barabarta (ed.), *Konferenca Ndërkombëtare për Qasjen në Drejtësi: Fuqizimi i Qasjes në Drejtësi për Grupet e Disavantazhuara* (Ankara, Komisioni Evropian), faqe 117-121.

5. OHCHR (2021) "Non-discrimination: groups in vulnerable situations" [Mosdiskriminimi: grupet në situata të cenueshme]. OHCHR. <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Health/Pages/GroupsInVulnerableSituations.aspx>; OKB

instrumenteve gjejnë zbatim edhe në Shqipëri. Në vitin 2016, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm hynë zyrtarisht në fuqi.⁶ Dokumenti përcakton 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat synojnë të mobilizojnë përpjekje botërore për t'i dhënë fund varfërisë, për të mëkuar paqen, për të mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë njerëzve dhe për të mbrojtur planetin.⁷ Objektivi 16.3 është hartuar për 'të siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë'. Në Shqipëri, qeveria ngriti një komitet ndërministror në vitin 2017 për të mbështetur zbatimin e OZHQ-ve.⁸ Gjithashtu, Shqipëria është shtet palë i instrumenteve themelore të të drejtave të njeriut të OKB-së përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)⁹, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW)¹⁰ dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)¹¹. Të gjithë këta instrumente i bëjnë thirrje shteteve të garantojnë të drejtën e qasjes së barabartë në drejtësi.¹² Në rang rajonal, e drejta e qasjes së barabartë në drejtësi mbrohet, për shembull, nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) e Këshillit të Evropës që është instrument shtrëngues për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit. Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës që prej vitit 1995.¹³ Në këtë kuadër vendi ka ratifikuar KEDNJ-në, përfshirë nenin e saj 6 që i garanton çdo personi të drejtën për gjykim të drejtë, dhe ndihma juridike është element kyç i kësaj të drejte. Për më tepër, 'Udhëzimet për Efikasitetin e Efektshmërinë e Skemave të Ndhmës Juridike në Fushat e të Drejtës Civile dhe Administrative' të Këshillit të Evropës theksojnë rolin kritik të ndihmës juridike për garantimin e qasjes në drejtësi në mënyrë të barabartë për të gjithë, duke nxitur shtetet anëtare të ndjekin vizionin e OZHQ-ve për "një botë të drejtë, me barazi, tolerante të hapur dhe me shoqëri përfshirëse në të cilën përmbushen nevojat e personave më të cënueshëm".¹⁴

⁶ "Vulnerable Groups: [Grupet e Cënueshme] Who are They? [Kush janë?] OKB. <https://www.un.org/en/fight-racism/vulnerable-groups>.

⁷ Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (2015) Transforming our world: the 2030 agenda for sustainable development [Transformimi i botës sonë: Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm], 21 tetor, A/RES/70/1.

⁸ Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (2015) Transforming our world: the 2030 agenda for sustainable development [Transformimi i botës sonë: Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm], 21 tetor, A/RES/70/1, faqe 1-2.

⁹ OKB (2022) "Sustainable Development Goals: [Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm]: Knowledge Platform [Platforma e Njohurive]: Shqipëri". OKB. <https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/albania>.

¹⁰ Shqipëria ratifikoi ICCPR-në në 4 tetor 1991. Baza e të Dhënave për Traktatet e OKB-së: Statusi i ratifikimit për Shqipërinë. OHCHR. https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=141&Lang=E.

¹¹ Shqipëria ratifikoi CEDAW më 11 maj 1994 Baza e të Dhënave për Traktatet e OKB-së: Statusi i ratifikimit për Shqipërinë. OHCHR. https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=141&Lang=E.

¹² Shqipëria e ratifikoi KDPAK më 11 shkurt 2013 Baza e të Dhënave për Traktatet e OKB-së: Statusi i ratifikimit për Shqipërinë. OHCHR. https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=141&Lang=E.

¹³ ICCPR, Neni 14(1)(1); KDPAK, neni 5(1) dhe (2); CEDAW, Neni 15(1) dhe (2).

¹⁴ KfE (2023) "Shqipëri". KfE. <https://www.coe.int/en/web/portal/albania>.

¹⁵ Udhëzimet për Efikasitetin e Efektshmërinë e Skemave të Ndhmës Juridike në Fushat e të Drejtës Civile dhe Administrative të KfE (2021), faqet 5, 8, 10-11, 16.

Gjithsesi, pas akordimit të statusit të vendit kandidat për në BE në vitin 2014¹⁵, Komisioni Evropian, krahu ekzekutiv i BE-së, theksoi nevojën kritike të Shqipërisë lidhur me konsolidimin e përparimit në disa fusha kyçe, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit si dhe krimin të organizuar. Këtu përfshihen edhe heqja e pengesave lidhur me qasjen në drejtësi, përfshirë pamundësinë e grupeve të disavantazuara për të përfutur ndihmë juridike dhe nga politikat e përfshirjes sociale. Si pasojë dhe me qëllim trajtimin e rekomandimeve të BE-së, Shqipëria miratoi Ligjin Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" (më poshtë referuar si "Ligji për NJF-në"), një sërë aktesh nënligjore për ofrimin e NJF-së¹⁶, dhe Strategjinë e tretë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2022-2030.

3. Situata aktuale e ofrimit të ndihmës juridike në Shqipëri

3.1 Administrimi dhe organizimi i ndihmës juridike

Ministria e Drejtësisë (MD) është përgjegjëse për administrimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të ofrimit të ndihmës juridike.¹⁷ Politikat e saj zbatohen nga Drejtoria e NJF-së që ndër të tjera, është e ngarkuar me organizimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, sigurimin e cilësisë së NJF-së, si dhe përpunimin e pagesave për avokatët.¹⁸

Një prej tipareve dalluese të sistemit të ndihmës juridike në Shqipëri është sistemi i përzier i ofrimit të ndihmës juridike parësore. Ligji për NJF-në dallon ndërmjet ndihmës juridike parësore dhe asaj dytësore¹⁹, dhe përcakton gjithashtu rregullat për kërkesën e përjashtimit nga tarifat gjyqësore dhe tarifat e tjera për dorëzimin e kërkesave në gjykatë. Ndhma juridike dytësore mbulon këshillimin juridik dhe përfaqësimin në gjykatë. Përfaqësimi juridik mund të kryhet vetëm nga avokatët e kontraktuar ndërsa dokumentacioni juridik mund të hartohet nga ofrues të tjerë përveç avokatëve. Sa i përket shërbimeve të ndihmës juridike parësore (pra ofrimin e informacionit juridik dhe këshillimit juridik paraprak), Ligji për NJF-në lejon edhe qendrat shtetërore të ndihmës juridike, OJF-të dhe klinikat ligjore të universiteteve²⁰ të ofrojnë shërbimet përkatëse.²¹ Aktualisht, janë në funksion 20 qendra të ndihmës juridike, 15 OJF dhe 12

¹⁵ Këshilli Evropian (2023) "EU Enlargement Policy: [Politika e Zgjerimit të BE-së]: Shqipëri". Këshilli Evropian. <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/enlargement/albania/>.

¹⁶ Lista e hollësishme e të gjitha akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjera është e disponueshme në <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/legjislacion/>.

¹⁷ Ligji për NJF-në, Neni 7.

¹⁸ Ligji për NJF-në, Nenet 6 dhe 8.

¹⁹ Ligji për NJF-në, Neni 3(b) dhe (c) dhe Neni 5.

²⁰ Klinikat ligjore universitare funksionojnë në Universitetin Luarasi, në Universitetin Evropian të Tiranës, në Universitetin Wisdom College, në Universitetin Aleksandër Moisiu, në Universitetin Ismail Qemali, në Universitetin College Beder, në Universitetin e Tiranës, në Universitetin Qirjazi, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë dhe në Universitetin e Shkodrës.

²¹ Ligji për NJF-në, Nenet 13 dhe 15.

klinika ligjore në universitete të cilat janë të autorizuar të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore²². Në këtë kontekst Shqipëria përdor edhe shërbimet me një ndalesë, pra sportelet në të cilat ofrohen shërbime të ndryshme juridike²³. Ato ofrojnë ndihmë juridike parësore përmes telefonit ose fizikisht, me apo pa caktim paraprak orari. Klinikat ligjore të universiteteve nga ana tjetër, luajnë rol të vogël në ofrimin e ndihmës juridike parësore. Në vitin 2023, vetëm 23 individë kanë përfituar nga shërbimet e tyre. Si ofruesit e ndihmës juridike parësore, ashtu edhe ata të asaj dytësore duhet të përmbushin disa kritere të përcaktuara në Ligjin për NJF-në që të kualifikohen si ofrues.

Publiku informohet rreth shërbimeve të NJF-së përmes shërbimeve të përhershme fizike, shërbimeve të lëvizshme, aktiviteteve ndërgjegjëse (tryeza të rrumbullakëta, për shembull), programeve televizive dhe radiofonike, linjave të ndihmës (për shembull ‘Linja e Gjelbër’), faqeve të internetit (përfshirë edhe një platformë në internet), materialeve të shtypura si fletëpalosje, broshura, si dhe përmes mediave sociale si Facebook, Instagram dhe X.

Me gjithë rritjen e konsiderueshme nga viti në vit²⁴, buxheti vjetor i akorduar për NJF-në është ende i ulët (0,24 Euro për frymë) krahasuar me vendet e tjera evropiane, ku mesatarja ishte 3,08 Euro për frymë në vitin 2020.²⁵

3.2 Procesi i aplikimit për ndihmë juridike

NJF-ja është e disponueshme për procese gjyqësore administrative, civile dhe penale, përveç rasteve të ndihmës juridike të detyrueshme sipas përcaktimeve ligjore në procese penale.²⁶ Ligji për NJF-në siguron ndihmë juridike mbi bazën e kërkesës. Kërkesat për ofrimin e ndihmës juridike dytësore administrohen nga gjykatat dhe ‘organet procedurale që nisin hetimet’²⁷. Në disa gjykata janë ngritur njësitë e veçanta për përpunimin e kërkesave për ndihmë juridike.²⁸

22. 12 prej 20 qendrave të ndihmës juridike janë mbështetur nga UNDP-ja me financim nga ADA. Shihni për shembull, <https://www.undp.org/albania/press-releases/new-centre-providing-primary-free-legal-aid-service-opens-elbasan>.

23. Udhëzimet për Efikasitetin e Efektshmërinë e Skemave të Ndihmës Juridike në Fushat e të Drejtës Civile dhe Administrative të KiE (2021), përkufizimi 9(l).

24. Duke nisur me buxhet prej 25.317.344 Lekë në vitin 2018, financimi është rritur konsiderueshëm me kalimin e viteve. Buxheti vjetor ishte 66.200.000 Lekë në vitin 2021, 47.200.000 Lekë në vitin 2022, dhe 66.550.000 Lekë në vitin 2023. Edhe kontributi i donatorëve është gjithashtu në rritje me 1.210.000 Lekë në vitin 2019 dhe 20.486.157 Lekë në vitin 2022. Kontributi ka pësuar rënie të lehtë në vitin 2023 (18.581.073 Lekë).

25. CEPEJ (2020) “Baza dinamike e të dhënave të sistemeve gjyqësore evropiane: Shqipëri”. KiE. <https://public.tableau.com/app/profile/cepej/viz/OverviewEN/Overview>. Buxheti i akorduar për ndihmën juridike në vitin 2022 ishte rreth 800.000 Euro. Buxheti i shpenzuar në vitin 2022 vlerësohet në vlerën e 400.000 Euro (me rritje nga vlera prej 245.739 Euro në vitin 2021).

26. Ligji për NJF-në, Nenet 3(c) dhe 21; Kodi i Procedurës Penale, Neni 49.

27. Ligji për NJF-në, Nenet 6, 19(1) dhe 21.

28. Për shembull, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ndihma juridike dytësore është e disponueshme për qytetarët shqiptarë, personat pa shtetësi, personat me kombësi të huaj, si dhe azilkërkuesit dhe refugjatët.²⁹ Personat juridikë nuk kualifikohen për ndihmë juridike. Ndihma juridike bazohet në mundësi.³⁰ Pranueshmëria e personave për ndihmë juridike vlerësohet mbi bazën e përmasave të familjes, të ardhurave dhe pasurisë së tyre. Të ardhurat e tyre duhet të jenë nën pagën minimale dhe pasuritë e tyre nuk duhet të jenë më shumë se 36 paga minimale gjithsej.³¹ Për më tepër, ndihma juridike i jepet çdo individ pavarësisht situatës së tyre ekonomike, nëse ata janë pjesë e grupeve të mëposhtme: viktima të dhunës në familje, viktima të dhunës seksuale ose të trafikimit të qenieve njerëzore, fëmijë³², persona me aftësi të kufizuara, persona me aftësi të kufizuara mendore, personat nën kujdes, përfituesit e ‘programeve të mbrojtjes sociale’, dhe viktimat e të gjitha formave të diskriminimit që njihen me ligj.³³ Të gjithë kërkuesit e ndihmës juridike duhet të dorëzojnë dokumentacionin përkatës për verifikimin e ‘statusit’ të tyre. Kërkuesit e suksesshëm nuk kanë të drejtë të zgjedhin avokatin që dëshirojnë. Është, dhoma e avokatisë ajo që përzgjedh avokatin nga lista e avokatëve të autorizuar me rotacion.³⁴ Aktualisht, kjo listë përfshin 177 avokatë.³⁵ Kërkuesit e pasuksesshëm të cilëve u janë refuzuar kërkesat për NJF kanë të drejtën e ankimit.³⁶

Ndihma juridike parësore, pra ofrimi i informacionit juridik, këshillave juridike, dhe hartimi i dokumentacionit juridik, përfshirë edhe përfaqësimin përpara organeve administrative³⁷, lidhet me të njëjtat kushte si ndihma juridike dytësore³⁸, përveç kërkuesve të cilëve në përgjithësi nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumentacion shtesë për vërtetimin e ‘statusit’ të tyre. Mjafton që kërkuesi të dorëzojë një formular vetëdeklarimi që vërteton kualifikimin e vet për shërbimin.

3.3 Sfidat në sistemin e NJF-së

Me gjithë ndryshimet e konsiderueshme që prej botimit të raportit të vitit 2017 të UNDP-së për qasjen në drejtësi, sistemi i ndihmës juridike nuk është ende aq i efektshëm sa mund të ishte.

29. Ligji për NJF-në, Neni 10(1).

30. Ligji për NJF-në, Neni 22(5).

31. Ligji për NJF-në, Neni 12.

32. Ndihma juridike garantohet në proceset penale. Në proceset e tjera, fëmijët kanë të drejtën e ndihmës juridike vetëm nëse jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror.

33. Ligji për NJF-në, Neni 11.

34. Udhëzimi i përbashkët Nr. 17 datë 5 gusht 2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit për caktimin e avokatëve të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në procese civile dhe administrative”.

35. I disponueshëm në <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/publikime/>.

36. Ligji për NJF-në, Neni 21(4).

37. Ligji për NJF-në, Neni 3(b).

38. Urdhri Nr. 225 datë 25 mars 2019 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.

Ligji për NJF-në ka zgjeruar objektin e ndihmës juridike duke siguruar më shumë qasje në sistemin e drejtësisë për grupet e disavantazuara si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit si dhe personat me nivel të ulët të ardhurash. Ligji për NJF-në ka zgjeruar përkufizimin e ndihmës juridike, duke përfshirë tashmë edhe këshillimin dhe përfaqësimin juridik në procese administrative. Për zbatimin e tij janë miratuar një sërë aktesh nënligjore, të cilat përcaktojnë organizimin dhe administrimin e ofrimit të ndihmës juridike.³⁹ Ligji për NJF-në solli edhe ngritjen e Drejtorisë së NJF-së në vitin 2020, duke i hapur kështu rrugë një qasjeje më të bashkërenduar dhe efikase ofrimit të ndihmës juridike në mbarë vendin. Si rezultat i kësaj, u nënshkruan 25 marrëveshje me gjykata të ndryshme për të siguruar “qasjen në drejtësi për qytetarët përmes ofrimit të shërbimeve të NJF-së”.⁴⁰

Gjithashtu, është ngritur rrjeti i ofruesve të shërbimit me qëllim që shërbimet e NJF-së të jenë më të pranishme dhe të sigurojë profesionalizëm më të lartë të ofruesve të shërbimeve të NJF-së, të cilat ofrohen nga qendrat shtetërore të ndihmës juridike, OJF-të, avokatët dhe klinikat ligjore në institucionet e arsimit të lartë. Qendrat e para të shërbimeve të ndihmës juridike nisën funksionimin në vitin 2019, duke synuar decentralizimin e shërbimit dhe sjelljen e tij më pranë atyre të cilëve u nevojitet. Fillimisht u synuan zonat urbane dhe rajonet me qasje të kufizuar në shërbime të NJF-së. Deri në vitin 2021 ishin hapur tetë qendra të shërbimeve të ndihmës juridike dhe deri në vitin 2023, 20 qendra ishin në funksion (tetë prej të cilave aktualisht mbështeten nga ADA dhe UNDP-ja)⁴¹ Përveç ndihmës juridike parësore, dhe me ndihmën e donatorëve, OJF-të mund të ofrojnë edhe shërbime të ndihmës juridike dytësore.

Megjithatë, në vitin 2023, Projekti i Drejtësisë Botërore e renditi Shqipërinë në vendin e 76-të (nga 142 vende gjithsej) në kuadër të matjeve lidhur me qasjen në dhe përbalueshmërinë e sistemit të drejtësisë civile.⁴² Në raportin e vitit 2023 për

vendin, Komisioni Evropian gjithashtu kritikoi vështirësitë e sistemit të NJF-së lidhur me mbulimin e grupeve të cënueshme.⁴³ Një prej gjetjeve të raportit ishte se fëmijët rrallëherë përfitojnë nga ndihma juridike dhe se sistemit i mungon qasja me ndjeshmëri gjinore, veçanërisht sa i përket rasteve të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Po ashtu, Komiteti i CEDAW përveçse evidentoi financimin e pamjaftueshëm dhe infrastrukturën e dobët të sistemit të NJF-së, shprehu shqetësimin se as gjyqësori dhe as agjencitë ligjzbatuese nuk kanë njësi të specializuara për dhunën me bazë gjinore, çka jep kontribut për kulturën e pandëshkueshmërisë dhe vë në rrezik efektshmërinë e sistemit të NJF-së.⁴⁴

Për më tepër, Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve arriti në përfundimin se shumë pjesëtarë të komunitetit rom nuk kanë besim tek gjyqësori dhe nuk janë në dijeni për të drejtën e tyre për ndihmë juridike, duke rezultuar në përdorimin e sistemit të NJF-së nga një numër i vogël romësh.⁴⁵ Edhe për personat me aftësi të kufizuara ka pengesa të konsiderueshme lidhur me qasjen në shërbimet e NJF-së. Për shembull, ‘Raporti alternative për zbatimin e KDPK-ut në Shqipëri’ evidentoi se vetëm 7% e përfituesve të NJF-së janë persona me aftësi të kufizuara.⁴⁶

Arsyet kryesore përse personat me aftësi të kufizuara nuk përdorin sistemin e NJF-së janë mungesa e qasjes fizike në godinat e gjykatave dhe godina të tjera, instrumentet e paefektshme të komunikimit dhe mungesa e teknologjive ndihmëse.⁴⁷ Një tjetër vështirësi është harta e re gjyqësore,⁴⁸ e cila ka ulur ndjeshëm numrin e gjykatave në Shqipëri duke rrezikuar që individët të mos kenë mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe duke ngritur pengesa shtesë për sistemin e NJF-së lidhur me sigurimin e qasjes në sistem pavarësisht numrit më të vogël të gjykatave.

39. I disponueshëm në <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/legjislacion/>.

40. I disponueshëm në <https://ndihmajuridike.gov.al/>.

41. I disponueshëm në <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/publikime/>. Tetë qendrat e ndihmës juridike që aktualisht financohen nga UNDP-ja dhe ADA veprojnë në qytetet e Lezhës, Pogradecit, Vlorës, Dibrës, Kukësit, Beratit dhe Elbasanit. 12 qendrat e tjera të shërbimeve juridike në Tiranë, Lushnjë, Durrës, Shkodër, Tropojë, Përmet, Pukë, Mat, Kavajë, Kurbin, Gjirokastrë, dhe Fier financohen nga qeveria shqiptare. Edhe organizata të tjera ndërkombëtare kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm për suksesin e qendrave të ndihmës juridike. Për shembull, UNICEF-i ka mbështetur qendrat përmes programeve që përqendrohen tek qasja në drejtësi miqësore me fëmijët në konflikt me ligjin. Përmes projektit EURALIUS, BE-ja ka qenë kontribues kyç për reformën në drejtësi dhe përparimin e qasjes në drejtësi në Shqipëri (për shembull, përmes krijimit të instrumenteve praktike për udhëzimin e punës së qendrave). Fondacioni Shoqëria e Hapur ka mbështetur klinikat e ligjit në institucionet e arsimit të lartë dhe paraligjorët, duke i ndihmuar me organizimin e fushatave të informimit ligjor, punën e ndërgjyqësorisë strategjike, si dhe për hapjen e një platforme në internet (juristionline.al) dhe një linje ndihme pa pagesë. OSBE-ja ka lehtësuar trajnimin e specializuar për punonjësit e qendrave të shërbimeve të ndihmës juridike, duke i ndërgjegjësuar ata lidhur me nevojat e përdoruesve të sistemit të NJF-së, dhe veçanërisht të grupeve të cënueshme. Së bashku me OJF të specializuara dhe gjykata të shkallës së parë të Fierit, Durrësit, Tiranës, Lezhës, Shkodrës dhe Dibrës, përpara vitit 2017, UNDP në Shqipëri ka luajtur rol kyç për funksionimin e gjashtë qendrave pilote të ndihmës juridike. Këto pilotime u ofruan shërbime të ndihmës juridike parësore dhe dytësore komuniteteve vendore më të cënueshme.

42. Projekti i Drejtësisë Botërore (2023) “Rule of Law Index: [Indeksi i Shtetit të së Drejtës:] Shqipëri”. *Projekti i Drejtësisë Botërore*. <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/factors/2023/Albania/Civil%20Justice/>.

43. Të dy raportet janë të disponueshëm në https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/albania_en#key-documents.

44. Komiteti CEDAW (2023) *Vërejtjet përmbyllëse të raportit të pestë periodik të Shqipërisë* (Gjenevë, CEDAW). fq. 4.

45. Civil Rights Defenders (2018) *The Wall of Antigypsyism: [Muri i Anticiganizmit:] Roma and Egyptians in Albania [Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri]* (Stockholm, Civil Rights Defenders). faqe 17-18.

46. Fondacioni Së Bashku (2024) *Raport Alternativ për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara* (Tiranë, Fondacioni Së Bashku). fq. 11.

47. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2018) *Sigurimi i Qasjes në Drejtësi për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kuadrin Ligjor Shqiptar: Raport Monitorimi* (Tiranë, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara). faqe 94-98.; Komiteti Shqiptar i Helsinkit (2019) *Studimi Mbi Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti dhe Respektimin e Standardit të Aksesit në Drejtësi të Grupeve Vulnerabël* (Tirana, Komiteti Shqiptar i Helsinkit).

48. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 495 datë 21 korrik 2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave territoriale të gjykatave”.



PJESA II REZULTATET E FAZËS KËRKIMORE SASIORE

Një anketim në familje dhe një sondazh përmes internetit, i cili u qarkullua tek profesionistët e përfshirë në ofrimin e NJF-së, u kryen me qëllim arritjen e analizës së gjerë dhe të thelluar të çështjeve që lidhen me qasjen në drejtësi. Kjo pjesë paraqet rezultatet e këtyre instrumenteve studimore.

A. ANKETA E FAMILJEVE

Baza qendrore e këtij raporti është anketa kombëtare përfaqësuese e familjeve. Anketa synoi individët në moshë madhore në Shqipëri me të cilët u kryen intervista fizike nga 15 studentë intervistues në periudhën 20 shkurt 2024 deri 28 mars 2024. Përpara mbledhjes së të dhënave, intervistuesit u trajnuan dhe pilotuan pyetësin në fjalë, që më pas u modifikua bazuar në reagimin dhe kontributin e tyre. Intervistuesit, që ishin pothuajse të gjitha femra, u monitoruan në terren nga tre mbikëqyrës. Të gjitha intervistat u kryen në gjuhën shqipe. Për anketën e familjeve u intervistuan 1206 individë gjithsej. Të intervistuarit u zgjodhën përmes përzgjedhjes rastësore të familjeve dhe vetëm një pjesëtar u intervistua për familje. Kohëzgjatja mesatare e intervistës ishte 12 minuta.

Pyetësi i intervistës kishte pesë pjesë:

1. Tiparet demografike të të intervistuarit;
2. Njohuritë lidhur me sistemin e ndihmës juridike;
3. Besimi në sistemin e drejtësisë;
4. Përvoja me sistemin e drejtësisë përpara procesit gjyqësor; dhe
5. Përvoja me sistemin e drejtësisë gjatë procesit gjyqësor.

Pyetësi i anketës kishte strukturë të ngjashme me pyetësin e hartuar për anketën e familjeve për raportin e qasjes në drejtësi të UNDP-së në vitin 2017⁴⁹. Megjithatë është me vend të theksohet përputhshmëria e kufizuar ndërmjet dy anketave. Ndryshe nga anketa e vitit 2017, anketa e vitit 2024 u përqendrua më shumë në ofrimin e ndihmës juridike. Për më tepër, ndërkohë që studimi i vitit 2017 u zbatua në bashkitë Mat, Përmet, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë, anketa e vitit 2024 u zbatua me kampion kombëtar përfaqësues, dhe përfshiu intervista nga të 13 rajonet gjyqësore të Shqipërisë.⁵⁰


49. Anketë për Qasjen në Drejtësi në Shqipëri UNDP (2017) (Tiranë, UNDP).

50. Sipas Hartës së Re Gjyqësore të Shqipërisë.

1. Përbërja e kampionit

Anketa u zbatua në të 13 rajonet gjyqësore të Shqipërisë.⁵¹ Numri i intervistave në secilin rreth gjyqësor u bazua në popullsinë në moshë madhore në secilin rreth sipas të dhënave të regjistrit civil të vitit 2023, siç paraqitet në Grafikon 1. Në këto rrethe, intervistat u kryen në 30 bashki dhe 43 njësi administrative gjithsej.


GRAFIKU 1 TË INTERVISTUARIT SIPAS RRETHIT GJYQËSOR



(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

Nëse analizohen tre rajonet kryesore gjeografike të Shqipërisë, të paraqitura në Grafikon 2, thuajse gjysma e të intervistuarve jetojnë në rajonin qendror (Durrës, Elbasan dhe Tiranë), ndjekur nga rajoni jugor (Berat, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Sarandë dhe Vlorë) dhe rajoni verior (Dibrë, Kukës, Lezhë dhe Shkodër).

GRAFIKU 2 TË INTERVISTUARIT SIPAS ZONËS GJEOGRAFIKE




(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

51. Sipas Hartës së Re Gjyqësore të Shqipërisë.


Nga 44 Njësitë Parësore të Kampionimit të përzgjedhura për kampionin e anketës kombëtare, 20 prej tyre ishin në zona rurale dhe 24 në zona urbane, ndërsa intervistat u shpërndanë sipas grafikut të mëposhtëm.

GRAFIKU 3 TË INTERVISTUARIT SIPAS LLOJIT TË VENDBANIMIT




Si shpërndarja moshore, ashtu edhe ajo gjinore e të intervistuarve është përfaqësuese e grupmoshave dhe raportit gjinor në rang kombëtar. Si pasojë numri i të intervistuarave gra është thuajse i barabartë me atë të të intervistuarave burra. Kur merret në konsideratë shpërndarja moshore, 39% e kampionit është e grupmoshës 18 - 34 vjeç, 33% e tij është e tij është i grupmoshës 35 - 54 vjeç dhe 28% e tij është i grupmoshës 55 vjeç e lart.

GRAFIKU 4 TË INTERVISTUARIT SIPAS GJINISË




GRAFIKU 5 TË INTERVISTUARIT SIPAS MOSHËS




63% e të intervistuarve kanë partner, nga të cilët 54% janë të martuar dhe 9% jetojnë në partneritete civile. Nga 32% e të intervistuarve që nuk kanë partner, 27% nuk janë martuar ndonjëherë, 4% janë të divorcuar dhe 6% janë të ve. Kur merret në konsideratë te qenit prind, më shumë se gjysma e të intervistuarve (51%) nuk kanë fëmijë. Nga 49% të të intervistuarve që jetojnë në familje me fëmijë, 43% kanë një ose dy fëmijë dhe vetëm 6% raportojnë se kanë tre ose më shumë fëmijë që jetojnë në familje.

GRAFIKU 6 TË INTERVISTUARIT SIPAS GJENDJES CIVILE




GRAFIKU 7 TË INTERVISTUAR SIPAS NUMRIT TË FËMIJËVE NË FAMILJE



(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

12% e të intervistuarve në rang kombëtar raportuan se jetojnë me një person me aftësi të kufizuara. Kjo përqindje është pak më e lartë tek të intervistuarit e grupmoshës 55 vjeç e lart, ndër të cilët 19% raportojnë se jetojnë me një person me aftësi të kufizuara. Për më tepër, 19% e të intervistuarve që jetojnë në rajonin verior të Shqipërisë raportojnë se jetojnë me një person me aftësi të kufizuara.


GRAFIKU 8 TË INTERVISTUARIT SIPAS NUMRIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA QË JETOJNË NË TË NJËJTËN FAMILJE
A KA PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË FAMILJEN TUAJ?



(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

Në rang kombëtar, 7% e të intervistuarve vetëidentifikohen si pjesëtarë të pakicave etnike. Nga këta, 3% identifikohen si romë, 3% si grekë, 0,8% si egjiptianë, 0,5% si maqedonas, dhe 0,1% si vllleh. Shpërndarja moshore e të intervistuarve nga pakicat është si vijon: 29% janë të grupmoshës 18-34 vjeç, 38% të grupmoshës 35-54 vjeç dhe 33% të grupmoshës 55 vjeç e lart. Në kuadrin gjeografik, pjesa më e madhe të intervistuarve nga pakicat banojnë në rajonet qendrore (49%) dhe jugore (46%) të Shqipërisë, dhe vetëm një pjesë e vogël jeton në rajonin verior (5%). Për më tepër, një pjesë e madhe e të intervistuarve nga pakicat jetojnë në zona rurale (66%) krahasuar me zonat urbane (34%).

GRAFIKU 9 TË INTERVISTUARIT SIPAS PAKICAVE



(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

26% e të intervistuarve raportuan se janë me arsim të ulët ose pa arsim. Në këtë grup 3% nuk kanë arsim, 6% kanë përfunduar vetëm arsimin fillor dhe 17% kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët. 46% e të intervistuarve gjithsej kanë arsim të mesëm të lartë, nga të cilët 35% kanë diplomë të arsimit të mesëm të përgjithshëm ndërsa 11% kanë diplomë të arsimit të mesëm profesional. Nga pjesa tjetër prej 28% që kanë arsim të lartë, 26% kanë diplomë universitare dhe vetëm 2% kanë diplomë të nivelit master.

GRAFIKU 10 TË INTERVISTUARIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR




(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

Në grupmoshën 18-34 vjeç, numri i individëve me nivel më të lartë arsimor është konsiderueshëm më i lartë (45%) se sa mesatarja kombëtare (28%). Megjithatë, tek të intervistuarit nga pakicat, numri i atyre me nivel arsimor të mesëm ose të lartë është konsiderueshëm më i ulët, ndërkohë që 68% kanë nivel arsimor të ulët. Gratë janë të arsimuara disi më mirë se burrat, dhe mesatarisht 34% e grave kanë diploma universitare ose pasuniversitare krahasuar me 22% tek burrat. 57% e të intervistuarve deklaruan se janë të punësuar, ku 10% e tyre punojnë në sektorin publik, 23% në sektorin privat, dhe 24% janë të vetëpunësuar. Ndërkohë, 15% deklaruan se ishin punëkërkues të


papunë, dhe 26% deklaruan se nuk ishin ekonomikisht aktivë. Grupi i personave ekonomikisht joaktivë përfshin studentët, pensionistët, shtëpiakët, dhe ata që nuk po kërkojnë punësim. Norma e punëkërkesve është paksa më e lartë tek grupmosha 18-34 vjeç (20%) dhe tek banorët e zonave veriore (19%) krahasuar me mesataren kombëtare prej 15%. Tek të intervistuarit nga pakicat, norma e punëkërkesve është më shumë se dyfish i asaj kombëtare me 33%.

GRAFIKU 11 TË INTERVISTUARIT SIPAS STATUSIT TË PUNËSIMIT




Më shumë se gjysma e kampionit të anketuar deklaroi se ka të ardhura familjare mujore prej 50.000 Lekë ose më pak. Më konkretisht, 14% deklaruan të ardhura mujore prej më pak se 25.000 Lekë dhe 36% deklaruan të ardhura ndërmjet 25.000 dhe 50.000 Lekë. Për më tepër, 22% deklaruan të ardhura familjare mujore ndërmjet 50.000 dhe 100.000 Lekë. Vetëm 8% e të intervistuarve raportuan të ardhura më të larta se 100.000 Lekë, nga të cilët 6% janë në segmentin nga 100.000 deri në 150.000 Lekë dhe 2% kanë të ardhura më të larta se 150.000 Lekë. Vlen të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve (17%) vendosi të mos deklaronte të ardhurat e tyre familjare.

GRAFIKU 12 TË INTERVISTUARIT SIPAS TË ARDHURAVE MUJORE FAMILJARE



Krahasuar me mesataren kombëtare prej 22%, në grupmoshën 18-34 vjeç ka më shumë individë me të ardhura të nivelit të mesëm (30%). Pjesa e atyre që kanë të ardhura më të ulëta se 50,000 Lekë në muaj është në përpjesëtim të zhdrejtë më e lartë tek pakicat (73%) dhe disi më me lartë në rajonin jugor (63%) krahasuar me mesataren kombëtare (53%). Në rang kombëtar, 21% e të intervistuarve pranuan se marrin ndihmë financiare ose sociale nga shteti. Nga këta, 2% marrin pagesa papunësie, 8% marrin pagesa sociale, 8% marrin pagesa aftësie të kufizuar, dhe 3% marrin ndihmë materiale ose financiare në formën e ushqimit, barnave ose produkteve higjienike.

GRAFIKU 13 TË INTERVISTUARIT SIPAS PËRFITIMEVE TË MIRËQENIES



Numri i të intervistuarve që jetojnë në familje që marrin ndihmë për mirëqenien është paksa më i lartë tek pakicat (34%) dhe grupmosha 55 vjeç e lart (31%).


2. Kuptimi dhe perceptimet për ndihmën juridike dhe sistemin e drejtësisë

Të intervistuarve iu drejtuan një sërë pyetjesh me qëllim vlerësimin e njohurive dhe kuptimit të tyre lidhur me sistemin e ndihmës juridike, si dhe perceptimet e tyre lidhur me qasjen dhe besimin në sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Rezultatet e anketës treguan se thuajse një e treta e kampionit të anketuar (29%) kanë dijeni për ekzistencën e shërbimeve të ndihmës juridike falas. Niveli i dijenisë është konsiderueshëm më i lartë tek familjet me të ardhura mesatare dhe të larta; ata që kanë të ardhura ndërmjet 50,000 dhe 100,000 Lekë në muaj dhe ata që kanë të ardhura më të larta se 100,000 Lekë në muaj.

Gjithashtu, individët me nivel më të lartë arsimor, si ata me arsim të lartë dhe ata me diploma të nivelit master, kanë gjithashtu më shumë dijeni. Të rinjtë e grupmoshës 18-34 vjeç,

banorët e rajonit qendror të Shqipërisë, të punësuarit, dhe ata që jetojnë në familje me persona me aftësi të kufizuara kanë gjithashtu më shumë dijeni krahasuar me mesataren kombëtare.


GRAFIKU 14 NDËRGJEGJËSIMI LIDHUR ME SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
A KENI DËGJUAR NDONJËHERË PËR SHËRBIMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS?



Nga ana tjetër, ndërgjegjësimi lidhur me shërbimet e ndihmës juridike falas është qartësisht më i ulët tek të intervistuarit me nivele arsimore më të ulëta, dhe veçanërisht tek ata që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor ose të mesëm të ulët. Qytetarët nga grupet e pakicave, personat e papunë, banorët e rajonit jugor, individët mbi 55 vjeç, ata që jetojnë në familje më të ardhura të ulëta (më pak se 50,000 Lekë në muaj) dhe ata që jetojnë në zona rurale kanë gjithashtu më pak dijeni. 90% e atyre që kanë dijeni për ekzistencën e shërbimeve të ndihmës juridike falas mendojnë se ngritja e këtyre shërbimeve është politikë pozitive. Shumica e atyre që mendojnë se shërbimet e ndihmës juridike falas nuk janë të efektshme, e deklarojnë këtë sepse besojnë se sistemi i drejtësisë në Shqipëri nuk është funksional.


GRAFIKU 15 EFIKASITETI I SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE

MENDONI SE NGRITJA E SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS ËSHTË POLITIKË EFIKASE PËR TË NDIHMUAR QYTETARËT?



70% e atyre që kanë dijeni për ndihmën juridike falas, supozuan pjesërisht saktë se ajo i ofrohet individëve me të ardhura të ulëta. Megjithatë, 26% e këtij grupi gabimisht beson se ndihma juridike falas është për personat që nuk dëshirojnë të paguajnë për avokatin. Vetëm 20% e kuptojnë tërësisht qëllimin e vërtetë të ndihmës juridike falas.

GRAFIKU 16 NJOHURITË PËR GRUPET E SYNUARA TË NDIHMËS JURIDIKE




Analizimi i mëtejshëm i të dhënave të anketës tregon se 68% e të intervistuarve në rang kombëtar besojnë se sistemi i drejtësisë në Shqipëri mbrohet të drejtat e tyre. Nga këta, 14% besojnë se sistemi i mbrohet mjaftueshëm të drejtat e tyre, ndërsa 54% besojnë se ai i mbrohet disi të drejtat e tyre.

Ky nivel besimi është konsiderueshëm më i lartë tek individët me diploma të arsimit të lartë dhe atij pasuniversitar dhe disi më i lartë tek grupmosha 18-34 vjeç. Në kontrast, mosbesimi tek sistemi i drejtësisë është më i pranishëm krahasuar me mesataren kombëtare tek banorët e rajonit verior, familjet me persona me aftësi të kufizuara, pakicat etnike dhe të papunët.

GRAFIKU 17 BESIMI NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË SHQIPËRI


A MENDONI SE SISTEMI I DREJTËSISË NË SHQIPËRI MBRON MJAFTUESHËM TË DREJTAT TUAJA?



Për më tepër, thuajse një e treta (30%) e atyre që dyshojnë në aftësitë e sistemit të drejtësisë për të mbrojtur të drejtat e tyre e lidhin këtë mendim me perceptimin për nivelin e lartë të korrupsionit në sistem.

Kur shqyrtohet aksesueshmëria e perceptuar e sistemit të drejtësisë, 61% e të anketuarve besojnë se sistemi është i aksesueshëm në nivele të ndryshme. 53% mendojnë se sistemi i drejtësisë është disi i aksesueshëm dhe 8% mendojnë se sistemi është shumë i aksesueshëm. Nga ana tjetër, pothuajse 30% e gjejnë sistemin të paaksesueshëm në nivele të ndryshme, me 22% që thonë se është disi i paaksesueshëm dhe 7% që thonë se është shumë i paaksesueshëm. Qasja në sistem perceptohet si më e ulët nga pakicat etnike, të papunët, familjet me persona me aftësi të kufizuara, individët me nivel të ulët arsimor (pa arsim, arsim fillor ose arsim të mesëm të ulët) dhe nga individët 55 vjeç e lart.


GRAFIKU 18 QASJA E PERCEPTUAR NË SISTEMIN E DREJTËSISË



Kur u pyetën lidhur me pengesat kryesore ndaj qasjes në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, kufizimet financiare kryesojnë si pengesa kryesore përmendur nga 61% e të intervistuarve në nivel kombëtar.

GRAFIKU 19 PENGESAT E PERCEPTUARA NË SISTEMIN E DREJTËSISË

CILAT PENGESA MENDONI SE I NDALOJNË NJERËZIT NGA QASJA NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË SHQIPËRI?




(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

Pengesa e dytë është mungesa e informacionit, e identifikuar si e tillë nga 47% e të intervistuarve. Pengesa e tretë për nga shpeshtia dhe e përmendur nga 24% e të intervistuarve është vështirësia për t’iu qasur sistemin për shkak të vendit ku banojnë individët. Pengesa të tjera për t’u përmendur janë: kompleksiteti i proceseve juridike i përmendur nga 22% e të intervistuarve; frika nga pasojat juridike e përmendur nga 21% e të intervistuarve; dhe diskriminimi i përmendur nga 14% e të intervistuarve.

Ndërkohë që kufizimet financiare janë shqetësim i përmendur në nivel të ngjashëm nga të gjitha grupet social-demografike, pengesat e tjera të perceptuara ndryshojnë konsiderueshëm mes këtyre grupeve. Për shembull, mungesa e informacionit, kompleksiteti i proceseve juridike dhe frika nga pasojat juridike përmenden më shpesh nga individët me arsim universitar dhe pasuniversitar, krahasuar me mesataren kombëtare. Në veçanti, mungesa e informacionit perceptohet gjithashtu si pengesë paksa më e madhe tek të intervistuarit që jetojnë në Shqipërinë qendrore (rrethet gjyqësore të Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit).

GRAFIKU 20 PENGESAT E PERCEPTUARA SIPAS FAKTORËVE SOCIAL-DEMOGRAFIKË



Nga ana tjetër, diskriminimi theksohet si pengesë në sistemin e drejtësisë thuajse dy herë më shpesh nga ana e grupeve të pakicave kombëtare, krahasuar me mesataren kombëtare. Për më tepër, vështirësitë lidhur me qasjen në sistemin e drejtësisë për shkak të vendndodhjes gjeografike përmenden theksuar më shpesh nga të intervistuarit


nga pakicat kombëtare dhe ata që jetojnë në veri të Shqipërisë (rajonet gjyqësore të Shkodrës, Kukësit, Lezhës dhe Dibrës).

Bazuar në rezultatet e anketës, 42% e të intervistuarve besojnë se është relativisht e thjeshtë të gjejsh informacion lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Brenda këtij grupi, 32% mendojnë se është disi e thjeshtë, ndërsa 10% mendojnë se është shumë e thjeshtë. Nga ana tjetër, thuajse 25% e të popullsisë mendon se qasja në këtë informacion paraqet shkallë të ndryshme vështirësie.

Gjithashtu, 25% të popullsisë janë më neutral, dhe perceptojnë se procesi i gjetjes së informacionit lidhur me të drejtat e tyre nuk është as i vështirë dhe as i thjeshtë. Kjo shpërndarje opinonesh tregon se ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë mendon se qasja në informacion ligjor është e thjeshtë, një tjetër grup gjithashtu i konsiderueshëm vijon të përballlet me vështirësi. Kjo thekson nevojën e përmirësimit të qasjes në dhe të shpërndarjes së informacionit ligjor.

GRAFIKU 21 QASJA E PERCEPTUAR NË INFORMACION PËR TË DREJTAT DHE DETYRIMET


SIPAS MENDIMIT TUAJ, SA E THJESHTË ËSHTË QË PUBLIKU I GJERË TË MARRË INFORMACION PËR TË DREJTAT DHE DETYRIMET?



(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

Perceptimi i lehtësisë për të gjetur informacion për të drejtat dhe detyrimet ligjore është dukshëm më i lartë tek disa grupe të caktuara. Të rinjtë (grupmosha 18-34 vjeç), individët me nivel më të lartë arsimor (arsim të lartë ose pasuniversitar), dhe të punësuarit priren të mendojnë se qasja në këtë informacion është më e thjeshtë. Në veçanti, këto grupe deklarojnë nivele më të larta vetëbesimi në shqyrtimin e informacionit ligjor.

GRAFIKU 22 QASJA E PERCEPTUAR NË INFORMACION SIPAS FAKTORËVE SOCIAL-DEMOGRAFIKË




Nga ana tjetër, perceptimi i vështirësisë në marrjen e informacionit rreth të drejtave dhe detyrimeve ligjore është më i theksuar tek pakicat etnike, grupmosha 55 vjeç e lart, dhe punëkërkuarët. Këto grupe deklarojnë se përballen me më shumë vështirësi, çka tregon se ata mund të hasin më shumë pengesa, ose të mos kenë burimet për të gjetur në mënyrë të efektshme informacionin e nevojshëm ligjor. Ky dallim thekson nevojën për përpjekje të synuara për përmirësimin e qasjes dhe shpërndarjes së informacionit ligjor për këto grupe të cënueshme.

3. Përvoja me sistemin e drejtësisë


Kjo pjesë e anketës paraqet gjetjet nga pyetjet e anketës që lidhen me përvojat e qytetarëve me sistemin e drejtësisë, në veçanti sa i përket ndërveprimit të tyre me sistemin përpara dhe gjatë proceseve gjyqësore. Këtu trajtohen përpjekjet e qytetarëve lidhur me kërkimin dhe qasjen në informacion ligjor, kontaktin e tyre dhe aksesin në avokatë, si dhe përvojat e tyre gjatë proceseve gjyqësore. Për më tepër, hulumtohen edhe mendimet dhe nivelet e tyre të kënaqësisë me këto përvoja, me mbështetjen e siguruar nga qeveria dhe palë të tjera interesi, dhe perceptimet e tyre lidhur me cilësinë e shërbimeve që u janë dhënë. Kjo pjesë shqyrton edhe nëse të intervistuarit kanë hasur pengesa tek i qasen informacionit ligjor, shërbimeve dhe/ose gjykatës. 13% e të intervistuarve në nivel kombëtar kanë kërkuar informacion për çështje juridike gjatë pesë viteve të fundit. Kërkimi i informacionit ligjor është më i zakonshëm tek individët me të ardhura më të larta (mbi 100,000 Lekë), nivel më të lartë arsimor (arsim të lartë ose pasuniversitar) dhe grupmosha 35-54 vjeç. Është me interes të theksohet se individët që jetojnë me persona me aftësi të kufizuara kanë gjithashtu prirje disi më të larta të kërkojnë informacion ligjor krahasuar me mesataren kombëtare.

GRAFIKU 23 NORMA E KËRKIMIT TË INFORMACIONIT LIGJOR GJATË 5 VITEVE TË FUNDIT KENI KËRKUAR INFORMACION PËR NDONJË ÇËSHTJE JURIDIKE GJATË 5 VITEVE TË FUNDIT?



Nga ana tjetër, individët në rajonin jugor të Shqipërisë kanë kërkuar konsiderueshëm më pak informacion ligjor krahasuar me mesataren kombëtare. Kjo prirje vihet re edhe tek pakicat etnike, çka tregon pabarazi në qasje apo motivim për të kërkuar informacion ligjor tek këto grupe. Çështja më e shpeshtë për të cilën qytetarët kanë kërkuar informacion ligjor është ajo e pronave, ndjekur nga zgjidhja e martesës dhe trashëgimia.

GRAFIKU 24 ÇËSHTJET PËR TË CILAT ËSHTË KËRKUAR INFORMACION JURIDIK




(Baza: Ata që kanë kërkuar informacion. N=156)

Megjithëse të intervistuarve iu lejua të zgjedhin përgjigje të shumëfishta, vetëm një pjesë e vogël statistikore deklaroi se kishin kërkuar ndihmë për çështje si konfliktet me autoritetet publike, krime, borxhe, diskriminim, etj.

Në grupin e atyre që kanë kërkuar informacion ligjor gjatë pesë viteve të fundit, shumica dërmuese përmendën burimet zyrtare si burimin e tyre kryesor të informacionit. Në përgjithësi, në më shumë se 70% të rasteve të intervistuarit kishin kërkuar informacion nga burime zyrtare ose të informuara, si studiot ligjore (30%), qeverisja vendore (21%), gjykatat (13%), qendrat e ndihmës juridike (5%) dhe dhomat e avokatisë (5%). Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve (40%) pranuan edhe se kishin kërkuar informacion për çështje juridike nga miqtë dhe familja, duke theksuar kështu rëndësinë e marrëdhënieve të besimit.


GRAFIKU 25 BURIMET E INFORMACIONIT LIGJOR



(Base: Those who have sought info. N=156)


Shumica dërmuese (73%) e atyre që kanë kërkuar informacion ligjor gjatë pesë viteve të fundit deklaruan se në përgjithësi janë të kënaqur me informacionin e marrë, pavarësisht burimit apo çështjes së veçantë për të cilën iu nevojitej informacioni. Duhet theksuar se një numër i ngjashëm të intervistuarish në këtë nënkampion (74%) deklaruan se informacioni që kishin marrë në ishte në përgjithësi i dobishëm për ta.

GRAFIKU 26 KËNAQËSIA ME INFORMACIONIN E MARRË



(Baza: Ata që kanë kërkuar informacion. N=156)

GRAFIKU 27 EFEKTSHMËRIA E INFORMACIONIT TË MARRË




(Baza: Ata që kanë kërkuar informacion. N=156)

67% e atyre që kishin kërkuar informacion për çështje juridike gjatë 5 viteve të fundit, gjithashtu kontaktuan avokat lidhur me të njëjtën çështje. Dhe nga ata që kishin kontaktuar avokat, shumica (61%) u shprehën të kënaqur me shërbimin e marrë.

GRAFIKU 28 NIVELI I KONTAKTIT ME AVOKAT PAS INFORMIMIT LIGJOR

A JU KËRKUA TË KONTAKTONIT AVOKAT PËR ÇËSHTJEN APO PROBLEMIN TUAJ JURIDIK?




(Baza: Ata që kanë kërkuar informacion. N=156)

60% e individëve që kanë kërkuar informacion ligjor gjatë pesë viteve të fundit kanë vijuar me veprime gjyqësore lidhur me të njëjtën çështje për të cilën ishin informuar. Nga ata që zgjodhën të mos vijnë me veprime gjyqësore pavarësisht se kishin kërkuar informacion, arsyet më të shpeshta të përmendura për mos vijimin e mëtejshëm përfshinin kostot përkatëse, mungesën e relevancës së perceptuar të çështjes në fjalë, vëllimin e dokumentacionit të nevojshëm, kompleksitetin e çështjes juridike, dhe mungesën e provave të mjaftueshme për t'u paraqitur në gjykatë.

GRAFIKU 29 NIVELI I VEPRIMEVE JURIDIKE PAS INFORMIMIT

VENDOSËT TË NDËRMERRNI VEPRIM JURIDIK LIDHUR ME ÇËSHTJEN OSE PROBLEMIN?




(Baza: Ata që kanë kërkuar informacion. N=156)

Norma e atyre që vendosën të ndërmarrin veprime juridike është lehtësisht më e lartë tek gratë (68%) krahasuar me burrat (52%). Sa i përket përvojave në gjykatë, vetëm 9% e të anketuarve në nivel kombëtar pranuan se kanë qenë në gjykatë për një çështje

ligjore në pesë vitet e fundit. Ky raport është disi më i ulët në rajonin jugor të Shqipërisë dhe tek të intervistuarit e papunë. Nga ana tjetër, numri i atyre që kanë qenë në gjykatë në pesë vitet e fundit është paksa më i lartë se mesatarja kombëtare për individët me nivel më të lartë arsimor dhe të ardhura më të larta. Këto gjetje sugjerojnë se niveli arsimor dhe i të ardhurave mund të ndikojnë në mundësinë e angazhimit me sistemin gjyqësor, ndërsa faktorët rajonalë dhe të punësimit mund të përbëjnë pengesa shtesë sa i përket qasjes në procese gjyqësore.


GRAFIKU 30 NIVELI I PËRVOJËS ME GJYKATAT GJATË 5 VITEVE TË FUNDIT

A KENI QENË NË GJYKATË NË 5 VITET E FUNDIT PËR SHKAK TË NJË ÇËSHTJEJE APO PROBLEMI JURIDIK QË KENI PASUR?



Në mënyrë të ngjashme me kërkesat për informacion ligjor, individët që kishin pasur përvoja me gjykatat në pesë vitet e fundit përmendën më shpesh çështjet e pronave si arsyen e paraqitjes së tyre në gjykatë. Arsye të tjera të zakonshme të mosmarrëveshjeve ligjore përfshinin zgjidhjet e martesave dhe trashëgiminë.


GRAFIKU 31 LLOJI I MOSMARRËVESHJES GJYQËSORE



(Baza: Ata që kanë përdorur gjykatën N=113)

Nga individët që kanë pasur përvoja me gjykatën në pesë vitet e fundit, më shumë se gjysma (52%) deklaruan se më parë ishin munduar të zgjidhnin çështjen drejtpërsëdrejti me palën tjetër përpara se të mobilizonin gjykatën. Kjo tregon parapëlqimin e konsiderueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet përmes ndërmjetësimit të drejtpërdrejtë ose mënyrave jo formale, përpara se t'i drejtohen gjykatës.


GRAFIKU 32 RAPORTI I ZGJIDHJES SË ÇËSHTJEVE JASHTË GJYKATËS
PËRPARA SE TË SHKONIT NË GJYKATË, IU DREJTUAT DREJTPËRSËDREJTI PALËS
TJETËR PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES APO PROBLEMIT TUAJ LIGJOR?



Megjithëse është e vështirë të arrihet në përfundime të sakta statistikore nga një kampion kaq i kufizuar, disa prirje vlejné të theksohen. Për shembull, individët që jetojnë në zonat rurale janë më të prirur të zgjidhin mosmarrëveshjet mes tyre para se të shkojnë në gjykatë. Nga ana tjetër, banorët e rajonit verior të Shqipërisë janë më të prirur të shkojnë menjëherë në gjykatë pa u përpjekur të zgjidhin më parë çështjen me palën tjetër.


Kur individët nuk ishin në gjendje të zgjidhnin çështjet e tyre ligjore në mënyrë të pavarur, veprimi i tyre kryesor ishte të kontaktonin me një avokat. Kjo ishte përgjigja më e shpeshtë ndër personat që kishin mosmarrëveshje në gjykata në pesë vitet e fundit. Përgjigja e dytë në radhë nga shpeshtia ishte këshillimi me pjesëtarët e familjes apo miqtë. 18% e të intervistuarve kërkuan ndihmë nga qendrat e ndihmës juridike apo zyrat e qeverisjes vendore në zonën e tyre.

GRAFIKU 33 VEPRIMET FILLESTARE TË NDËRMARRA NË PAMUNDËSI
TË ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJES LIGJORE VETË



Më shumë se ¾ e atyre që kanë pasur përvoja në gjykata gjatë 5 viteve të fundit, deklaruan se janë trajtuar drejtë në gjykatë. Në mënyrë të ngjashme, 67% e të njëjtit grup të intervistuarish deklaruan se u ndjenë të respektuar nga gjyqtari, ndërkohë që 80% thanë se u ndjenë të kuptuar, dhe 85% thanë se iu dha mundësia të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre në gjykatë.


GRAFIKU 34 DEKLARATA PËR GJYKATËN NR. 2



(Baza: Ata që kanë përdorur gjykatën N=113)

Pavarësisht kësaj, kur të intervistuarit nga i njëjti nënkampion u pyetën për shqetësimet si pasojë e mosmarrëveshjeve të tyre, të dhënat flasin për ndikime të konsiderueshme. Nga ata që kanë qenë të përfshirë në çështje gjyqësore në pesë vitet e fundit, një pjesë e konsiderueshme (74%) shprehën se kanë përjetuar stres për shkak të mosmarrëveshjeve të tyre në gjykatë. Stresi është ndikimi i përmendur më shpesh, çka tregon se procesi gjyqësor shpesh rezulton në një ngarkesë psikologjike të konsiderueshme.

GRAFIKU 35 PËRVOJAT SI PASOJË E MOSMARRËVESHJES GJYQËSORE




(Baza: Ata që kanë përdorur gjykatën N=113)

Përveç stresit, përvojat e tjera negative të përmendura shpesh përfshijnë humbjet financiare të raportuara nga 36% e të intervistuarve, ndërkohë që frika është gjithashtu përvojë e zakonshme që ndikon 24% të të anketuarve. Për më tepër, 33% e individëve që kishin qenë në gjykatë në pesë vitet e fundit u shprehën se kanë përjetuar një prej pasojave negative më poshtë si rezultat i mosmarrëveshjes së tyre: shëndet të dobët, humbje të vetëbesimit, ose dëmtim të marrëdhënieve familjare. Këto gjetje ilustrojnë pasojat më të gjera dhe më personale të mosmarrëveshjeve, të cilat shkojnë përtej shqetësimeve të menjëhershme ligjore dhe financiare dhe ndikojnë shëndetin, vetëvlerësimin dhe lidhjet familjare.

Gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të informojnë qytetarët lidhur me të drejtat e tyre në fillim të procesit, përfshirë të drejtën për përfaqësim ligjor falas nëse nuk kanë mundësi të paguajnë një avokat. 63% e atyre që kanë pasur çështje në gjykatë gjatë pesë viteve të fundit deklaruan se ata e kanë marrë këtë informacion nga gjyqtari.


GRAFIKU 36 SHPJEGIMI I TË DREJTËS PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS NGA GJYQTARËT

A JU SHPJEGOI GJYQTARI NË FILLIM TË PROCESIT TË DREJTAT TUAJA, PËRFSHIRË TË DREJTËN TË PËRFAQËSOHENI ME AVOKAT FALAS NËSE NUK KENI MUNDËSI TË PAGUANI PËR TË?



Sa i përket ndihmës juridike, vetëm 24% e individëve që kishin përvojë në gjykatë gjatë pesë viteve të fundit deklaruan se kualifikoheshin për këtë ndihmë. Pavarësisht se shumë të intervistuar thanë se gjyqtari i kishte shpjeguar të drejtën për ndihmë juridike falas, thuajse një e treta (29%) e të njëjtit grup deklaruan se ata ishin të paqartë nëse kualifikoheshin për ndihmë juridike.


GRAFIKU 37 KUALIFIKIMI PËR NDIHMË JURIDIKE
A KUALIFIKOHESHIT PËR NDIHMË JURIDIKE?



Pavarësisht përvojës së tyre përpara apo gjatë procesit gjyqësor, të anketuarit në nivel kombëtar u pyetën lidhur me arsyet e mundshme që mund t'i shtynin të mos shkonin në gjykatë në të ardhmen. Një pjesë e konsiderueshme (59%) përmendën kostot si faktor parësor. Arsyeja e dytë më e përmendur ishte mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë,

ku 39% e të intervistuarve e përmendën këtë si shqetësim. Më tej, 11% e të anketuarve përmendën mungesën e besimit se do të gjenin ndihmën e duhur, nëse do t'u nevojitej kjo ndihmë. Arsye të tjera përfshinin mungesën e telefonit celular apo internetit (8%), frikën nga trauma (6%), mungesën e kohës (6%), faktin që nuk ndiheshin të kuptuar nga avokatët apo profesionistët e tjerë të fushës (5%), aftësinë e kufizuar dhe/ose të jetuarin në zonë të largët (3%). Së bashku, këto përgjigje nënvizojnë pengesat e ndryshme individuale, logjistike dhe sistematike që mund të pengojnë individët të kërkojnë zgjidhje në rrugë ligjore.

GRAFIKU 38 FAKTORËT QË MUND TË PENGJOJNË NË MARRJEN E VEPRIMEVE LIGJORE NË TË ARDHMEN



(Baza: Kampioni Kombëtar N=1206)

Ndryshimet mes përgjigjeve tek grupet e ndryshme social-demografike në kampionin kombëtar janë statistikisht të papërfillshme, me disa përjashtime që vlejnë të theksohen. Mosbesimi në sistemin e drejtësisë është konsiderueshëm më i lartë tek punëkërkesit e papunë (50%) krahasuar me mesataren kombëtare prej 39%.

Për më tepër, pakicat etnike deklaruan shqetësime të veçanta. Një pjesë e madhe (13%) e pakicave etnike besojnë se avokatët dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve juridike nuk i kuptojnë, krahasuar me mesataren kombëtare prej 5%. Për më tepër, 11% e pakicave etnike shprehën shqetësim lidhur me traumën e mundshme nga proceset gjyqësore, përqindje kjo më e lartë se mesatarja kombëtare prej 6%.

4. Përfundimet kyçe nga anketa e familjeve

Ndërgjegjësimi dhe perceptimet:

1. Thuajse 1/3 (29%) e popullatës së anketuar janë të ndërgjegjësuar për sistemin e ndihmës juridike falas. Ndërgjegjësimi është dukshëm më i lartë tek familjet me të ardhura të mesme dhe të larta dhe tek individët me nivel më të lartë arsimor.
2. Ndërgjegjësimi është konsiderueshëm më i ulët tek të anketuarit nga grupet e pakicave, dhe ata me nivele më të ulëta arsimore.
3. 90% e individëve që janë në dijeni të këtyre shërbimeve e konsiderojnë ngritjen e sistemit të ndihmës juridike falas si politikë pozitive.

Besimi në sistemin e drejtësisë:

4. 68% besojnë se sistemi i drejtësisë në Shqipëri mbron të drejtat e tyre, veçanërisht individët me nivele arsimore më të larta dhe të rinjtë (18-34 vjeç).
5. Mosbesimi është më i theksuar te banorët në veri të vendit, pakicat, të papunët dhe familjet me pjesëtarë me aftësi të kufizuara.
6. Thuajse një e treta e individëve që janë skeptikë lidhur me sistemin e drejtësisë përmendin korrupsionin e lartë si arsye.

Qasja dhe pengesat:

7. Kufizimet financiare perceptohen si pengesa kryesore ndaj qasjes në sistemin e drejtësisë (61%) ndjekur nga mungesa e informacionit (47%), kompleksiteti i proceseve gjyqësore (22%) dhe frika nga pasojat juridike (11%).
8. 42% e të anketuarve besojnë se të gjesh informacion lidhur me të drejtat e tyre është relativisht e thjeshtë, ndërsa një e treta e tyre besojnë se është e vështirë.

Informacioni ligjor dhe përvoja në gjykatë:

9. 13% e të anketuarve kanë kërkuar informacion ligjor gjatë pesë viteve të fundit, dhe ata me nivele më të larta të ardhurash dhe arsimit kanë kërkuar informacion më shpesh.
10. Informacioni i kërkuar më shpesh lidhet me çështjet e pronës, zgjidhjes së martesës dhe trashëgimisë, ndërkohë që shumë individë i drejtohen miqve dhe të njohurve për këshillim. (2)
11. 60% e atyre që kanë kërkuar informacion ligjor vijuan më pas me veprime juridike, ku 52% bënë përpjekje për zgjidhje të drejtpërdrejtë me palën kundërshtare përpara se t'i drejtoheshin gjykatës. (2)
12. Vetëm 9% e të anketuarve i janë drejtuar gjykatës për një çështje ligjore në pesë vitet e fundit, dhe më shpesh në lidhje me mosmarrëveshjet mbi pronën. (2)
13. Më shumë se tre të katërtat e atyre që kanë pasur përvojë në gjykatë janë ndjerë të trajtuar në mënyrë të drejtë dhe me respekt nga gjyqtari, dhe se u është dhënë mundësi për të shprehur mendimin e vet.
14. Pavarësisht kësaj, 74% kanë përjetuar stres për shkak të mosmarrëveshjeve të trajtuara në gjykatë, ndërsa 33% janë përballur me probleme shëndetësore, humbje të vetëbesimit ose përkeqësim të marrëdhënieve familjare.
15. 63% e atyre me përvojë në gjykata raportuan se gjyqtarët u shpjeguan të drejtat e tyre, përfshirë të drejtën për përfaqësim ligjor falas.
16. Megjithatë, 29% janë ende të paqartë nëse kualifikohen për ndihmë juridike. (2)

B. SONDAZHI PËRMES INTERNETIT


Me qëllim mbledhjen e këndvështrimeve dhe qëndrimeve të ofruesve të NJF-së dhe profesionistëve të tjerë lidhur me përvojat e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve u hartua një sondazh përmes internetit. Ky sondazh synonte profesionistët e fushës dhe profesionistët të tjerë që punojnë me ndihmën juridike. Në sondazh morën pjesë 139 individë gjithsej. Pyetësi i sondazhit iu qarkullua të 61 bashkive dhe përbëhej nga 52 pyetje lidhur me administrimin, bashkërendimin dhe sigurimin e cilësisë së NJF-së. Sondazhi u nda në tre pjesë:

1. Informacion lidhur me rolin, vendndodhjen dhe vjetërsinë në punë të të anketuarit;
2. Funksionimin e ofrimit të ndihmës juridike parësore; dhe
3. Funksionimin e ofrimit të ndihmës juridike dytësore.

1. Përbërja e kampionit

Të dhënat e sondazhit tregojnë se në të morën pjesë profesionistë nga 12 qarqe. Shumica dërmuese e të anketuarve janë të vendosur në qarqet e Tiranës (23%), Durrësit (20%) dhe Korçës (14%). Për më tepër, rreth 5% e të anketuarve ishin nga secili prej qarqeve të mëposhtme: Berat, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Shkodër, dhe Vlorë.


GRAFIKU 39 TË ANKETUARIT SIPAS QARQEVE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)


Sondazhi u plotësua nga të anketuar nga 44 bashki të ndryshme. Duhet theksuar se një pjesë e konsiderueshme e kampionit ishte nga Tirana dhe Durrësi. Nëse analizohen sipas lidhjes së tyre me shërbimet e ndihmës juridike, të anketuarit mund të ndahen në dy grupe kryesore: ofrues të ndihmës juridike falas (19%) dhe punonjës të strukturave të qeverisjes vendore të cilët referojnë dhe ndihmojnë me rastet e ndihmës juridike (81%). Grupi i parë përfshin punonjësit publikë në qendrat e ndihmës juridike (9%), personelin e OJF-ve të autorizuar të ofrojnë ndihmë juridike (8%) dhe pjesëtarët e stafit akademik (1%). Grupi i dytë përfshin punonjësit socialë në bashki (65%) të cilët përbëjnë grupin më të madh të profesionistëve në kampion, psikologët në bashki (7%) dhe zyrtarë të tjerë të strukturave të qeverisjes vendore (6%) si personelin e drejtorive juridike të institucioneve vendore dhe administratorët shoqërorë.

GRAFIKU 40 TË ANKETUARIT SIPAS LIDHJES ME NDIHMËN JURIDIKE FALAS



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)


GRAFIKU 41 TË ANKETUARIT SIPAS PROFESIONIT



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Shumica e të anketuarve ishin profesionistë me 3-10 vite përvojë (43%), ndjekur nga profesionistët e rinj me përvojë deri në 3 vite (33%), ndërsa rreth një e pesta ishin profesionistë me shumë se 10 vite përvojë (23%).

GRAFIKU 41 TË ANKETUARIT SIPAS PËRVOJËS




(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

2. Ndihma juridike parësore

Kur u pyetën lidhur me kënaqësinë e tyre me qasjen në shërbimet e ndihmës juridike në Shqipëri, shumica e të anketuarve shprehën mendim pozitiv. Më konkretisht, 25% ishin shumë dakord me deklaratën “Në përgjithësi jam i kënaqur me mënyrën se si individët mund t’i qasen shërbimeve të ndihmës juridike në Shqipëri”, ndërsa 58% ishin disi dakord me këtë, duke treguar kënaqësi të përgjithshme me qasjen në këto shërbime.


GRAFIKU 42 KËNAQËSIA ME QASJEN NË NDIHMËN JURIDIKE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Të anketuarit treguan se zakonisht qytetarët informohen për ndihmën juridike përmes burimeve të ndryshme. Burimi i përmendur më shpesh ishte bashkia. Megjithatë, ky rezultat duhet të interpretohet me kujdes, sepse shumica e të anketuarve ishin punonjës të bashkisë, çka mund të sjellë anshmëri bazuar në përvojat e tyre personale. Burimi i dytë më i zakonshëm ishin bisedat me bashkëqytetarët (51,9%), çka korrespondon edhe me gjetjet e anketës kombëtare të familjeve. Burime të tjera me rëndësi përfshijnë qendrat e ndihmës juridike (47%), mediat sociale (46%), shërbimet e kujdesit shoqëror (37%), OJF-të (32%), faqet e internetit (29%), studiot ligjore (28%), komisaritet e policisë (26%), linjat e këshillimit pa pagesë (23%), televizionin, radion dhe shtypin (22%), gjykatat (19%), burimet e shtypura (14%) dhe shërbimet telefonike (14%). Për më tepër, disa të anketuar përmendën klinikat ligjore të universiteteve (5%), dhomat e avokatisë (4%) dhe sindikatat (2%).


GRAFIKU 44 SI INFORMOHEN QYTETARËT PËR NDIHMËN JURIDIKE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Sipas të dhënave të mbledhura nga sondazhi përmes internetit, kur qytetarët kontaktojnë për herë të parë ofruesit e ndihmës juridike, ata kryesisht kërkojnë informacion bazë për zgjidhjen e çështjes së tyre juridike (73%) dhe hollësi për shërbimet e ndihmës juridike (60%). Në raste më të rralla ata kërkojnë informacion për strehëzat për gratë (22%), alternativat për ndihmë juridike, si ndërmjetësimi (21%) dhe shërbime të shëndetit mendor (11%).


GRAFIKU 45 INFORMACIONI I KËRKUAR ZAKONISHT KUR KONTAKTOHEN OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Të anketuarit shprehën se informacioni për ndihmë juridike ose këshillimi për çështje juridike ofrohet kryesisht nga qendrat e ndihmës juridike (70%), avokatët (49%), punonjësit socialë (47%), OJF-të (37%), zyrtarët publikë (25%), klinikat ligjore të universiteteve (11%) dhe gjyqtarët (9%).

GRAFIKU 46 OFRUESIT E INFORMACIONIT PËR NDIHMË /KËSHILLIM JURIDIK PËR ÇËSHTJE JURIDIKE




(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Nga të anketuarit që deklaruan se e ofrojnë personalisht këtë informacion (26% e të gjitha përgjigjeve, ose 34 të anketuar gjithsej), 10 janë punonjës publikë në qendrat e ndihmës juridike, 5 punojnë në OJF të autorizuar për të ofruar ndihmë juridike, 15 janë punonjës socialë në bashki, dhe 4 janë punonjës të tjerë të bashkisë si psikologë ose juristë. Shumica dërmuese e të anketuarve (86%) u shprehen përgjithësisht të kënaqur me cilësinë e këshillave juridike parësore të ofruara, ndërsa më pak se një përqind u shprehën të pakënaqur me cilësinë.

Udhëzimet e brendshme për ofruesit e ndihmës juridike janë instrument i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike. Megjithatë, krijohet përshtypja se këto udhëzime nuk janë të disponueshme ose përdorura gjerësisht. Vetëm një në katër të anketuar është në dijeni të udhëzimeve, ndërsa 54% e tyre nuk janë në dijeni. Për më tepër, 17% nuk janë të sigurt nëse këto udhëzime ekzistojnë. Dijenia për këto udhëzime është ndjeshëm më e lartë tek punonjësit e qendrave të ndihmës juridike, 67% e të cilëve shprehen se janë në dijeni të udhëzimeve, krahasuar me vetëm 7% të punonjësve të strukturave të bashkisë. Kjo mospërputhje vë në dukje nevojën për shpërndarjen dhe zbatimin më të mirë të udhëzimeve të brendshme për të siguruar cilësi të njëtrajtshme të shërbimeve të ndihmës juridike.


GRAFIKU 47 DIJENIA PËR UDHËZIMET NDIHMËSE PËR OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE

JENI NË DIJENI TË NDONJË UDHËZIMI ZYRTAR QË NDIHMON OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE TË TRAJTOJË QYTETARËT QË KËRKOJNË INFORMACION DHE/OSE KËSHILLA JURIDIKE FILLESTARE?




Bazuar në rezultatet e sondazhit, duket se qytetarët kërkojnë shpesh këshilla juridike për çështje të tilla si zgjidhje e martesës (68%), dhuna në familje ose dhuna seksuale (63%), mosmarrëveshje për tokën ose pronat (50%) dhe çështje që lidhen me pensionin (47%). Nga ana tjetër, çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin (13%) dhe migracionin (12%) janë më të rralla. Nëse analizohen përgjigjet duke marrë në konsideratë lidhjen e të anketuarve me shërbimet e ndihmës juridike, është e qartë se ofruesit e ndihmës juridike përmendin pensionin (71%), zgjidhjen e martesës (83%), dhe rastet e lidhura me pronat (71%) më shpesh se punonjësit e bashkisë, të cilët i raportojnë më pak këto lloje çështjesh (pensionet 47%, zgjidhjen e martesës 68%, dhe pronën 47%). Kjo mospërputhje sugjeron se punonjësit e qendrave të ndihmës juridike përballen me numër më të madh rastesh që përfshijnë pensionet, zgjidhjen e martesës dhe mosmarrëveshjet për pronat krahasuar me kolegët e tyre në bashki.

GRAFIKU 48 ÇËSHTJET LIGJORE PËR TË CILAT QYTETARËT KËRKOJNË KËSHILLIM



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

GRAFIKU 49 VENDNDODHJET IDEALE PËR T'U QASUR SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE




(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Shumica e të intervistuarve janë dakord se shërbimet e ndihmës juridike duhet të aksesohen idealisht përmes pikave vendore të kontaktit në qendrat e ndihmës juridike falas (65%) dhe ekipeve të lëvizshme që ndërgjegjësojnë qytetarët në vendndodhje me frekuentim të lartë si supermarketet, bashki dhe shkolla të mesme (50%). Alternativa të tjera të përdorura përfshinin linjat e këshillimit pa pagesë (44%), mediat sociale dhe OJF-të (të dyja me 41%), asistentët virtualë dhe bisedat me bashkëqytetarët (të dyja me 38%), portalet në internet dhe burimet e shtypura (të dyja me 35%), programet televizive, radiofonike dhe shtypin (të tria me 31%) dhe komisaritet e policisë (27%). Alternativat më pak të përdorura ishin studiot ligjore, dhomat e avokatisë, gjykatat dhe klinikat ligjore në universitete. Të anketuarit në zonat rurale parapëlqyen më shumë bisedat me bashkëqytetarët dhe burimet e shtypura.

Sipas të anketuarve, personat me aftësi të kufizuara marrin informacion për ndihmën juridike dhe këshillimin juridik fillestar kryesisht përmes pikave vendore të kontaktit në qendrat e ndihmës juridike falas (68%) dhe ekipeve të lëvizshme (50%). Metoda të tjera të zakonshme përfshijnë linjat e këshillimit pa pagesë, mediat sociale, bisedat me bashkëqytetarët, portalet në internetit, dhe burimet e shtypura.


GRAFIKU 50 QASJA NË SHËRBIME TË NDIHMËS JURIDIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Më pas në sondazh, pjesëmarrësit u pyetën lidhur me burimet përmes të cilave, në përvojën e tyre, pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, viktimat e dhunës në familje, dhe azilkërkuesit ose refugjatët marrin informacion për ndihmën juridike dhe këshillimin juridik fillestar. Rezultatet e këtyre tre pyetjeve paraqiten në Grafikun 15. Për komunitetin rom dhe egjiptian, të intervistuarit shprehën se burimi kryesor i informacionit ishte bashkia (63%) dhe bisedat me bashkëqytetarët (53%) ndjekur nga qendrat e ndihmës juridike dhe OJF-të (të dyja me 39%), qendrat e mbështetjes dhe kujdesit shoqëror (39%), media sociale (24%) dhe programet televizive e radiofonike dhe shtypi i shkruar (17%). Të intervistuarit raportuan se viktimat e dhunës në familje ose asaj seksuale merrnin kryesisht informacion për ndihmën juridike dhe këshillim juridik fillestar përmes bashkisë (74%), qendrave të ndihmës juridike (47%), qendrave të mbështetjes dhe kujdesit shoqëror (43%), bisedave me bashkëqytetarët (39%), komisarateve të policisë (37%), mediave sociale (31%), dhe linjave të ndihmës (29%).


GRAFIKU 51 QASJA NË SHËRBIME TË NDIHMËS JURIDIKE PËR KOMUNITETIN ROM DHE EGJIPTIAN, VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Të anketuarit janë kryesisht në mbështetje të një bashkëpunimi më të ngushtë me ofruesit e tjerë të ndihmës juridike. Në total, 95% e të anketuarve janë dakord për bashkëpunimin me ndërmjetësit, kur 82% janë shumë dakord, dhe 14% disi dakord. E njëjta përqindje (95%) është në mbështetje të bashkëpunimit me OJF-të, ku 82% e të anketuarve janë shumë dakord dhe 13% janë disi dakord. Mbështetja për forcimin e bashkëpunimit me klinikat ligjore është gjithashtu e lartë, me 86% të kampionit që bie tërësisht dakord. Megjithatë, përqindja e atyre që janë shumë dakord (65%) është ndjeshëm më e ulët krahasuar me dy rastet e tjera.


GRAFIKU 52 MENDIMET PËR BASHKËPUNIMIN ME AKTORË TË NDRYSHËM PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE JURIDIKE
KA KUPTIM QË BASHKËPUNIMI ME NDIHMËSIT TË FORCOHET NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Kur u pyetën sa dakord janë me pohimin se bashkëpunimi ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike si avokatët, OJF-të, klinikat ligjore në universitete dhe organizatat që mbështesin viktimat e dhunës në familje është i efektshëm, gjysma e të anketuarve ishin shumë dakord (52%), ndërsa një e treta (29%) ishin disi dakord.

GRAFIKU 53 DAKORDËSIA LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NDËRMJET OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE
OFRUESIT E NDIHMËS SI AVOKATËT, OJF-TË, KLINIKAT LIGJORE DHE TË TJERË SI ORGANIZATAT QË
MBËSHTESIN VIKTIMAT E DHF BASHKËPUNOJNË MIRË MES TYRE




(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Megjithatë, vetëm 38% e të anketuarve shprehën se bashkëpunojnë shpesh me ndërmjetësit, ndërsa 35% e tyre u shprehën se bashkëpunojnë ndonjëherë me ta. Këto të dhëna tregojnë mungesë të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike, gjyqtarëve dhe ndërmjetësve.

Nga ana tjetër, shumica dërmuese e të anketuarve (83%) ranë dakord se avokatët dhe gjyqtarët në veçanti, duhet të bashkëpunojnë më shumë me ndërmjetësit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës.


GRAFIKU 54 SHPESHTIA E BASHKËPUNIMIT ME NDËRMJETËSIT
HOW FREQUENTLY DO YOU COLLABORATE WITH MEDIATORS?



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Sa i përket referimeve tek ofruesit e ndihmës juridike, të anketuarit deklaruan se punonjësit socialë (75%) dhe qendrat e mbështetjes shoqërore (60%) janë burimi kryesor i referimeve. Burime të tjera me rëndësi përfshijnë policinë, (49%), OJF-të (47%), vetë të intervistuarit (46%), dhe zyrtarët publikë (45%). Në përvojën e tyre avokatët (24%), gjyqtarët (15%), dhe klinikat ligjore në universitete (13%) kanë numrin më të ulët të referimeve. Këto të dhëna theksojnë rolin kritik të punonjësve socialë dhe të qendrave të kujdesit shoqëror lidhur me drejtimin e individëve tek shërbimet e ndihmës juridike, ndërkohë që gjithashtu theksojnë rolin më pak aktiv që luajnë profesionistët juridikë dhe institucionet akademike lidhur me referimet.

GRAFIKU 55 BURIMET E REFERIMIT TEK OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE




(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Ndër të anketuarit që deklaruan se bëjnë referime si pjesë e punës së tyre, 65% janë punonjës socialë në bashki, dhe 15% të tjerë janë punonjës të tjerë të bashkisë, si psikologë. Ndërkohë që 93% e të anketuarve deklaruan se janë të ndërgjegjshëm për nevojat e grupeve të cënueshme si viktimat e dhunës në familje, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, romët, egjiptianët, komuniteti LGBTIQ+ dhe refugjatët, vetëm 37% deklarojnë se janë të dijeni të programeve ndërgjegjësuese për ofruesit e ndihmës juridike lidhur me nevojat e grupeve të cënueshme.


GRAFIKU 56 DIJENIA PËR PROGRAMET NDËRGJEGJËSUESE LIDHUR ME NEVOJAT E GRUPEVE TË CENUESHME

A KENI DIJENI PËR TË PAKTËN NJË PROGRAM SENSIBILIZIMI PËR OFRUESIT E NDIHMËS JURIDIKE LIDHUR ME NEVOJAT E GRUPEVE TË CENUESHME?



Kur u pyetën ku referohen më shpesh grupet e cenuseshme, të anketuarit kryesisht përmendën punonjësit socialë (58%), qendrat e ndihmës juridike (56%) dhe OJF-të (43%). Thuajse një në tre të anketuar (29%) deklaruan se i referojnë individët e cenuseshëm tek avokatët, ndërsa ka më pak referime drejt gjykatës (12%) apo klinikave ligjore të universiteteve (6%).


GRAFIKU 57 REFERIMI I GRUPEVE TË CENUESHME



Grupi më i madh i të anketuarve (47%) janë të bindur se ofruesit e këshillimit juridik fillestar janë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme. Ndërkohë që 20% besojnë ofruesit e këshillave juridike fillestare nuk janë të trajnuar mjaftueshëm, duhet theksuar se një në tre të anketuar nuk kishin


informacion për këtë çështje. Nuk ka dallime të konsiderueshme në raportin e përgjigjeve për këtë pyetje ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike dhe punonjësve të strukturave publike vendore.

GRAFIKU 58 MENDIMI PËR NIVELIN E TRAJNIMIT TË OFRUESVE TË KËSHILLIMIT FILLESTAR NË PËRVOJËN TUAJ A JANË TË TRAJNUAR MJAFTUESHËM OFRUESIT QË JAPIN INFORMACION DHE KËSHILLIM JURIDIK FILLESTAR PËR TË KRYER FUNKSIONET E TYRE PROFESIONALE?



Në mënyrë të ngjashme, 48% e të anketuarve besojnë se ofruesit janë të trajnuar mjaftueshëm për të këshilluar grupet e cenuseshme, si viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, 17% nuk janë dakord dhe 35% nuk kanë mendim lidhur me këtë çështje. Të anketuarit deklaruan se marrin pjesë në aktivitete trajnimi si seminare pune (81%) dhe se mbështeten tek diskutimet informale me kolegët (32%) për të përditësuar informacionin e tyre. Vetëm një e treta e të anketuarve (29%) kanë marrë pjesë në programe të akredituara të zhvillimit profesional.

GRAFIKU 59 MËNYRAT PËR PËRDITËSIM NË FUSHËN E SË DREJTËS




(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

3. Ndihma juridike dytësore

Shumica e të anketuarve bien dakord se gjyqtarët i informojnë qytetarët lidhur me të drejtat e tyre për ndihmë juridike (68%). Një në pesë të anketuar nuk e di nëse gjyqtarët e përmbushin këtë detyrë. Kjo normë korrespondon me të dhënat e mbledhura nga anketa e familjeve ku më shumë se 60% e personave që kishin pasur përvojë me gjykatën gjatë 5 viteve të fundit deklaruan se ishin informuar nga gjyqtari lidhur me të drejtën për ndihmë juridike.


GRAFIKU 60 MENDIME MBI INFORMIMIN NË GJYKATË, PROCEDURAT E APLIKIMIT, KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE VËSHTIRËSITË PËR KËRKUESIT
A JENI DAKORD ME POHIMET E MËPOSHTME



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Një pjesë e madhe të anketuarve ishin dakord se procedura e aplikimit për ndihmë juridike është e thjeshtë dhe e qartë (71%), dhe një numër i ngjashëm beson se kriteret e kualifikimit për ndihmë juridike janë të drejta (72%). Megjithatë, 56% e të anketuarve pranuan se shpesh kërkuesit e ndihmës juridike përballen me vështirësi kur aplikojnë, ndërsa rreth një në katër prej tyre (24%) nuk ishin të sigurt për këtë. Shumica e të anketuarve që nuk ishin të sigurt ishin punonjës të strukturave publike vendore, ndërsa ofruesit e ndihmës juridike kishin më shumë dijeni për çështjen, ku më shumë se 80% ishin dakord se kërkuesit përballen me vështirësi. Kur merren në konsideratë grupet e cënueshme, shumica e të anketuarve (61%) ishin dakord se avokatët përballen me vështirësi gjatë trajtimit të rasteve që lidhen me këto grupe. Një numër më i vogël të anketuarish (56%) janë dakord se gjyqtarët përballen me vështirësi kur punojnë me grupe të cënueshme. Kjo tregon se të anketuarit janë të mendimit që si avokatët ashtu edhe gjyqtarët përballen me vështirësi të konsiderueshme kur trajtojnë nevojat e grupeve të cënueshme në sistemin e drejtësisë.


GRAFIKU 61 PERCEPTIMET E TRAJTIMIT TË DREJTË DHE VËSHTIRËSIVE NË OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

63% e të anketuarve besojnë se në përgjithësi gjyqtarët dhe avokatët punojnë mirë së bashku për çështjet e ndihmës juridike, ndërsa 23% nuk janë të sigurt. Për më tepër, 71% mendojnë se procedura aktuale e përzgjedhjes së avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike është e drejtë, ndërsa 20% shprehin pasiguri lidhur me këtë. Nuk ka dallime të konsiderueshme sa i përket këtyre pikëpamjeve ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike dhe punonjësve të strukturave publike vendore. Kur u pyetën lidhur me kriteret për përzgjedhjen e avokatëve për çështjet juridike, të anketuarit i dhanë përparësi aftësive (72%), ndjekur nga formimi juridik dhe specializimi (të dyja me 50%) dhe pjesëmarrja në edukim të vazhduar juridik (38%). Sa i përket rasteve të ndihmës që përfshijnë grupe të cënueshme, përgjigjet ishin të ngjashme, ndërkohë që 65% e të anketuarve theksojnë edhe rëndësinë e trajnimit të specializuar për trajtimin e çështjeve të grupeve të cënueshme.


GRAFIKU 62 KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E AVOKATIT TË NDIHMËS JURIDIKE



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

50% e të anketuarve përmendën trajtimin e çështjeve të ndihmës juridike të lidhura me të drejtën familjare në gjykatë, ndjekur nga 29% për çështjet e së drejtës pronësore, dhe 22% për çështjet e së drejtës së pensioneve. E drejta e punësimit u përmend nga 13%, kontratat dhe detyrimet nga 12% dhe migracioni nga 11%.


GRAFIKU 63 FUSHAT E SË DREJTËS NË TË CILAT OFROHET PËRFAQËSIM MË I SHPESHTË



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)

Kur u pyetën për arsyet përse ofrimi i ndihmës juridike kërkon kohë për avokatët, shumica e të anketuarve u përgjigjën se kërkuarit e ndihmës juridike nuk janë gjithmonë të qartë nëse kualifikohen për ndihmë juridike (41%). Arsye të tjera përfshijnë vështirësinë e kërkuarve të ndihmës juridike në plotësimin e formularit të aplikimit (34%), sigurimin e shumë dokumenteve mbështetës (32%), dhe faktin që kërkuarit nuk dinë ku të sigurojnë dokumentet e kërkuara (23%). Disa prej përgjigjeve janë më të shpeshta tek ofruesit e ndihmës juridike se sa tek kampioni në përgjithësi. Për shembull, një në katër (25%) ofrues të ndihmës juridike përmendën se kërkuarit që nuk marrin informacion për ndihmën juridike në gjuhën që ata dëshirojnë është faktor që merr kohë. Në përgjithësi, të anketuarit ishin më së shumti dakord se qytetarëve u caktohet shpejt avokati i ndihmës juridike për çështjen e tyre (71%). Vetëm një pjesë e vogël nuk është dakord me këtë pohim, ndërsa të tjerët nuk shprehën mendim lidhur me këtë çështje.


GRAFIKU 64 MENDIMET PËR ÇAKTIMIN E AVOKATËVE
INDIVIDËVE U ÇAKTOHET SHPEJT AVOKAT I NDIHMËS JURIDIKE PËR ÇËSHTJET E TYRE:



(Baza: Të gjithë të anketuarit N=133)


Kur u pyetën për metodat ideale për sigurimin e cilësisë së shërbimit të avokatëve, shumica e palëve të interesit të ndihmës juridike që morën pjesë në sondazh theksuan trajnimin e vazhduar të detyrueshëm për ndihmën juridike (41%). Metoda të tjera të përmendura shpesh përfshijnë vlerësimin mes kolegëve nga ana e dhomës së avokatisë (38%) dhe anketat e kënaqësisë (36%). Për më tepër, të intervistuarit sugjeruan trajnim të vazhduar të detyrueshëm në fushat e veçanta të së drejtës të lidhura me çështjet me ndihmë juridike të trajtuara nga avokatët (35%), dhe mekanizëm ankesash për përfituesit e ndihmës juridike (26%). Kur përgjigjet për këtë pyetje u analizuan bazuar në marrëdhënien e të intervistuarit me ndihmën juridike, anketat e kënaqësisë për përfituesit (58%) dhe krijimi i një mekanizmi ankesash për përfituesit (54%) ishin dy rekomandimet më të shpeshta të dhëna nga ofruesit e ndihmës juridike.

GRAFIKU 65 MENDIMET PËR METODAT E SIGURIMIT TË CILËSISË GJATË OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE



Kur u pyetën për motivimin e tyre për të lidhur kontratë për ofrimin e ndihmës juridike, 43% e të anketuarve nuk dhanë përgjigje. Ndër ata që u përgjigjën, shtysat kryesore ishin fitimi i përvojës profesionale (34%), marrja informacion për këtë mundësi gjatë studimeve ose formimit të tyre profesional (25%), ndjenja e detyrimit moral (16%) dhe shtimi i kënaqësisë në punë (14%). Pagesa ishte arsyeja e përmendur më pak dhe e shprehur nga vetëm 9% e të anketuarve.


GRAFIKU 66 SHTYSAT PËR PËRFSHIRJEN NË OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE



Për të anketuarit me më shumë se dhjetë vite përvojë, motivimi kryesor ishte fitimi i përvojës profesionale (37%) dhe ndjenja e detyrimit moral (41%). Për më tepër, fitimi i përvojës profesionale ishte veçanërisht me rëndësi për të anketuarit që janë ofrues të ndihmës juridike (nga qendrat e ndihmës juridike, OJF-të e autorizuar ose klinikat ligjore), me 67% prej tyre që e përmendën këtë si shtysën kyçe.

Një vëzhgim i rëndësishëm lidhur me pagesën ishte se kur të anketuarit u pyetën për kënaqësinë e tyre me të, një pjesë e konsiderueshme (48%) thanë se nuk e dinë (22%) ose se nuk dëshirojnë t'i përgjigjen pyetjes (26%). Ndër ata që shprehën mendim, 15% shprehën se janë shumë të kënaqur dhe 23% se janë mesatarisht të kënaqur. Vetëm 5% deklaruan mungesë të përgjithshme kënaqësie me pagesën për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike.

GRAFIKU 67 KËNAQËSIA ME PAGESËN PËR SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE



Kënaqësia me pagesën ishte dukshëm më e lartë tek ofruesit e ndihmës juridike, ku 54% gjithsesi shprehën kënaqësi, krahasuar me 35% tek punonjësit e strukturave publike vendore.

Kur u pyetën përse mendonin se shërbimet e tyre ishin konkurruese, shumica e të anketuarve zgjodhën aftësitë si arsyen kryesore (29%), ndjekur nga përfundimi i trajnimeve të specializuara (15%) dhe faktin që janë vazhdimisht të informuar në fushën e tyre të ekspertizës (15%).

4. Përfundimet kyçe nga sondazhi përmes internetit

1. Një numër i konsiderueshëm palësh interesi në sistemin e ndihmës juridike u shprehën pozitivisht lidhur me qasjen në shërbimet e ndihmës juridike. Zakonisht, qytetarët marrin informacion për ndihmën juridike përmes bashkive, bisedave me bashkëqytetarët, qendrave të ndihmës juridike dhe mediave sociale.
2. Qendrat e ndihmës juridike, avokatët dhe punonjësit socialë janë ofruesit kryesorë të këshillimit juridik. Një e katërta e të anketuarve shprehën se e kanë dhënë personalisht këtë shërbim, shumë prej të cilëve ishin punonjës socialë ose punonjës në bashki. Shumica e të anketuarve beson se cilësia e këshillimit juridik fillestar është e kënaqshme, në rastet kur qytetarët kërkojnë këshillim për zgjidhje martesë, dhunë në familje ose seksuale, mosmarrëveshje pronësie për toka ose prona dhe për pensionet.

3. Vetëm një në katër të anketuar kishte informacion lidhur me udhëzimet për profesionistët e ndihmës juridike. Ofruesit e ndihmës juridike ishin më të informuar sesa punonjësit e strukturave të qeverisjes vendore. Më pak se gjysma e të anketuarve besojnë se ofruesit e këshillimit juridik fillestar kanë trajnim të përshtatshëm, ku shumë prej tyre e mbështesin zhvillimin e tyre profesional në seminare dhe diskutime informale.
4. Punonjësit socialë dhe qendrat e kujdesit shoqëror konsiderohen burimet parësore të referimit. Punonjësit e qendrave të ndihmës juridike dhe ekipet e lëvizshme konsiderohen nga të anketuarit si mundësia më e mirë për qasjen e qytetarëve në shërbimet e ndihmës juridike.
5. 68% janë dakord se gjyqtarët informojnë qytetarët për të drejtën e tyre për ndihmë juridike, ndërkohë që 71% e të anketuarve konsiderojnë se procesi i aplikimit për ndihmë juridike është i qartë.
6. Më shumë se gjysma e të anketuarve (56%) pranojnë se shpesh kërkuesit e ndihmës juridike kanë vështirësi gjatë aplikimit, ndërsa për shumicën e tyre avokatët dhe gjyqtarët përballen me vështirësi kur trajtojnë grupet e cënueshme.
7. Shumica dërmuese e palëve të interesit që morën pjesë në sondazh (71%) mendojnë se procedura aktuale për për zgjedhjen e avokatit që do të ofrojë ndihmën juridike është e drejtë. Ata deklarojnë se aftësitë (72%) dhe formimi juridik (50%) duhet të marrin përparësi si kritere për për zgjedhjen e avokatëve. Po ashtu, 71% e të anketuarve bien gjithashtu dakord se avokati caktohet shpejt për çështjet e ndihmës juridike falas.
8. Shtysat kryesore për palët e interesit të përfshira në sistemin e ndihmës juridike ishin përfitimi i përvojës profesionale, ndërgjegjësimi përmes studimeve, dhe detyrimi moral që ndjejnë. Thuajse gjysma e të anketuarve nuk e di ose nuk dëshiron të përgjigjet lidhur me pyetjen për kënaqësinë me nivelin e pagesës. Nga ata që u përgjigjën, 38% ishin të kënaqur, me kënaqësi më të lartë tek ofruesit e ndihmës juridike krahasuar me punonjësit e strukturave të qeverisjes vendore.



PJESA III

**RËZULTATET E FAZËS
SË STUDIMIT CILËSOR**

3.1 Qasja dhe pengesat

3.1.1 Pengesat që hasin përfituesit kur i qasen ndihmës juridike

“Mentaliteti në sistemin e drejtësisë është i vjetruar dhe shpesh bie ndesh me parimet e të drejtave të njeriut dhe gjithëpërfshirjes. Shpesh gjyqtarët tregojnë mungesë ndjeshmërie ndaj nevojave të grupeve të marginalizuara, siç janë personat me aftësi të kufizuara dhe komuniteti LGBTQI+”. Përfaqësues i një NGO-je për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Studimi identifikon disa kategori të cënueshme që përballen me pengesa kur i qasen ndihmës juridike. **Individët në situatë të vështirë ekonomike** vijnë në kontakt me pengesat lidhur me qasjen në drejtësi. Vështirësitë financiare përbëjnë pengesë për përfitimin e shërbimeve juridike dhe realizimin efektiv të të drejtave të tyre.

Individët që përjetojnë diskriminim kualifikohen për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, por duhet ta provojnë atë nëpërmjet një vendimi të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sipas informacionit të dhënë nga Komisioneri, aktualisht nuk ka asnjë rast diskriminimi që ka kërkuar ndihmë juridike, çka tregon se ka pengesë ligjore. Kjo vjen për shkak se personi që pretendon diskriminim nuk duhet të jetë i/e detyruar të faktojë këtë diskriminim me vendim të Komisionerit, sepse kanë kërkuar ndihmë për t'u mbrojtur. Kjo dispozitë ka nevojë të ndryshohet.

Po ashtu, në rastet e **viktimave të dhunës në familje**, gjykata kërkon urdhër mbrojtjeje përpara se të vendosë lidhur me ndihmën juridike dytësore. Por, jo çdo grua që është viktimë e dhunës në familje merr urdhër mbrojtjeje për shkak të frikës nga përshkallëzimi i situatës me bashkëshortin, dhe kërkon ndihmë vetëm lidhur me zgjidhjen e martesës. Në këto raste, gjykatat zbatojnë interpretime të ndryshme dhe OSHC-të thanë se ka raste në të cilat gjykatat kanë refuzuar ofrimin e ndihmës juridike. Për më tepër, procesi dhe afati për verifikimin e urdhrit të mbrojtjes të lëshuar nga gjykata është shpesh i gjatë, duke penguar kështu gjyqtarin lidhur me ofrimin e ndihmës juridike dytësore, duke qenë se këto janë procese të veçanta. Si pasojë, shumë pak të mbijetuara përfaqësohen nga avokatë dhe shumica marrin ndihmë nga OSHC-të dhe avokatët e këtyre të fundit. Komunitetet **rome dhe egjiptiane** shpesh nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm, duke vështirësuar përfshirjen e tyre në sistemin e drejtësisë, qoftë për të kërkuar të drejtat e tyre apo edhe për t'iu qasur shërbimeve bazë. Çështja përkeqësohet më tej nga niveli i ulët arsimor i komunitetit, që mund të kufizojë kuptimin e tyre për të drejtat dhe proceset juridike, duke vështirësuar avokimin e efektshëm për vetveten. Shpesh këto raste i referohen OSHC-ve për ndihmë. Një prej gjyqtarëve të intervistuar u shpreh se *“vihet re një ndjenjë e dukshme tërheqjeje ose pranimi tek disa pjesëtarë të komunitetit rom, të cilët e perceptojnë sistemin si tejet të ndërlikuar ose të anshëm ndaj tyre, duke i shtyrë të mos kërkojnë ndihmë juridike.”*

Diskriminimi bëhet pengesë për komunitetet e marginalizuara si komunitetet rome, egjiptiane, LGBTQI+, dhe të tjerë.

“Ata duhet të sjellin avokat sepse shpesh gjyqtarët e nisin procesin pa një të tillë, sidomos nëse vënë re që janë romë.” - Avokat nga OJF e autorizuar.

Nevoja për ndryshime ligjore për përmirësimin e qasjes së romëve dhe kategorive të tjera të marginalizuara në shërbimet e ndihmës juridike është theksuar nga disa palë kyçe interesi të intervistuar. Këto ndryshime ligjore janë të nevojshme për trajtimin e vështirësive të shpeshta me të cilat përballlet komuniteti rom, veçanërisht lidhur me mungesën e dokumentacionit, siç ilustruhet edhe nga rasti më poshtë.

Një tjetër rast i treguar nga një gjyqtar që ilustron vështirësitë me të cilat përballlet komuniteti rom është ai i një fëmije të lindur në kushte shtëpie nga prindër romë dhe i paregjistruar zyrtarisht pas lindjes, duke e lënë fëmijën pa dokumentacion zyrtar. Si pasojë, kërkesa e prindërve për regjistrimin e fëmijës në arsim u refuzua për shkak të mungesës së dokumentacionit. Prindërit u detyruan t'i qasen sistemit të drejtësisë për zgjidhje, duke kërkuar ndërhyrjen e gjykatës me qëllim verifikimin zyrtar të lindjes së fëmijës. Ky hap ishte i nevojshëm për nxjerrjen e certifikatës së lindjes që do të mundësonte regjistrimin e fëmijës në regjistrin civil dhe si rrjedhojë edhe në sistemin arsimor.

Pengesat në qasjen e shërbimeve juridike dhe komunikim me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara.

Një tjetër kategori që has vështirësi të konsiderueshme me qasjen në drejtësi është ajo e personave me vështirësi në dëgjim, dhe kjo vjen kryesisht si pasojë e problemeve me komunikimin dhe mungesës së interpretëve. Kjo pengesë kufizon ndjeshëm aftësinë e tyre për t'u angazhuar në procese juridike dhe për të marrë mbështetje të përshtatshme. Qasja është gjithashtu e vështirë për personat me vështirësi në shikim. Marrëveshjet me OSHC-të dhe mbështetja nga OSBE-ja, që përfshijnë edhe një manual në breil, kanë ndihmuar në ofrimin e shërbimit personave me vështirësi në dëgjim dhe shikim. Megjithatë, vështirësitë vijnë në lidhje me disponueshmërinë e barabartë të mbështetjes në mbarë vendin. Pavarësisht disa përmirësimeve infrastrukturore lidhur me vendndodhjen e qendrave të ndihmës juridike falas, qasja fizike për personat me aftësi të kufizuara mbetet sfidë.

Individët LGBTQI+ përballen me pengesa për shkak të paragjykitimit dhe stereotipizimit, çka rezulton në trajtimin e më pak çështjeve. Këta individë kërkojnë ndihmë kryesisht përmes OSHC-ve.

Së fundi, **të moshuarit** janë një tjetër grup i disavantazhuar sa i përket qasjes në drejtësi, për shkak të **mungesës së informacionit për qasjen në drejtësi dhe qasjes në teknologji, në internet dhe për shkak të njohurive digjitale të nevojshme për përdorimin e shërbimeve në internet** (e-Albania).

3.1.2 Pengesa të tjera të sistemit

Referimi më i shpeshtë i qytetarëve drejt shërbimeve juridike vjen nga policia ose punonjësit e qeverisjes vendore. Edhe prokuroria dhe gjykatat referojnë individë. Gjithashtu, i zakonshëm është edhe vetëreferimi. Në intervista u përmendën edhe shembuj pozitivë të bashkëpunimit të efektshëm ndërmjet shërbimeve të NJF-së dhe MKR-së në nivel vendor. Megjithatë, referimi nuk është sistemik. Probleme si **mospagesa ose pagesat e ulëta për ekspertët** kanë penguar në raste të caktuara qasjen në drejtësi për qytetarët.

Vështirësitë me verifikimin e kriterit të statusit ekonomik.

Personat me të ardhura të ulëta përballen me pengesa në verifikimin e situatës së tyre ekonomike për shkak të kërkesave të shumta për dokumentacion, si vërtetimi i të ardhurave dhe pronësisë. Shpesh ky proces është i gjatë dhe burokratik. Punonjësit e qendrave të shërbimeve të NJF i ndihmojnë kërkuarit të mbledhin dokumentacionin e nevojshëm, por lëshimi i dokumentacionit mbështetës kundrejt pagesës, paraqet një tjetër sfidë për individët me mundësi të kufizuara financiare. Disa institucione nuk i ofrojnë këto shërbime pa pagesë, duke e penguar më tej qasjen. Për më tepër, verifikimi i të ardhurave për të gjithë ata që janë të regjistruar në një certifikatë familjare është problematik kur anëtarët e familjes janë jashtë vendit ose nuk janë të gatshëm të ofrojnë dokumentacion, duke penguar kështu vlerësimin e saktë ekonomik.

Qasja në dhe kompleksiteti i formularëve.

Formularët e ndihmës juridike plotësohen nga punonjësit e qendrave dhe nënshkruhen nga qytetarët, por ato mund të plotësohen edhe përmes internetit. Këta formularë nuk janë shumë miqësorë për përdoruesin dhe plotësimi i tyre kërkon mbështetje. Ka nevojë që formularët të rishikohen, mundësisht edhe të zëvendësohen me një deklaramë më të thjeshtë me qëllim thjeshtimin e procesit. Formularët aktualë janë të gjatë, dhe shkaktojnë vonesa dhe shkurajojnë kërkuarit.

Proceset e zgjatura gjyqësore dhe kërkesat për provat.

Një prej vështirësive kryesore lidhur me qasjen në sistemin e drejtësisë është kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, sidomos në shkallën e apelit. Proceset e gjata mund të jenë frikësuese dhe shkurajuese, duke shtuar paqartësinë dhe stresin emocional të palëve të përfshira. Këto kërkesa procedurale mund të mund të shtyjnë individët që janë në vështirësi ekonomike të mos kërkojnë të drejtat e tyre ligjore.

Problemet me përzgjedhjen e avokatëve.

Qytetarët përballen me vështirësi në marrjen e ndihmës juridike dytësore. Caktimi i avokatëve mund të zgjasë deri në një muaj, duke shkaktuar vonesa. Ndërkohë që avokatëve u caktohen rregullisht çështje, u ngritën shqetësime lidhur me **drejtësinë e sistemit të rotacionit**, duke qenë se disa avokatëve u caktohen përpjesëtimisht më shumë çështje. Ka probleme edhe kur qytetarët angazhojnë vetë avokatët e tyre dhe

kërkojnë vetëm përjashtimin nga shpenzimet gjyqësore, sepse përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore lidhet me caktimin e avokatit nga lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore.

Koha dhe kostot përkatëse.

Për më tepër, mbledhja e dokumentacionit të nevojshëm mund të ketë kosto, dhe në disa raste kjo kosto arrin në vlerën e 3000 Lekë. Gjithashtu, mund të ketë vonesa në marrjen e përgjigjeve nga zyra e kadastrës dhe përgjigjet negative kushtojnë 500 Lekë, çka përbën kosto të lartë për familjet me shumë anëtarë.

Një zgjidhje efikase do të ishte nëse gjykata ka qasje të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave me qëllim mbledhjen e informacionit për qytetarët, duke thjeshtuar kështu procesin dhe duke pakësuar barrën e qytetarëve. Për më tepër, kostot që lidhen me përfaqësimin juridik përbëjnë pengesë të konsiderueshme për shumë individë. Shpenzimet e angazhimit të avokatit, së bashku me tarifat e gjykatës dhe kostot e nevojshme për vlerësimet e ekspertëve që nevojiten për vërtetimin e pretendimeve, mund të jenë të papërballueshme.

Në praktikë, problemet me pagesat e Ministrisë së Drejtësisë për ekspertët në rastet e ndihmës juridike shpesh çojnë në një hezitim nga ana e ekspertëve për të pranuar këto kërkesa, ose ata gjejnë mënyra të tjera për t'i detyruar qytetarët të mbulojnë vetë shpenzimet. Këto barra financiare shpesh i bëjnë individët të tërhiqen ose ndërlikojnë mundësitë e tyre për të kërkuar drejtësi apo për të mbrojtur të drejtat e veta në mënyrë të efektshme.

Problemet në gjykata dhe në sistem

gjithashtu pengojnë qasjen në drejtësi. Ka raste që gjykatat kanë të kuptuar të kufizuar ose bëjnë interpretim të ngushtë të legjislacionit në lidhje me kategoritë e veçanta, çka çon në pasaktësi procedurale dhe shpenzime të shtuara për individët e cënueshëm. Për më tepër, vonesat e konsiderueshme gjatë proceseve gjyqësore përkeqësojnë më tej këto vështirësi. Vendndodhja fizike e qendrave të ndihmës juridike, që shpesh është larg zonave të banuara shton një shtresë tjetër vështirësie veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

Ndikimi i mundshëm i hartës së re gjyqësore në qasjen tek shërbimet e ndihmës juridike. Avokati i Popullit (AP) po kryen një studim për vlerësimin e mënyrës se si riorganizimi i gjykatave po ndikon ofrimin e shërbimeve dhe qasjen e qytetarëve. Ka shqetësime lidhur me vendndodhjen e zyrave të shërbimit në lidhje me qytetarët. Një sugjerim thekson se edhe vetëm funksionimi i zyrave të shërbimit dy ditë në javë do të ishte me dobi për qasjen. Megjithatë, siç përmendet nga përfaqësuesit e OSHC-ve, ata që jetojnë në Krujë tashmë duhet të udhëtojnë në Durrës për të përfituar shërbime të ndihmës juridike dytësore.

Pjesëmarrësit përmendën se një tjetër problem madhor është **objekti i kufizuar dhe afatet e shërbimeve të NJF-së**. Aktualisht NJF-ja ofron kryesisht këshillim juridik, ndërkohë që ka nevojë që ky objekt të zgjerohet dhe të ofrohet mbështetje më gjithëpërfshirëse përtej informacionit juridik. Për më tepër, afatet e shkurtra për përfitimin e ndihmës juridike dytësore vështirësojnë mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm në kohë. Në kontrast me shërbime të tjera emergjence, NJF-ja nuk mund të përgjigjet menjëherë, sepse në qendra mungojnë burimet e mjaftueshme njerëzore.

Problemet operacionale dhe strukturore përkeqësojnë më tej këto vështirësi. Shpesh qendrat e ndihmës juridike funksionojnë me vetëm një punonjës, çka kufizon aftësitë e tyre për të ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse. Për më tepër, shërbimet e NJF-së nuk janë të integruara mirë me shërbimet e tjera të bashkërenduara në nivel vendor, duke penguar kështu referimet e efektshme dhe mbështetjen e gjithanshme.

Qasja në informacionin e përditësuar për aktorët mbështetës kyçë dhe problemet me bashkërendimin u përmendën si çështje nga përfaqësuesit e prokurorive të intervistuar për këtë vlerësimin, të cilët përfshinë edhe mungesën e listave të përditësuar të psikologëve dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror në rang vendi. Për shembull, një çështje në Vlorë mund të ketë nevojë për psikolog me seli në Tiranë. Këto mangësi të informacionit praktik dhe disponueshmërisë së shërbimit, së bashku me pengesat procedurale, pengojnë qasjen e viktimave të dhunës në shërbime jetike mbështetëse dhe krijojnë vështirësi logjistike transporti dhe bashkërendimi.

Tranzicioni i shërbimeve publike elektronike (e-Albania) dhe qasja në drejtësi. Vendimi i qeverisë i datës 1 maj 2022 për ofrimin e një sërë shërbimesh publike në mënyrë elektronike prek gjithashtu edhe qasjen e qytetarëve në drejtësi, sepse një sërë dokumentesh personale, certifikatash, si dhe regjistrimi i fëmijëve në shkollë tashmë janë të disponueshme vetëm përmes aplikimeve në e-Albania. Një studim i kryer nga Avokati i Popullit ka identifikuar një sërë problemesh. Shqetësimi kryesor është se ofrimi i shërbimeve elektronike ndërlikon metodat alternative të qasjes në shërbime, veçanërisht për të huajt ose ata që nuk kanë qasje në teknologji ose nuk kanë aftësi të mira kompjuterike, dhe sidomos në rastet kur shërbimi elektronik është e vetmja mënyrë për marrjen e dokumentacionit përkatës. Problemi është më domethënës në qarqet jashtë Tiranës dhe veçanërisht për grupet e cënueshme.

Ndërkohë që synimi është përmirësimi i efikasitetit të ofrimit të shërbimit dhe ulja e korrupsionit, ata që preken më shumë nga mungesa e qasjes në drejtësi, dhe në veçanti ata me burime të kufizuara financiare, janë të detyruar që të mbështeten në lehtësues privatë për të përdorur shërbimet e e-Albania-s. Qasja në shërbimet publike elektronike është kthyer në shërbim të domosdoshëm dhe ka ndikim në qasjen në drejtësi në përgjithësi. Për këtë arsye, është e nevojshme të zbatohen alternativa të ndryshme për qasjen në shërbime publike, bazuar në nevojat e ndryshme të popullsisë.

3.1.3 Vështirësitë që lidhen me kuadrin dhe instrumentet aktuale

Kuadri dhe instrumentet aktuale për ndihmën juridike falas në Shqipëri përballen me vështirësi të shumta që pengojnë efektshmërinë dhe qasjen në këto shërbime, veçanërisht për grupet më të disavantazuara, si viktimat e dhunës në familje, komunitetet rome dhe egjiptiane dhe personat me aftësi të kufizuara.

Procesi burokratik i aplikimit dhe mungesa e politikave dhe instrumenteve lehtësuese

Procesi i aplikimit që qytetarët të marrin ndihmë juridike konsiderohet burokratik dhe i vështirë. Në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike falas ka një sërë vështirësish të konsiderueshme, sidomos për individët me mundësi të kufizuara ekonomike apo grupet e marginalizuara. Këta individë përballen me vështirësi të ndryshme, si: marrjen e informacionit të nevojshëm përmes e-Albania-s; pamundësinë e pagesës për shërbimet/dokumentacionin e nevojshëm gjatë fazës së aplikimit (p.sh. certifikatat negative nga Kadastra) dhe vonesat e përgjigjeve nga institucionet përkatëse. Kompleksiteti i kuadrit ligjor ndërlikohet më tej nga mungesa e politikave dhe instrumenteve për lehtësimin e procesit të aplikimit. Aktualisht, kërkuesit duhet të plotësojnë dy formularë dhe duhet të dorëzojnë dokumentacion mbështetës, çka nuk mbështet siç duhet lehtësimin e aplikimit të tyre, veçanërisht për grupet e cënueshme. Aktet ligjore dhe nënligjore duhet të rishikohen me synimin e lehtësimit të procesit të aplikimit për NJF dhe për vënien në zbatim të mekanizmave shtesë të mbështetjes për kategoritë e cënueshme **lidhur me mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm**.

Ligji përcakton verifikimin e të ardhurave për të gjithë individët e përfshirë në certifikatën familjare të kërkuesit. Megjithatë, kjo kërkesë paraqet vështirësi kur pjesëtarët e familjes janë jashtë vendit ose nuk janë të gatshëm të ofrojnë dokumentacionin e nevojshëm. Këto vështirësi pengojnë verifikimin e saktë të situatës ekonomike dhe kufizojnë qasjen në drejtësi për të gjithë qytetarët.

- DREJTORIA E NJF-SË-

Pengesat për grupet e cënueshme

Situata është më e vështirë për grupet e cënueshme, si viktimat e dhunës në familje. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që ofrojnë ndihmë juridike në këtë fushë theksojnë se këto viktima përballen me **pengesa të konsiderueshme lidhur me vërtetimin e statusit të tyre dhe kualifikimin për ndihmë juridike**. Për më tepër, **afatet e shkurtra për marrjen e urdhrave të mbrojtjes** dhe lista e gjatë e dokumentacionit pengojnë më tej qasjen në drejtësi për këtë kategori, duke vështirësuar marrjen e ndihmës së nevojshme. Sipas kuadrit ligjor, viktimat e dhunës në familje (VDHF) përveç nënshkrimit të një deklarate

vetjake se ato përmbushin kriteret e përcaktuara me ligj, duhet të dorëzojnë edhe dokumentacion justifikues. Kjo kërkesë përjashton individët që kanë qenë subjekt i dhunës në familje por nuk janë njohur nga gjykata si viktimë të dhunës, duke mos i lejuar kështu qasjen në ndihmë juridike falas. Me qëllim lehtësimin e pozicionit të tyre, një sugjerim mund të jetë rishikimi i kuadrit ligjor duke e konsideruar vetëdeklarimin e viktimës së dhunës në familje të mjaftueshëm për përfitim të ndihmës juridike.

Vështirësitë për popullsinë rome

E njëjta situatë vlen edhe për popullsinë rome. Sipas kuadrit ligjor aktual, ky grup i cenueshëm nuk njihet si kategori e veçantë dhe mund të përfitojë nga ndihma juridike falas vetëm nëse vërteton nivel të pamjaftueshëm të ardhurash ose pasurie. Shpesh pjesëtarët e këtij grupi e kanë të pamundur të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, sidomos kur merret në konsideratë që një pjesë e dokumentacionit jepet me pagesë. Në këto rrethana, organizatat që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike për këtë grup theksojnë nevojën e rishikimit të Ligjit Nr. 111/2017. Ato bëjnë thirrje për përfshirjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane si kategori të veçanta të kualifikuara për ndihmë juridike falas pavarësisht të ardhurave apo pasurisë së tyre.

“The Roma community faces significant challenges, primarily due to issues related to documentation and their generally lower levels of education. Without the necessary paperwork, such as identification cards, birth certificates, or proof of residence, it becomes exceedingly difficult to engage with the legal system, whether to pursue claims, defend rights, or even access basic services.”

- JUDGE, SPECIAL APPEAL COURT AGAINST ORGANISED CRIME AND CORRUPTION, TIRANA-

Vështirësitë për personat me aftësi të kufizuara

Ofruesit e ndihmës juridike theksojnë gjithashtu mungesën e protokolleve dhe politikave të veçanta që synojnë të lehtësojnë qasjen në shërbime të ndihmës juridike falas për individët me vështirësi në shikim ose dëgjim. Formularët dhe dokumentacioni i kërkuar nga ofruesit e Ndihmës Juridike Falas (NJF) nuk mundëson përdorimin nga personat me vështirësi në shikim. Ndërkohë, mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave përbën sfidë të konsiderueshme lidhur me qasjen në këto shërbime për individët me vështirësi në dëgjim. Është kritike që këto formularë dhe dokumente të mund të përdoren nga të gjithë individë që kërkojnë ndihmë juridike falas. Për më tepër, ka gjithashtu nevojë të hartohen protokolle të veçanta për ofruesit e shërbimeve mbi mënyrat e trajtimit të efektshëm dhe ofrimit të shërbimit për individët me vështirësi në shikim dhe/ose dëgjim.

“Struktura fizike e sistemit të drejtësisë dhe mekanizmat proceduralë nuk janë gjithmonë në përputhje me nevojat e individëve me aftësi të kufizuara fizike, ose vështirësi në shikim apo dëgjim, duke vështirësuar qasjen e tyre në shërbime ligjore dhe pjesëmarrjen në procese gjyqësore.”

-GJYQTAR, GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË.-

Vështirësitë për personat me aftësi të kufizuara

Ofruesit e ndihmës juridike theksojnë gjithashtu mungesën e protokolleve dhe politikave të veçanta që synojnë të lehtësojnë qasjen në shërbime të ndihmës juridike falas për individët me vështirësi në shikim ose dëgjim. Formularët dhe dokumentacioni i kërkuar nga ofruesit e Ndihmës Juridike Falas (NJF) nuk mundëson përdorimin nga personat me vështirësi në shikim. Ndërkohë, mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave përbën sfidë të konsiderueshme lidhur me qasjen në këto shërbime për individët me vështirësi në dëgjim. Është kritike që këto formularë dhe dokumente të mund të përdoren nga të gjithë individë që kërkojnë ndihmë juridike falas. Për më tepër, ka gjithashtu nevojë të hartohen protokolle të veçanta për ofruesit e shërbimeve mbi mënyrat e trajtimit të efektshëm dhe ofrimit të shërbimit për individët me vështirësi në shikim dhe/ose dëgjim.

Kriteret e statusit ekonomik

Konsiderohet se ka nevojë për ndryshime ligjore lidhur me kriteret e kualifikimit për ndihmë juridike falas. Ndërkohë që kategoritë aktuale të përfituesve janë të përshtatshme, kriteret e statusit ekonomik duhen rishikuar. Në veçanti, kufijtë e të ardhurave dhe pasurisë që duhet të përmbushin individët për kualifikim për ndihmë juridike duhen rivlerësuar. Ka nevojë të ripërcaktohen segmentet e të ardhurave për të garantuar që jo vetëm përfituesit e ndihmës ekonomike, por edhe individët e tjerë me të ardhura të ulëta të përfitojnë nga ligji.

Konsideratat e pasakta lidhur me barrën financiare

Një tjetër vështirësi e rëndësishme në kuadrin ligjor është konsiderata e pasaktë e barrës së përgjithshme financiare të kërkuarit. Kërkuarve me të ardhura të pamjaftueshme u duhet të paraqesin prova të të ardhurave, pasurive dhe shpenzimeve të tyre. Megjithatë, sipas ofruesve të NJF-së, kur gjykatat shqyrtojnë kërkesat për ndihmë juridike dytësore, ato e bazojnë vendimin e tyre vetëm në vlerësimin e të ardhurave dhe pasurisë, pa marrë në konsideratë shpenzimet e kërkuarit. Ky fokus i ngushtë nuk garanton një panoramë gjithëpërfshirëse të situatës financiare të kërkuarit, duke shkualifikuar individë që realisht kanë nevojë për ndihmë juridike, ndërkohë që kanë shpenzime të konsiderueshme të pashmangshme.

3.2 Disponueshmëria e shërbimit

Gjykata e juridiksionit të përgjithshëm Tiranë nuk ka një qendër të përkushtuar për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Në përgjithësi, ashtu siç edhe u deklarua nga përfaqësuesit e OSHC-ve, distanca e qendrave të NJF-së nga gjykatat përbën pengesë ndaj qasjes për individë që kanë nevojë për mbështetje juridike. Më parë, gjykatat kishin seksione të specializuara për të çështjet e të miturve ose atyre familjare të cilat siguronin informacion dhe mbështetjen e nevojshme. Megjithatë, këto seksione u shkrinë në kuadër të reformave të kohëve të fundit, duke ia kaluar këtë barrë bashkive si institucionet parësore ku qytetarët kërkojnë ndihmë. Në vlerësimin e palëve të intervistuar të interesit, përpjekjet për trajtimin e situatës kanë qenë të pakta dhe kryesisht të paefektshme.

Në lidhje me procesin e aplikimit për fonde nga NGO-të e autorizuar u ngritën shqetësime lidhur me transparencën, çka vështirëson përcaktimin e momentit kur hapen thirrjet për aplikim. **Shqetësime u ngritën edhe lidhur me proceset e autorizimit dhe financimit nga shteti për NGO-të.** Procesi i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike mund të përmirësohet më tej. Procesi krijon vështirësi të shumta për shkak të kompleksitetit dhe kërkesave të shumta për dokumentacion. U theksua se element thelbësor për zgjerimin e shërbimeve është financimi i qëndrueshëm nga buxheti i shtetit për organizatat e autorizuar. Aktualisht, vetëm dy nga 15 NGO të autorizuar marrin mbështetje financiare nga shteti si ofrues të ndihmës juridike. Përvoja përkatëse e organizatave që aplikojnë duhet të ketë më shumë peshë gjatë procesit të vlerësimit. Në përgjithësi, metodologjia duhet t'i përshtatet më mirë organizatave me numër të vogël personeli, dhe duhet të njihet ofrimi i ndihmës juridike përmes telefonit ose internetit.

Qasja e grave në drejtësi - vështirësitë dhe strategjitë

Gratë në sektorë punësimi informalë në Shqipëri përballen me pengesa ndaj qasjes në drejtësi. Këto vështirësi janë të rrënjosura thellë në normat dhe praktika shoqërore që disavantazhojnë gratë, veçanërisht ato që punojnë në sektorë informalë si pastrimi, kujdesi për fëmijët dhe kujdesi për të moshuarit. Prania e marrëveshjeve informale të punësimit pengon konsiderueshëm aftësinë e këtyre punonjëseve për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të kërkuar zhdëmtim ligjor. Për më tepër, mungesa e programeve të formimit, shpërndarjes së informacionit dhe fushatave ndërgjegjëse lidhur me të drejtat e punësimit rezultojnë në probleme më të gjera të lidhura me pabarazinë dhe padrejtësinë.

Gratë në sektorët informalë përballen me vështirësi ekonomike dhe faktorë socio-kulturorë që kufizojnë aftësinë për të ushtruar të drejtat e tyre. Shpesh si burimi kryesor i të ardhurave në familjet e tyre, këto gra gjenden në cikël varfërie pasi vendimet financiare dhe qasja tek të ardhurat kontrollohen nga partnerët burra. Kjo kufizon pavarësinë e tyre ekonomike dhe i vendos ato në pozita vulnerabël. Këto trysni të ndërthurura edhe me normat socio-kulturore krijojnë mjedis të përshtatshëm për shfrytëzim dhe abuzim. Si pasojë, shumë gra bien viktimë e dhunës me bazë gjinore, çka pasqyron probleme më të përgjithshme të pushtetit dhe kontrollit në shoqërinë shqiptare.

Ka ende mangësi të konsiderueshme në disponueshmërinë dhe ndërgjegjësimin për shërbimet e ndihmës juridike, veçanërisht sa i përket grave në sektorët informalë dhe atyre që përballen me dhunën me bazë gjinore. Qendrat e ndihmës juridike janë të përqendruara në zona urbane, duke i lënë gratë e zonave rurale dhe të thella ku abuzimi në vendin e punës është i zakonshëm, të izoluara dhe pa mundësi veprimi. Qytetarët në zonat e thella rurale ose qarqet me përqendrim të lartë të fasonerive shpesh nuk janë të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre ose ku të kërkojnë ndihmë juridike. Mungesa e qendrave të ndihmës juridike është pengesë e konsiderueshme ndaj qasjes në drejtësi, çka kërkon masa përkatëse.

Trajtimi i nevojave për informacion përmes qasjeve novatore

Për të trajtuar nevojën urgjente për mbështetje juridike lidhur me të drejtat e punës, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim zbatoi një fushatë që përfshinte edhe një linjë telefonike, që u promovua përmes reklamave radiofonike. Reagimi domethënës ndaj fushatës me rreth 300 thirrje të pritura tregoi kërkesën e lartë për ndihmë juridike, por theksoi edhe vështirësitë lidhur me financimin. Ky reagim shpalosi realitetin e vështirë të mungesës së informacionit sa i përket të drejtave të punës dhe disponueshmërisë së ndihmës juridike. Shumë qytetarë ende nuk janë në dijeni të të drejtave të tyre, ekzistencës së shërbimeve të ndihmës juridike, apo si t'i qasen këtyre burimeve kur përballen me padrejtësi apo diskriminim në vendin e punës. Mungesa e ndërgjegjësimit është e pranishme në shtresa të ndryshme shoqërore, çka tregon se problemi është sistematik dhe se pengon përdorimin e efektshëm të mbështetjes juridike nga ata që kanë nevojë për të.

- INTERVISTË ME PËRFAQËSUESIN E QENDRËS ALEANCA GJINORE
PËR ZHVILLIM (NGO LOKALE), MARS 2024 -

3.3 Përshtatshmëria e ofrimit të shërbimit

3.3.1 Autorizimi dhe financimi i OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike

Procedura e autorizimit për OJF-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore bazohet në Vendimin Nr.55 datë 6 shkurt 2019 që përcakton procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për organizatat jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti. Megjithëse ndryshimet e kohëve të fundit të vendimit Nr. 55/2019 kanë shfuqizuar detyrimin e riautorizimit çdo dy vjet, ka ende vështirësi të konsiderueshme, për shkak të akteve nënligjore që përcaktojnë procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e kërkuar.

Thuajse të gjitha OJF-të e intervistuar e konsiderojnë procesin e autorizimit të Ministrisë së Drejtësisë si shumë burokratik. Procesi kërkon një listë të gjatë dokumentesh që kanë kosto dhe përgatitja e të cilëve kërkon kohë të konsiderueshme. Për më tepër, OJF-të duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin në format shkresor, dhe nuk pranohen dorëzime të dokumentacionit elektronik ose të skanuar, çka ndërlikon dhe ngadalëson më tej procesin e autorizimit.

Sa i përket financimit, nga viti 2017 deri në vitin 2024 vetëm dy nga 15 OJF kanë përfituar fonde nga buxheti i shtetit. 13 OJF-të e tjera nuk kanë marrë fonde nga Drejtoria/Ministria e Drejtësisë. Si pasojë, këto OJF varen kryesisht nga grantet e donatorëve për financim. Nëse diskutohen fondet e buxhetit të shtetit, OJF-të shprehin skepticizëm duke theksuar se fondet shtetërore janë minimale krahasuar me shërbimin që ato ofrojnë. Procedura e financimit bazohet në Vendimin Nr. 110 datë 6 mars 2019, i cili përcakton procedurat dhe rregullat për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parëse të garantuar nga shteti, dhe mënyrën e financimit të tyre.

“Rekomandohet që çdo gjykatë të ketë specialist të përkushtuar dhe të disponueshëm për ofrimin e ndihmës juridike. Ky model “me një ndalesë” do të ulte konsiderueshëm nevojën e hapave të shumtë dhe paraqitjes në vendndodhje të ndryshme nga ana e qytetarëve për të marrë ndihmën përkatëse. Ky specialist mund të drejtojë qytetarët gjatë procesit juridik, t’i ndihmojë me përgatitjen e dokumentacionit, dhe të japë këshilla juridike të përgjithshme, duke e bërë procesin gjyqësor më të thjeshtë dhe më pak stresues.”

- GJYQTAR, GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, TIRANË-

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas përcakton një zë të veçantë buxhetor për financimin e këtyre organizatave jofitimprurëse të autorizuar dhe përgatit planin vjetor të financimit bazuar në vlerën e miratuar. Sipas informacionit të siguruar nga Drejtoria, buxheti i miratuar me Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” përcaktoi 4,000,000 Lekë si transferta të brendshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore individëve që plotësojnë kushtet sipas ligjit për Ndhmën Juridike Falas. Për më tepër, një shumë tjetër prej 4,000,000 Lekë u caktua si transferta të brendshme për ofrimin e ndihmës juridike grave dhe vajzave në nevojë, të cilat plotësojnë kushtet.

Shuma e transfertave të brendshme ishte gjithsej 8,000,000 Lekë. I njëjti fond u miratua edhe për vitet 2023 dhe 2024, përkatësisht me Ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe me Ligjin Nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”. Pavarësisht këtyre planeve, OJF-të nuk kanë marrë financim nga Ministria për ofrimin e ndihmës juridike të autorizuar. Një problematikë e identifikuar është çështja e moskualifikimit të OJF-ve që aplikojnë për fonde nga buxheti i shtetit nëse ato marrin fonde nga donatorë të tjerë për të njëjtat shërbime të ndihmës juridike. Sipas Vendimit Nr. 110/2019, organizatat jofitimprurëse të autorizuar nuk duhet të kenë dy burime identike financimi për të njëjtën veprimtari. Duke qenë se OJF-të funksionojnë kryesisht përmes propozimeve për projekte të financuara nga donatorët, ky kufizim i shkualifikon ato nga skema e financimit nga shteti.

3.3.2 Sfidat e lidhura me burimet e NJF-së

Vështirësitë e burimeve njerëzore Raporti thekson se pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore ka ndikim negativ në cilësinë e shërbimeve të ndihmës juridike falas. Më shumë se 80% e qendrave të ndihmës juridike funksionojnë vetëm me një punonjës. Ky problem u evidentua veçanërisht pasi qendrat kaluan nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë. Pavarësisht numrit të vogël të rasteve të trajtuara nga disa qendra, funksionimi me vetëm një punonjës vështirëson tej mase organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit për shërbimet e ndihmës juridike, veçanërisht në zonat e thella dhe rurale. Idealisht, secila qendër duhet të ketë të paktën dy punonjës me qëllim menaxhimin e efektshëm të këtyre përgjegjësive. Duke marrë në konsideratë këto vështirësi, është kritike që secila qendër e NJF-së të ketë të paktën dy punonjës.

Vështirësitë operacionale dhe financiare Situata ndërlikohet më tej nga vështirësitë operacionale dhe financiare. Kufizimet financiare dhe mos pagesa e ekspertëve kanë ndikim negativ në ofrimin e shërbimit. Në vitin 2022, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas iu akorduan 47,200,000 Lekë gjithsej, ndjekur nga 66,550,000 Lekë në vitin 2023 dhe 107,450,000 Lekë në vitin 2024. Megjithëse buxheti për Ndhmën Juridike po rritet, ai ende përbën më pak se 1% të buxhetit të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Më konkretisht, përqindja e buxhetit të NJF-së në vitin 2022 në raport me buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë ishte 0,75%, ndjekur nga 0,79% në vitin 2023 dhe 0,69% në

vitin 2024. Burimet e kufizuara financiare kanë kufizuar edhe mbulimin me qendra të ndihmës juridike falas. Me gjithë përpjekjet për zgjerim, shërbimet e ndihmës juridike parësore aktualisht janë të disponueshme vetëm në 20 nga 61 bashkitë e vendit. Mungesa e qendrave të ndihmës juridike në zonat e tjera krijon pengesë të konsiderueshme lidhur me qasjen në drejtësi, duke theksuar nevojën për veprim nga ana e qeverisë.

Planifikimi i buxhetit për kategoritë e cenueshme Raporti vlerëson pozitivisht planifikimin buxhetor për fondet që i kushtohen ofrimit të shërbimeve të NJF-së grave dhe vajzave në nevojë. Megjithatë, raporti thekson edhe nevojën e planifikimit të buxhetimit të posaçëm edhe për kategoritë e tjera të cenueshme, si viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe fëmijët.

Fushatat e ndërgjegjësimit Burimet e kufizuara financiare ndikojnë edhe organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit ose seancave informuese për Ligjin për ndihmën juridike falas. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrat e Ndihmës Juridike Parësore zbatojnë fushata të shumta për informimin e qytetarëve për shërbimet e ndihmës juridike. Megjithatë, për shkak të buxheteve të kufizuara, këto fushata kryesisht organizohen në zona qendrore. Për këto arsye, duhet t'jepet përparësi informimit të qytetarëve në zona rurale dhe të thella.

3.3.3 Vështirësitë që lidhen me kapacitetet e ofruesve

Trajnimi i përkushtuar i pamjaftueshëm Trajnimi i përkushtuar i pamjaftueshëm për ofruesit e ndihmës juridike falas shton vështirësitë në sistemin e ndihmës juridike. Sipas ligjit, ofruesit e ndihmës juridike parësore zotërojnë njohuri të përgjithshme juridike, por nuk janë të specializuar në fusha të veçanta të së drejtës. E njëjta situatë vlen për avokatët e caktuar nga dhomat vendore të avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike falas. Këto mangësi në ekspertizë dhe trajnim do të thonë se shpesh ofruesit nuk janë të përgatitur të trajtojnë nevojat e ndërlikuara dhe delikate të grupeve të cenueshme, si viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, pakicat dhe fëmijët. Kufizimet financiare kufizojnë më tej aftësinë e ofrimit të trajnimit gjithëpërfshirës dhe zhvillimit të shërbimeve të përshtatura. Si pasojë, cilësia dhe efektshmëria e ndihmës juridike për këto grupe të cenueshme vihet në rrezik, duke çuar në mangësi në ofrimin e shërbimit dhe mbështetje të pamjaftueshme për ata që kanë më shumë nevojë.

“Ka nevojë të menjëhershme për seanca gjithëpërfshirëse trajtimi që trajtojnë mënyrën e punës me kategoritë e ndryshme të veçanta dhe grupet e cenueshme. Secili grup ka nevojë për trajtim të personalizuar dhe ndjeshmëri më të madhe nga ana e profesionistëve në sistem.”

-PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS-

Trajnimi i specializuar për gjyqtarët Ka gjithashtu qartësisht nevojë edhe për trajnim të specializuar për gjyqtarët e përfshirë në ofrimin e ndihmës juridike. Pavarësisht se kjo nevojë është evidentuar, shumë gjyqtarë nuk janë trajnuar ende lidhur me të. Organizimi i programeve të trajnimit për gjyqtarët do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e mbështetjes për individët që kërkojnë ndihmë juridike, duke i pajisur gjyqtarët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për trajtimin në mënyrë efektive të kompleksitetit të ofrimit të ndihmës juridike.

3.3.4 Cilësia e bashkërendimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve

Bashkëpunimi i efektshëm ndërmjet institucioneve të ndryshme, përfshirë ato të qeverisjes vendore, gjykatat dhe shërbimet sociale, është kritik për përmirësimin e qasjes në ndihmë juridike. Megjithatë, mekanizmat e bashkërendimit dhe referimit kanë mangësi të dukshme të cilat duhen trajtuar me qëllim sigurimin e ofrimit të shërbimit gjithëpërfshirës.

Mangësitë në shkëmbimet profesionale Shkëmbimet profesionale dhe mësimi i ndërsjellë ndërmjet ofruesve të ndihmës juridike dhe palëve të tjera të interesit ndërlikohen nga mungesa e konsiderueshme e veprimtarive mes tyre, veçanërisht sa i përket strategjive për trajtimin e rasteve më të ndërlikuara. Këto mangësi pengojnë zhvillimin e qasjeve kohezive dhe të efektshme për ofrimin e ndihmës juridike.

“Niveli i bashkëpunimit midis ofruesve të ndihmës juridike dhe institucioneve të tjera publike në nivel qendror dhe vendor mund të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e shërbimeve të ndihmës juridike.”

-OFRUES I NDIHMËS JURIDIKE -

Sfida në angazhimin me institucionet publike Sfidat në angazhimin me disa institucione publike çojnë në mungesë përfshirjeje dhe njohjeje të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e ndihmës juridike. Vështirësitë në referimin e rasteve dhe mungesa e komunikimit dhe transparencës lidhur me OJF-të e autorizuar krijojnë pengesa në krijimin e partneriteteve më të gjera.

Bashkëpunimi ekzistues. Pavarësisht këtyre vështirësive, ofruesit e ndihmës juridike konfirmuan bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet qendrave të ndihmës juridike dhe organeve të ndryshme në nivel vendor si policisë, bashkisë, Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për Rastet e Dhunës në Familje, gjykatës dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Këto organe i referojnë shpesh qytetarët tek Qendrat e Ndihmës Juridike.

Nevoja për bashkëpunim të shtuar. Është identifikuar nevoja për përf forcimin e bashkëpunimit me organe të tjera si Zyrat Vendore të Punësimit dhe Zyrat Vendore të Kadastrës. Nxitja dhe përf forcimi i këtij bashkëpunimi është thelbësor për përmirësimin e cilësisë në përgjithësi dhe qasjen në shërbimet e ndihmës juridike.

Bazuar në këto gjetje, është e qartë se përf forcimi i bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve është kritik për përmirësimin e përshtatshmërisë së shërbimeve të ndihmës juridike.

3.3.5 Sigurimi i cilësisë

Sistemi i vlerësimit të cilësisë. Parimet e cilësisë, efikasitetit dhe kostos efektive udhëheqin ofrimin e ndihmës juridike. Sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (DNJF) vë në funksion një sistem për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të ndihmës juridike dhe mbikëqyr në mënyrë të përvitshme standardet e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore të ofruara nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët. Ky sistem i vlerësimit të cilësisë bazohet në tregues cilësorë dhe sasiorë të miratuar nga Ministria e Drejtësisë sipas metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike falas. Megjithatë, mungojnë treguesit e kushtuar veçanërisht cilësisë së shërbimit, dhe treguesit aktualë paraqesin vështirësi lidhur me monitorimin. Ka një nevojë urgjente për një mjet të avancuar monitorimi për të përmirësuar efektivitetin e procesit të vlerësimit të cilësisë.

Struktura e monitorimit. Një sfidë e rëndësishme është se struktura e monitorimit për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës ligjore në Drejtorinë e Ndhmës Juridike përbëhet vetëm nga dy specialistë. Këta specialistë janë përgjegjës për monitorimin dhe sigurimin e përmbushjes së standardeve nga ana e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore dhe nga njëzet qendrat që ofrojnë ndihmë juridike parësore. Kapacitetet monitoruese të Drejtorisë së Ndhmës Juridike kanë nevojë të shtohen. Rritja e numrit të specialistëve do të përmirësonte ndjeshëm mbikëqyrjen dhe cilësinë e këtyre shërbimeve.

Mendimi dhe vlerësimi i qytetarëve. Asnjëra prej qendrave nuk ka marrë ende ankesa nga individë lidhur me shërbimet e ofruara. Megjithatë, asnjë prej tyre nuk ka shpërndarë formularë vlerësimi që mund të plotësohen nga individët pas përfundimit të shërbimit. Përdorimi i këtyre formularëve do të siguronte sugjerime me vlerë për shërbimet e ofruara, duke i ndihmuar qendrat dhe Drejtorinë me identifikimin e elementeve që kërkojnë përmirësim dhe për të kuptuar vështirësitë dhe pengesat që hasin qytetarët.

Mbledhja manuale e informacionit. Monitorimi dhe raportimi në kuadrin e ndihmës juridike përballen me vështirësi në sajë të mbledhjes manuale të informacionit nga ana e qendrave të ndihmës juridike. Ky proces pa efikasitet pengon monitorimin e efektshëm dhe vështirëson përpilimin e statistikave të sakta dhe prodhimin e raporteve vjetore gjithëpërfshirëse. Për më tepër, duhet të vihen në zbatim mekanizma më të sofistikuar të vlerësimit të ndikimit me qëllim vlerësimin e efektshmërisë së shërbimeve të ndihmës juridike. Vlerësimi i përshtatshëm lehtëson identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe siguron efektshmërinë e ndërhyrjeve.

“Monitorimi i qendrave në zonat e thella është i vështirë. Informacioni mbledhet manualisht nga qendrat. Është nxjerrë një urdhër i Ministrit të Drejtësisë që përcakton raportimin mujor të çështjeve.”

-DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS-

Mospërputhjet në raportim Organizatat jofitimprurëse i raportojnë DNJF-së sipas pikës 3 të Udhëzimit Nr. 1 datë 8 mars 2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit” të Ministrit të Drejtësisë. Ky udhëzim përcakton se çdo ofrues i ndihmës juridike të garantuar nga shteti dorëzon të dhëna mujore lidhur me aplikimet dhe vetëdeklarimet nga individët që kërkojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti nga Drejtoria.

OJF-të e autorizuar kanë ngritur shqetësimin se raportet e tyre drejtuar Drejtorisë duhet të përfshijnë rastet e këshilluara ose trajtuara përmes telefonit apo internetit. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Drejtësisë, organizatat duhet të mbajnë regjistra dhe dokumentacion të plotë vetëm për rastet e trajtuara me prani fizike. Si pasojë, numri i rasteve të raportuara është më i ulët se numri i rasteve faktike të ndihmuara nga OJF-të. Kjo mospërputhje është gjithashtu e qartë edhe në raportet statistikore të hartuara nga Drejtoria, të cilët nuk përfshijnë rastet e ndihmës juridike të raportuara përmes platformës “juristionline” dhe Numrit Pa Pagesë.

Me qëllim trajtimin e këtyre çështjeve, udhëzimet e raportimit duhet të ndryshohen dhe të kërkojnë përfshirjen e të gjitha llojeve të rasteve. Ky ndryshim do të siguronte paraqitje më të saktë të veprimtarive të OJF-ve dhe do të përmirësonte tërësinë e raporteve statistikore.



PJESA IV
**PËRMBLEDHJE E
GJETJEVE KYÇE**

4. Përmbledhje e gjetjeve kyçe

Ky seksion paraqet gjetjet kryesore të vlerësimit të qasjes në shërbimet e ndihmës juridike në Shqipëri. Rezultatet e vlerësimit theksuan ndikimin e rëndësishëm të miratimit të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” (Ligji për NJF-në) mbi përmirësimin e efektshmërisë dhe mbulimit të shërbimeve të ndihmës juridike që prej vitit 2017. Ligji për NJF-në shtoi numrin e kategorive të përfituesve që kualifikohen për ndihmë juridike falas dhe përcaktoi mekanizma që sigurojnë qasje me të efektshme në sistemin e drejtësisë për individët në përgjithësi, dhe individët e cenueshëm në veçanti. Vlen të theksohet se viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, të miturit, viktimat e diskriminimit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike u përfshinë tek përfituesit që kualifikohen.

Për më tepër, hapja e Qendrave të Ndhmës Juridike Falas që prej vitit 2019 ka përmirësuar qasjen në shërbime juridike falas. Numri i qendrave është rritur nga tetë në vitin 2021 në njëzet të tilla në vitin 2023. Shërbimet e ofruara nga qendrat e ndihmës juridike falas plotësohen nga shërbimet e ofruara nga OJF-të e autorizuar dhe klinikat ligjore. Deri në fund të vitit 2023, Ministria e Drejtësisë kishte autorizuar 15 OJF dhe 12 klinika ligjore për ofrimin e këtyre shërbimeve në qarqe të ndryshme. Përveç kontributit thelbësor të OJF-ve në kuadër të ndihmës juridike parësore, partneriteti i strukturuar ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë fuqizon më tej kuadrin e ndihmës juridike dytësore. Si rezultat i këtij partneriteti, numri i avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore është rritur ndjeshëm nga 23 në vitin 2017 në 177 në vitin 2024, duke shënuar rritje thelbësore të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve juridike.

Gjatë periudhës 2019-2023, sistemi i ofrimit të ndihmës juridike në Shqipëri regjistroi rritje të konsiderueshme të numrit të individëve që përfituan nga shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, me numrin e çështjeve që u rrit nga 23 çështje të ndihmës juridike parësore dhe 44 të ndihmës juridike dytësore në vitin 2019, në 26,991 përfitues të ndihmës parësore dhe 2,833 vendime gjyqësore në vitin 2023. Pandemia e COVID-19 gjithashtu rezultoi në krijimin e platformës digjitale të ndihmës juridike www.juristionline.al dhe hapjen e linjës telefonike pa pagesë 08001010, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së qasjes në shërbime edhe gjatë krizës shëndetësore.

Megjithatë, rezultatet e kërimit tregojnë se, pavarësisht progresit në ngritjen e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe zgjerimit të shërbimeve, ka ende vështirësi dhe fusha për përmirësim. Seksionet në vijim përmbledhin disa prej vështirësive të identifikuar lidhur me qasjen në ndihmë juridike, ofrimin dhe efektshmërinë e saj, të cilat nëse trajtohen do të përmirësonin qasjen në drejtësi për qytetarët në përgjithësi dhe për grupet e cenueshme në veçanti.

4.1. Besimi, ndërgjegjësimi dhe qasja

Përmirësimi i besimit të qytetarëve dhe garantimi i një sistemi gjyqësor transparent dhe të aksesueshëm, konsiderohen si elemente thelbësore për lehtësimin e qasjes në drejtësi, veçanërisht për grupet e cenueshme. Sipas anketës kombëtare të familjeve, 68% e të anketuarve në rang kombëtar besojnë se sistemi i drejtësisë në Shqipëri mbron të drejtat e tyre. Po ashtu, më shumë se 75% e atyre që kanë pasur përvojë me sistemin gjyqësor kohët e fundit besojnë se janë trajtuar me drejtësi në gjykatë. Megjithatë, individët nga zonat e thella dhe rurale, pakicat, të papunët dhe personat me aftësi të kufizuara raportojnë nivel më të ulët besimi në sistemin e drejtësisë. Një arsye që çon drejt këtij rezultati janë vështirësitë që këta individë hasin në ndërveprimet e tyre me sistemin e drejtësisë. Në të njëjtën kohë, edhe besimi në institucionet e gjyqësorit mund të ndikohet nga proceset e gjata dhe ngarkesa e shtuar e gjyqtarëve. Procesi i verifikimit të kërkesave për ndihmë juridike dytësore rrit ngarkesën e gjyqtarëve dhe të sistemit gjyqësor. Për shembull, vetëm Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë pret rreth 200 deri 300 kërkesa në vit. Për më tepër, informacioni i kufizuar dhe me raste i ndërlikuar për përftimin e ndihmës juridike i shkurajon individët nga të kërkuarit e ndihmës juridike falas dhe i shtyn ata t'i zgjidhin vetë çështjet e tyre.

Me qëllim trajtimin e këtyre vështirësive, Drejtoria e NJF-së ka shtuar përpjekjet për informimin e qytetarëve lidhur me shërbimet e disponueshme të ndihmës juridike përmes veprimtarive të ndryshme ndërgjegjësuere të planifikuara çdo vit. Gjatë periudhës 2020 - 2023, Drejtoria e NJF-së ka organizuar më shumë se 1000 aktivitete ndërgjegjësuere në të gjitha bashkitë e vendit. Për më tepër, gjatë të njëjtës periudhë janë nënshkruar 37 marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme në nivel qendror dhe vendor të cilat përqendrohen në ndërgjegjësimin e qytetarëve për shërbimet e ndihmës juridike. Vlen gjithashtu të theksohet se aktivitetet ndërgjegjësuere janë organizuar në nivel rajonal nga qendrat e NJF-së. Pavarësisht përpjekjeve të shtuara të Drejtorisë së NJF-së, njohuritë e qytetarëve mbi ndihmën juridike mbeten të kufizuara, sidomos te grupet e cenueshme, si gratë, vajzat dhe banorët e zonave të thella dhe rurale. Sipas të dhënave të anketës kombëtare të familjeve, vetëm 29% e të anketuarve janë në dijeni të shërbimeve të ndihmës juridike falas. Ndërgjegjësimi është më i lartë tek banorët e zonave urbane dhe individët me nivel arsimor më të lartë. Kjo gjetje thekson nevojën e zgjerimit të veprimtarive ndërgjegjësuere në zonat e thella dhe ato rurale, duke synuar individët me nivel arsimor më të ulët. Në këto raste, shumica e individëve nga grupet e cenueshme kërkojnë fillimisht ndihmë nga OJF-të, qasja tek të cilat është më e thjeshtë dhe të cilat janë të specializuara në punën me këto grupe. Vështirësia e njohurive të kufizuara vlen gjithashtu edhe për ofruesit e shërbimit. Gjetjet e studimit tregojnë se pavarësisht ndërgjegjësimit të shtuar të palëve kyçe të interesit si gjyqtarët, avokatët, autoritetet vendore, policia dhe prokurorët, ka ende nevojë që njohuritë e tyre për ofrimin e shërbimit të përmirësohen. Përpjekjet për përhapjen e informacionit si shpërndarja e fletëpalosjeve ose posterave në institucione janë për t'u vlerësuar, por nuk janë të mjaftueshme, sepse ka nevojë për informacion më të synuar

drejtuar kategorive të veçanta të synuara nga Ligji për NJF-në.

Qytetarët që morën pjesë në këtë vlerësim besojnë se shërbimet juridike dhe zgjidhja e çështjeve me avokatë privatë janë më të shpejta dhe kanë cilësi më të mirë krahasuar me ato që ofrohen nga avokatët e ndihmës juridike falas. Ky perceptim thekson nevojën e rritjes së besimit të qytetarëve në sistemin e ndihmës juridike falas, veçanërisht me qëllim lehtësimin e pozitës së grupeve të cënueshme dhe përdorimin e shërbimeve juridike falas nga ana e tyre.

Përfshirja dhe qasja vijnë të jenë sfida në sistemin e ndihmës juridike. Kategoritë e cënueshme si viktimat e dhunës në familje, komunitetet rome dhe egjiptiane, komuniteti LGBTQI+ dhe të moshuarit përballen me pengesa të veçanta, përfshirë pengesat ekonomike ose proceset burokratike që lidhen kryesisht me vërtetimin e situatës së tyre përmes dokumentacionit shoqëruar. Personat me vështirës në dëgjim përballen me vështirësi të veçanta për shkak të problemeve me komunikimin dhe mungesën e interpretëve në qendrat e ndihmës juridike falas, ndërsa informacioni dhe shërbimet nuk janë përshtatur ende për personat me vështirësi në shikim. Të moshuarit përballen me vështirësi për shkak të mungesës së qasjes në teknologji, në internet, dhe mungesës së njohurive digjitale, çka pengojnë përdorimin e shërbimeve elektronike, si ato përmes platformës e-Albania apo të ndihmës juridike elektronike. Viktimat e dhunës në familje përballen me pengesa për shkak të kërkesave ligjore për bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës që vërteton statusin e tyre formularit të vetëdeklarimit. Kjo kërkesë penalizon një numër të madh grash dhe vajzash të cilat megjithëse janë viktimat *de facto* të dhunës në familje nuk kanë marrë ende urdhër mbrojtjeje në momentin e aplikimit për ndihmë juridike. Për më tepër, procesi i verifikimit të urdhrave të mbrojtjes shpesh vonon ofrimin e ndihmës, që i shtyn viktimat e dhunës në familje të mbështeten kryesisht tek OJF-të. E njëjta vështirësi është qartësisht e dukshme sa i përket edhe ndihmës juridike për viktimat e diskriminimit. Në këto raste, kuadri ligjor i kërkon viktimës së diskriminimit të vërtetojë statusin e vet përmes një vendimi të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke krijuar kështu pengesë të konsiderueshme ligjore. Po ashtu, komuniteti LGBTQI+ përballen me pengesa për shkak të paragjykitimit dhe stereotipizimit.

Në këtë kontekst, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat që hasen veçanërisht nga kategoritë e cënueshme dhe garantuar qasje së barabartë dhe gjithëpërfshirëse në drejtësi, nevojiten shërbime të synuara dhe protokolle të veçanta.

4.2. Kufizimet e Burimeve Njerëzore dhe Financiare

Një prej vështirësive në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në Shqipëri lidhet me burimet e kufizuara njerëzore. Shumica e qendrave të ndihmës juridike funksionojnë me vetëm një punonjës, çka ndikon aftësinë e qendrave të NJF-së për të administruar

ngarkesën dhe kufizon kapacitetin e tyre për të organizuar fushata ndërgjegjësimi. Në mënyrë të ngjashme, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vetëm dy punonjës përgjegjës për monitorimin e të 20 qendrave në mbarë vendin, çka mund të krijojë vështirësi lidhur me mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve të NJF-së. Pavarësisht shtrirjes së shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas, mungesa e qendrave në bashkitë e tjera ndikon qasjen në shërbim, duke krijuar vështirësi për qytetarët në marrjen e ndihmës juridike në kohë.

Vështirësitë me burimet njerëzore ndërthuren më tej me kufizimet financiare, të cilat ndikojnë ndjeshëm mbi qasjen dhe cilësinë e shërbimeve të ndihmës juridike në Shqipëri. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shërbimet e NJF-së, buxheti për ndihmën juridike falas është ende i pamjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe cilësore. Sigurimi i burimeve të përshtatshme financiare për trajtimin e nevojave të të gjitha kategorive është thelbësor për përmirësimin e efektshmërisë së sistemit të ndihmës juridike.

4.3. Kapacitetet dhe Sfidat Burokratike dhe Procedurale

Vlerësimi tregoi se të gjithë ofruesit e NJF-së kanë përfunduar trajnim të specializuar të ofruar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Për më tepër, ata kanë marrë pjesë në trajnimin e vazhduar të organizuar nga ASPA dhe Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me donatorë të tjerë. Megjithatë, ka ende nevojë për trajnim më të specializuar të përshtatur për kategoritë e përfituesve të përcaktuara në ligj. Kjo nevojë është veçanërisht domethënëse për avokatët, gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë, të cilët në disa raste nuk kanë ekspertizë në fusha të veçanta të së drejtës, sidomos në trajtimin e rasteve që përfshijnë grupet e cënueshme si viktimat e dhunës në familje, trafikimit, të miturit në konflikt me ligjin, dhe fëmijët. Mungesa e trajnimit të specializuar ndikon aftësinë për të trajtuar çështjet e këtyre individëve me ndjeshmërinë e duhur dhe në përputhje me nevojat e tyre të veçanta.

Përveç nevojës për trajnim, ofrimi i ndihmës juridike ndërlikohet më tej nga vështirësitë aktuale burokratike që lidhen me procesin e aplikimit për NJF. Procesi i aplikimit për të përfituar ndihmë juridike është burokratik dhe i vështirë, me kërkesa të ndërlikuara dokumentacioni, që janë të vështira për t'u përmbushur, sidomos nga grupet e cënueshme dhe personat me mundësi të kufizuara ekonomike. Individët me të ardhura të ulëta përballen me pengesa kur u kërkohet të vërtetojnë statusin e tyre ekonomik, për shkak të kërkesave të shumta për dokumentacion mbështetës. Vërtetimi i të ardhurave për të gjithë pjesëtarët e familjes nuk është i thjeshtë, veçanërisht kur ata jetojnë jashtë vendit ose nuk janë të gatshëm të sigurojnë dokumentacionin e kërkuar. Për më tepër, formularët e ndihmës juridike nuk janë miqësor për përdoruesin dhe shpesh qytetarët kërkojnë ndihmë për plotësimin e tyre. Vështirësia dhe koha e nevojshme për plotësimin e këtyre formularëve mund të shkaktojë vonesa në marrjen e shërbimeve për individët në nevojë.

Këto vështirësi burokratike përkeqësohen nga problemet me për zgjedhjen e avokatëve. Ofrimi i ndihmës juridike dytësore mund të kërkojë deri në një muaj, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme. Gjetjet e vlerësimit theksuan gjithashtu shqetësimet lidhur me paanshmërinë e sistemit të rotacionit që përdoret për caktimin e avokatëve.

Një shqetësim tjetër i ngritur gjatë intervistave ka të bëjë me mbivendosjen ndërmjet sistemit të caktimit të avokatëve në çështje penale të administruar kryesisht nga prokuroria dhe gjykatat, dhe avokatëve të caktuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore falas në kuadër të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Është e rëndësishme që kjo vështirësi të theksohet, sepse të dy mekanizmat synojnë të ofrojnë përfaqësim ligjor të garantuar nga shteti për qytetarët që nuk e përballojnë dot këtë shërbim. Megjithatë, dallimi kryesor qëndron në burimin e financimit: ndërkohë që avokatët e caktuar në çështje penale kompensohen nga buxheti i gjykatës apo prokurorisë, avokatët që ofrojnë shërbime në kuadër të ligjit për NJF-në paguhën nga Ministria e Drejtësisë. Pasojat financiare të kësaj qasjeje janë të konsiderueshme, dhe shërbimet e avokatëve të caktuar nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i kushtojnë gjyqësorit rreth 10 milion Lekë në vit.

4.4. Bashkërendimi dhe Sigurimi i Cilësisë

Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të NJF-së, vlen të theksohet se Drejtoria e NJF-së ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh në nivel qendror dhe vendor për lehtësimin e bashkërendimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe lehtësimin e procesit për qytetarët. Megjithatë, ndonëse ka bashkëpunime të qëndrueshme mes subjekteve të caktuara, nevojitet zgjerimi i partneriteteve me organe të tjera si Zyrat Vendore të Punës dhe Zyrat e Kadastrës.

Referimi në shërbimet juridike është një tjetër element i sistemit të ndihmës juridike në Shqipëri ku hasen vështirësi. Shpesh qytetarët referohen në shërbimet juridike nga policia, punonjësit e qeverisjes vendore, prokuroria dhe gjykatat, ndërkohë që i zakonshëm është edhe vetëreferimi. Sipas sondazhit përmes internetit me palët e interesit të ndihmës juridike, punonjësit socialë dhe qendrat e mbështetjes dhe kujdesit shoqëror konsiderohen si burime parësore referimi. Të intervistuarit janë të mendimit se pikat e kontaktit në qendrat e NJF-s dhe ekipet e lëvizshme janë më të përshtatshme për sigurimin e qasjes në shërbimet e ndihmës juridike. Shërbimet e NJF-së nuk janë të integruara mirë me shërbimet e tjera të bashkërenduara në nivel vendor, duke penguar kështu referimet dhe mbështetjen gjithëpërfshirëse. Megjithëse ka disa shembuj pozitivë bashkëpunimi ndërmjet shërbimeve të NJF-së dhe Mekanizmit të Koordinimit për Rastet e Dhunës në Familje, ky bashkëpunim nuk është i përcaktuar në nivel sistemi.

Për më tepër, mungon informacioni i përditësuar për aktorët mbështetës kyçë në çdo bashki/rreth, çka ndikon në ofrimin e shërbimit.


Ka vështirësi të qarta edhe në lidhje me sistemin e raportimit për rastet që përfitojnë nga NJF-ja nga të gjitha kategoritë e ofruesve të shërbimeve të NJF-së. Aktualisht, proceset manuale të mbledhjes së të dhënave pengojnë monitorimin dhe raportimin e efektshëm, duke vështirësuar përpilimin e statistikave të sakta dhe prodhimin e raporteve në kohë reale. Për më tepër, udhëzimet aktuale për raportimin nuk përfshijnë rastet e trajtuara përmes telefonit ose internetit, çka sjell nënraportimin e shërbimeve të ofruara nga qendrat e ndihmës juridike dhe OJF-të. Gjithashtu, ka raste në të cilat OJF-të i ofrojnë ndihmë juridike individëve në nevojë, si viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit, përmes telefonit. Kjo ndihmë ofrohet pa kërkesë zyrtare për ndihmë juridike falas, çka ka ndikim në mundësinë e përfshirjes së këtyre rasteve në raportet mujore që OJF-të i dorëzojnë Ministrisë.

4.5. Kuadri ligjor dhe i politikave

Pavarësisht ndryshimeve novatore dhe ndikimit pozitiv të miratimit të ligjit për NJF-në, zbatimi i tij që prej vitit 2018 ka nxjerrë në pah një sërë vështirësish që nevojiten të trajtohen. Këto vështirësi përfshijnë probleme lidhur me autorizimin dhe financimin e OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike parësore për shkak të kufizimeve që lidhen me pasjen e më shumë se një burimi financimi kur OJF-të ofrojnë shërbime të NJF-së. Për më tepër, procesi i aplikimit për OJF-të që kërkojnë financim nga buxheti i shtetit përmes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas kërkon dorëzimin e dokumentacionit shterues vetëm në formë shkresore, duke kufizuar mundësinë e aplikimit përmes internetit. Rishikimi i kriterëve të kualifikimit për NJF është gjithashtu element i rëndësishëm, veçanërisht sa i përket kufirit të të ardhurave të ulëta. Duhet të rivlerësohen kufijtë e të ardhurave dhe pasurisë, për të garantuar që jo vetëm përfituesit e ndihmës ekonomike, por edhe individët me të ardhura të ulëta të kualifikohen sipas ligjit. Për më tepër, është e nevojshme të rishikohen kriteret për qytetarët romë dhe egjiptianë, duke i përfshirë ata si kategori e veçantë e kualifikuar për ndihmë juridike falas.

Si përfundim, pavarësisht progresit domethënës të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në Shqipëri, sistemi përballet ende me vështirësi të konsiderueshme që pengojnë qasjen dhe efektshmërinë e shërbimeve. Trajtimi i këtyre vështirësive ka rëndësi kritike për garantimin e mbështetjes juridike të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët, sidomos për grupet e cënueshme.

PJESA V
REKOMANDIMET



5. Rekomandime

5.1. Besimi, ndërgjegjësimi dhe qasja

Rritja e besimit të publikut në shërbimet e ndihmës juridike. Përmirësimi i besimit në shërbimet e ndihmës juridike falas ka rëndësi kritike dhe duhet të arrihet përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimit. Ndaj, përpjekje për të treguar cilësinë dhe efektshmërinë e këtyre shërbimeve janë të nevojshme, mundësisht përmes historive të suksesit, dëshmive dhe raportimit transparent të rezultateve. Përmirësimi i perceptimit të besueshmërisë së ofruesve të ndihmës juridike do të shtyjë më shumë individë të kërkojnë këto shërbime.

Trajtimi i pengesave të hasura nga komunitetet e cenueshme. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet pengesave të veçanta të hasura nga komunitetet e cenueshme, si komuniteti rom dhe personat me aftësi të kufizuara. Shërbimet e ndihmës juridike duhet të jenë përfshirëse për personat me aftësi të kufizuara dhe të sigurojnë qasje nga të gjithë. Rekomandohet përshtatja e formularëve dhe dokumentacionit me qëllim që të përdoren lehtësisht nga personat me vështirësi në shikim dhe dëgjim. Nevojitet të hartohen protokolle të veçanta dhe të krijohen shërbime të specializuara për trajtimin e rasteve që përfshijnë grupe të cenueshme. Të gjitha shërbimet e ndihmës juridike duhet të sigurojnë qasje për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë personat me vështirësi në shikim.

Rekomandohet gjithashtu edhe zbatimi i programeve për përmirësimin e njohurive digjitale të të moshuarve dhe grupeve të tjera me qasje të kufizuar në teknologji. Në këtë kuadër duhen ofruar metoda alternative për t'iu qasur shërbimeve të ndihmës juridike për ata që nuk arrijnë të përdorin platformat digjitale. Decentralizimi i proceseve të verifikimit dhe miratimit të kërkesave për ndihmë juridike mund të lehtësonte ngarkesën e gjyqtarëve dhe gjykatave. Këto detyra administrative mund t'i ngarkohen Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Një tjetër rekomandim lidhet me rishikimin e Ligjit për NJF-në me qëllim përfshirjen e komuniteteve rom dhe egjiptiane si kategori të veçanta të kualifikuara për ndihmë juridike falas, pavarësisht të ardhurave apo statusit ekonomik. Thjeshtimi i procesit të dokumentacionit për këto grupe do të lehtësonte qasjen e tyre në shërbimet e ndihmës juridike. Rekomandohet që viktimave të dhunës në familje t'u ofrohet ndihmë juridike e menjëhershme si shërbim emergjence, si dhe të shkurtohet lista e dokumenteve të nevojshme për t'iu garantuar në kohë qasje në drejtësi.

Përmirësimi i vizibilitetit, qasjes dhe mbulimit. Rekomandohet krijimi i një faqeje interneti të posaçme për shërbimet e ndihmës juridike miqësore me përdoruesit, ku ofrohet informacion i hollësishëm rreth qendrave të ndihmës juridike, shërbimeve të

ofruara dhe mënyrës së qasjes në to. Ky informacion në internet duhet të përfshijë mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë, nga ku individët të kenë mundësinë të kërkojnë informacion për shërbimet dhe të marrin udhëzime bazë. Gjithashtu rekomandohet që ky instrument të mund të përdoret nga të gjitha kategoritë e përdoruesve. Ministria e Drejtësisë duhet të përdorë mjete të shumëllojshme komunikimi, në internet dhe me metoda tradicionale, për t'i informuar qytetarët lidhur me disponueshmërinë e shërbimeve të ndihmës juridike. Kjo qasje do të lehtësonte mbulimin e grupeve të cenueshme dhe qytetarëve që jetojnë në zonat e thella duke tejkaluar kështu një sërë pengesash. Disa shembuj përfshijnë linjat telefonike dhe pikat e qasjes në distancë në vendet e frekuentuara nga komunitetet vendase. Zbatimi i përpjekjeve të synuara për mbulimin me shërbime përmes ekipeve të lëvizshme mund të sigurojë mbulim gjithëpërfshirës në zonat ku nuk ka qendra të NJF-së, ndërkohë që i duhet dhënë përparësi veprimtarive integruese që synojnë komunitetet e cenueshme dhe të marginalizuara. Ekipet e lëvizshme mund të ofrojnë shërbime juridike në terren dhe të ndërgjegjësojnë qytetarët rreth shërbimeve të ndihmës juridike. Kjo mund të arrihet nëpërmjet takimeve me komunitetin, njërive informuese të lëvizshme dhe bashkëpunimit me OJF-të lokale për të dhënë informacion dhe për t'u ardhur në ndihmë individëve gjatë përdorimit të shërbimeve.

Gjithashtu rekomandohet zbatimi i fushatave informuese gjithëpërfshirëse duke përdorur platforma të shumëfishta, si radio, televizion, media sociale dhe shtyp për të rritur ndërgjegjësimin rreth disponueshmërisë së shërbimeve të ndihmës juridike. Është e nevojshme të zbatohen fushata ndërgjegjësimi të synuara për të përmirësuar kuptimin rreth shërbimeve të ndihmës juridike falas, veçanërisht te grupet e cenueshme, si gratë, vajzat, banorët e zonave rurale dhe komunitetet e pakicave. Këto veprimtari duhet të bashkërendohen me partnerët vendorë përkatës për të arritur mbulim dhe ndikim maksimal.

Përmirësimi i vizibilitetit të shërbimit. Rekomandohet hartimi dhe shpërndarja e materialeve të qarta informuese që janë miqësore me përdoruesin për shërbimet e ndihmës juridike, kriteret e kualifikimit dhe procedurat e aplikimit. Këto materiale duhet të disponueshme në gjuhë dhe formate të ndryshme, përfshirë breil dhe formate audio, për të mundësuar qasjen e individëve me vështirësi në shikim dhe dëgjim. **Rekomandohet zbatimi i nismave të ndërgjegjësimit publik për të theksuar cilësinë dhe efektshmërinë e shërbimeve të ofruara nga avokatët e ndihmës juridike falas.** Paraqitja e historive dhe dëshmive të suksesit nga përfituesit do të ndihmojë në rritjen e besimit te sistemi.

5.2. Kufizimet e burimeve njerëzore dhe financiare

Shtimi i qendrave të ndihmës juridike dhe punonjësve përkatës. Rritja e numrit të qendrave të ndihmës juridike dhe trajtimi i mbulimit të territorit me shërbime janë elemente thelbësore, veçanërisht në zonat rurale dhe qarqet me shërbime të pamjaftueshme. Rekomandohet planifikimi i burimeve shtesë për të siguruar punësimin

e të paktën dy punonjësve në secilën qendër. Kjo do të rezultonte në cilësi më të lartë shërbimi dhe qasje të përmirësuar në ndihmë juridike për të gjithë qytetarët.

Trajtimi i sfidave operacionale dhe atyre financiare. Nevojitet avokim për rritjen e buxhetit për ndihmën juridike, me qëllim sigurimin e financimit të qëndrueshëm për të gjitha shërbimet e ndihmës juridike, përfshirë ndihmën juridike parësore dhe dytësore, fushatat e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve. Duhet të sigurohen burime të mjaftueshme financiare për mbështetjen e planeve për zgjerimin e shërbimit, përmirësimin e qasjes dhe cilësisë, dhe organizimin e fushatave ndërgjegjëse dhe veprimtarive informale.

Akordimi i fondeve për pajisjen e qendrave të ndihmës juridike dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me më shumë punonjës. Rekomandohet që secila qendër të ketë të paktën dy punonjës me qëllim menaxhimin e efektshëm të ngarkesës dhe zbatimin e veprimtarive të mbulimit. Rekomandohet gjithashtu edhe investimi i qëndrueshëm në zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe ngritje kapacitetesh për ofruesit e ndihmës juridike, me qëllim përmirësimin e ekspertizës dhe efektshmërisë së tyre në trajtimin e rasteve më të ndërlikuara.

Partneritetet me OJF-të me përvojë mund të mbështesin përmirësimin e mbulimit me shërbim. Efikasiteti i këtyre partneriteteve kërkon rishikimin e disa elementeve:

- **Thjeshtimi i procedurave të autorizimit për OJF-të.** Procesi aktual i autorizimit të OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike është tejet i ndërlikuar dhe kërkon burime dhe dokumentacion mbështetës të konsiderueshëm. Ky proces duhet të harmonizohet për të ulur barrën administrative të OJF-ve, duke i lejuar ato të përqendrohen më shumë tek ofrimi i shërbimit. Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht ose të skanuar do të lehtësonte më tej procesin.
- **Shtimi i mbështetjes financiare për organizatat e autorizuar.** Financimi aktual i organizatave të autorizuar nuk është i mjaftueshëm. Rritja e mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit do t'u mundësojë këtyre organizatave të zgjerojnë shërbimet e tyre dhe të mbulojnë një numër më të madh përfituesish. Vetëm një përqindje e vogël e OJF-ve të autorizuar përfitojnë financim nga shteti, çka kufizon aftësinë e tyre për t'u shërbyer me efektshmëri grupeve të cënueshme.
- **Rishikimi i rregulloreve për financimin nga shteti** për t'u mundësuar OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike parësore qasje në burime të shumëfishta financimi. Ky rishikim do t'i mundësonte OJF-ve të sigurojnë mbështetje financiare shtesë nga donatorë të ndryshëm, pa humbur përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit. Ky ndryshim do të siguronte OJF-ve burime të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse të ndihmës juridike, duke përmirësuar kapacitetin e tyre për t'u shërbyer në mënyrë efektive personave në nevojë.

Krahas kësaj, rekomandohet të shfrytëzohet ekspertiza dhe prania e OJF-ve në terren duke i përfshirë në proceset e politikëbërjes dhe zbatimit. Rekomandohet të nxitet bashkëpunimi ndërmjet OJF-ve dhe qendrave të ndihmës juridike me qëllim përmirësimin e mbulimit me dhe efektshmërisë së shërbimeve. Roli thelbësor i OJF-ve në ofrimin e ndihmës juridike komuniteteve të marginalizuara duhet të njihet dhe të mbështetet financiarisht.

Rekomandohet **zbatimi i shtysave për të gjithë ofruesit e ndihmës juridike**, përfshirë avokatët dhe ekspertët, me qëllim motivimin e profesionistëve (p.sh. shpërblim i përshtatshëm për avokatët dhe psikologët). Po ashtu, rekomandohet të rishikohen tarifat për avokatët e ndihmës juridike dytësore, me një fokus të veçantë në diferencimin e tarifave sipas llojit të rastit, pasi disa raste kërkojnë angazhim më të madh.

5.3. Kapacitetet dhe sfidat burokratike dhe procedurale

Ofrimi i zhvillimit të vazhduar profesional për ofruesit e ndihmës juridike dhe stafin gjyqësor. Programet e zhvillimit të vazhduar profesional për ofruesit e ndihmës juridike duhet të përqendrohen te praktikat më të fundit juridike dhe nevojat në ndryshim të popullatave të cënueshme. Është tejet e rëndësishme të zbatohen programe të specializuara trajnimi për ofruesit e ndihmës juridike, gjyqtarët, prokurorët dhe personelin e gjykatave me qëllim përmirësimin e trajtimit të çështjeve dhe ndjeshmërisë së tyre ndaj nevojave të grupeve të cënueshme, si viktimat e dhunës në familje, personat me aftësi të kufizuara, komunitetit LGBTQI+ dhe komunitetet e tjera të cënueshme. Trajnimet duhet të theksojnë ndjeshmërinë, kompetencat kulturore dhe nevojat ligjore të veçanta të këtyre grupeve, për të siguruar mbështetje të drejtë dhe të efektshme.

Për më tepër, avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore duhet të jenë të specializuar për të trajtuar lloje të ndryshme çështjesh, duke krijuar kështu lista avokatësh sipas kualifikimeve dhe specializimit të tyre. Në këtë mënyrë, kur një rast kualifikohet për ndihmë juridike dytësore, për trajtimin e efektshëm të çështjes mund të caktohet një avokat me ekspertizën e përshtatshme. Rekomandohet që institucionet përgjegjëse për administrimin e NJF-së të lehtësojnë përhapjen e praktikave të mira dhe mësimave të marra nga ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike. Kjo nismë do t'i ndihmojë ofruesit të zbatojnë strategji dhe qasje të efektshme, të zbatuara me sukses në bashki/rrethe të ndryshme.

Sigurimi i qasjes në dokumentacion dhe baza të dhënash në internet për gjyqtarët dhe ofruesit e ndihmës juridike do të harmonizojë trajtimin e çështjeve dhe proceset e vendimmarrjes. Mjetet digjitale mund të përshpejtojnë verifikimin e pamundësisë financiare dhe kriterëve të tjera përkatëse, duke e bërë procesin e ndihmës juridike më efikas dhe më të thjeshtë për kërkuesit.

5.4. Bashkërendimi dhe sigurimi i cilësisë

Sa i përket fuqizimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet qeverisjes vendore, gjykatave dhe shërbimeve sociale për përmirësimin e qasjes në ndihmë juridike, rekomandohet përmirësimi i mekanizmave të referimit dhe kanaleve të komunikimit ndërmjet ofruesve të shërbimit me qëllim sigurimin e NJF-së gjithëpërfshirëse dhe trajtimin e efektshëm të rasteve më të ndërlikuara. Rekomandohet nxitja e veprimtarive që lehtësojnë shkëmbimin profesional ndërmjet ofruesve të shërbimeve për të zhvilluar qasje kohezive dhe të efektshme lidhur me ofrimin e ndihmës juridike.

Integrimi i shërbimeve të ndihmës juridike me sistemet e tjera të mbështetjes për të përmirësuar identifikimin dhe referimin në NJF. Përmirësimi i integritetit të shërbimeve të ndihmës juridike me sistemet e tjera të mbështetjes sociale dhe asaj në komunitet do të përmirësojë mbështetjen e përgjithshme që i ofrohet individëve në nevojë. Rekomandohet angazhimi aktiv me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit në nivel vendor, rrjetin ekzistues të shërbimeve të kujdesit shoqëror, dhe partnerë të tjerë vendorë/rajonale, me qëllim përmirësimin e referimit të rasteve dhe bashkërendimin të mbështetjes ndërsektoriale për grupet e cënueshme. Ky element është veçanërisht i rëndësishëm për përmirësimin e qasjes dhe mbulimit të individëve më në nevojë. Bashkërendimi i përmirësuar me njësitë e qeverisjes vendore, shërbimet shoqërore dhe OJF-të mund të lehtësojë mbështetjen më gjithëpërfshirëse, duke trajtuar nevojat e ndryshme të grupeve në nevojë.

Sa i përket përmirësimit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë, rekomandohet shtimi i numrit të specialistëve të ngarkuar me monitorimin e qendrave të ndihmës juridike, me qëllim sigurimin e përmbushjes së standardeve dhe cilësinë e qëndrueshme të shërbimit. Më tej rekomandohet përdorimi i formularëve të vlerësimit që mund të plotësohen nga individët në përfundim të shërbimit, me qëllim dhënien e mendimit për përvojën e tyre. Gjithashtu rekomandohet rishikimi i udhëzimeve për raportimin, me qëllim përfshirjen e të gjitha llojeve të rasteve, përfshirë ato të trajtuara përmes telefonit ose internetit, si dhe të rasteve të ndihmës juridike dytësore të trajtuara nga avokatët e OJF-ve. Këto do të mundësonin përfaqësim më të saktë të numrit të rasteve që kanë marrë ndihmë juridike. Rekomandohet përdorimi i mjeteve digjitale për mbledhjen dhe raportimin më efikas të të dhënave. **Rekomandohet zbatimi i masave për kontrollin e cilësisë** për të siguruar që të gjithë ofruesit e ndihmës juridike përmbushin standarde të larta të profesionalizmit dhe kompetencës. Rekomandohen vlerësimet e rregullta të performancës së avokatëve, si dhe ofrimi i trajnimit shtesë sipas nevojës.

Vlerësimi i kapacitetit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për të menaxhuar një sistem gjithëpërfshirës të ndihmës juridike. Ky vlerësim duhet të shqyrtojë mundësinë për integrimin e sistemit aktual të caktimit të avokatëve për çështjet penale të administruar nga prokuroria dhe gjykata, me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Ky integrim do të ndihmonte përcaktimin e aftësisë së Drejtorisë së NJF-së për të trajtuar çështjet e ndihmës juridike penale dhe civile në një sistem të unifikuar.

Krahas kësaj, vlerësimi duhet të shqyrtojë edhe pasojat financiare, operacionale dhe administrative të këtij integrimi, duke synuar harmonizimin e administrimit dhe financimit të shërbimeve të ndihmës juridike. Integrimi mund të reduktojë barrën financiare mbi buxhetin e gjykatave, të përmirësojë bashkërendimin brenda sistemit juridik, të eliminojë hapat e panevojshëm, si dhe të sigurojë akordimin efikas të burimeve të ndihmës juridike për t'u shërbyer personave më në nevojë.

Transferimi i përgjegjësisë së vlerësimit të kërkesave për ndihmë juridike falas nga gjyqësori te Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas. Ky ndryshim do të ndihmonte në harmonizimin e procesit, duke e bërë atë më efikas dhe duke pakësuar barrën e gjyqësorit. Rekomandohet që Drejtoria e NJF-së të ngarkohet drejtpërsëdrejti me caktimin e avokatëve nga lista e miratuar nga Ministria e Drejtësisë pas vlerësimit të kërkesës në fjalë, duke kursyer kohë dhe kosto. Krahas kësaj, rekomandohet zbatimi i masave të ndërmjetme për rastet ose situatat urgjente jashtë orarit të punës së Drejtorisë, ku gjykata mund t'i kërkojë kërkuar të plotësojë një formular kërkesë paraprake për ndihmë juridike falas, të caktojë provizorisht avokatin dhe t'ia kalojë formularin Drejtorisë së NJF-së për verifikim.

5.5. Kuadri ligjor dhe i politikave

Këshillohet marrja në konsideratë e rishikimit të kërkesave ligjore për të garantuar që individët që përballen me diskriminim të kenë qasje në ndihmë juridike. Rekomandohet ndryshimi i kërkesës aktuale për individët që të marrin një vendim nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi para se të aksesojnë ndihmën juridike. Ky ndryshim duhet t'i lejojë individët që deklarojnë se janë diskriminuar të marrin ndihmë juridike të menjëhershme, ose për të vërtetuar rastin e tyre përpara Komisionerit, ose për të mobilizuar drejtpërsëdrejti gjykatën. Nevojiten qasje të përshtatura dhe përmirësim i përpjekjeve të mbulimit për të siguruar se këto grupe kanë qasje të barabartë në drejtësi. Rekomandohet edhe planifikimi dhe akordimi i fondeve buxhetore të veçanta për grupet e cënueshme, si viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët me qëllim përmbushjen e nevojave të tyre ligjore të veçanta.

Përmirësimi i proceseve të përpilimit të dokumentacionit dhe rishikimi i kriterëve ekonomike për kualifikimin për ndihmë juridike. Kërkuar me të ardhura të pamjaftueshme u duhet të paraqesin prova të forta të të ardhurave, pasurive dhe shpenzimeve të tyre. Megjithatë, shpeshherë gjykatat i mbështesin vendimet e tyre vetëm te të ardhurat dhe pasuritë, duke anashkaluar shpenzimet. Është e nevojshme që kriteret ekonomike të kualifikimit për ndihmë juridike të rishikohen. Kufijtë aktualë të të ardhurave dhe pasurisë përjashtojnë një numër domethënës individësh në nevojë. Vlerësimi më gjithëpërfshirës që merr parasysh shpenzimet, do të siguronte panoramë më të saktë të situatës financiare të kërkuarve dhe kualifikimit të tyre për të përfituar ndihmë juridike.

SHTOJCË

Shpërndarja rajonale e anketës së familjeve

Tabela më poshtë paraqet bashkitë e përzgjedhura për anketën e familjeve.

Gjykata e rrethit gjyqësor	Bashkitë e përfshira	Popullsia	Përqindja e popullsisë	Nr. i intervistave	Raporti urbane-rurale	Nr. i NJPK-ve
Berat	Berat, Dimal, Kuçovë, Skrapar, Polican	229,550	5.22%	63	47%-53%	2-6
Dibër	Dibër, Bulqizë, Mat, Klos	174,232	3.96%	48	29%-71%	2-5
Durrës	Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë	503,077	11.44%	137	64%-36%	5-14
Elbasan	Elbasan, Cerrik, Belsh, Peqin, Gramsh, Librazhd, Prrenjas	447,423	10.17%	122	42%-58%	6-12
Fier	Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër	508,951	11.57%	139	42%-58%	5-14
Gjirokastrë	Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyre, Dropull	148,025	3.36%	40	45%-55%	2-4
Sarandë	Sarandë, Konispol, Finiq, Delvinë	123,249	2.80%	34	57%-43%	1-3
Korçë	Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Devoll, Pogradec	350,179	7.96%	96	41%-59%	3-9
Kukës	Kukës, Has, Tropojë	109,993	2.50%	30	33%-67%	1-3
Lezhë	Lezhë, Mirditë, Kurbin	224,711	5.11%	61	45%-55%	2-6
Shkodër	Shkodër, Vau i Dejës, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë Arrëz	209,710	4.77%	57	46%-54%	2-6
Tiranë	Tiranë, Kamëz, Vorë, Krujë	1,105,587	25.13%	302	76%-24%	10-30
Vlorë	Vlorë, Selenicë, Himarë	264,339	6.01%	72	67%-33%	3-7
Gjithsej		4,399,026	100.00%	1200	55%-45%	44-119

FJALORTH ME TERMA TË SHPESHTË

Përgjatë këtij raporti janë përdorur terma të ndryshëm që mund të kenë kuptim të ndryshëm në varësi të kontekstit në të cilin përdoren. Në kontekstin e këtij raporti,

“**Kërkues**” është personi që aplikon për ndihmë juridike.

“**Dhomë Avokatie**” është organizimi i avokatëve që është përgjegjës për rregullimin e profesionit të avokatit në juridiksionin e mbuluar dhe që i shërben anëtarëve të vet.

“**Ndihmë juridike**” kuptohet në përgjithësi si këshillim juridik, ndihmë juridike dhe/ose përfaqësim në gjykatë për personin të cilit i lind e drejta e përfitimit. Në Shqipëri, ndihmë juridike i referohet shërbimeve juridike dhe shërbimeve të tjera pa pagesë të përcaktuara në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

“**Ofrues i ndihmës juridike**” i referohet çdo personi (juridik apo fizik, me apo pa kualifikime profesionale) të përfshirë në ofrimin e ndihmës juridike, të ofruar me kohë të plotë, të pjesshme, apo rast pas rasti.

“**Me një ndalesë**” është një vend i vetëm ku ofrohen shërbime të ndryshme juridike nga organe publike ose jopublike.

“**Paraligjorë**” janë persona me arsim juridik jouniversitar.

“**Ndihmë juridike parësore**” në përgjithësi është ndihma juridike për mbulimin e kostove që lidhen me informimin, këshillimin juridik fillestar dhe informacionin për ndihmën juridike. Ajo nuk përfshin përfaqësimi në gjykatë. Në Shqipëri, ndihma juridike parësore i referohet: i) ofrimit të informacionit lidhur me sistemin juridik të Republikës së Shqipërisë, aktet ligjore në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të së drejtës dhe metodat e zbatimit dhe ushtrimit të këtyre të drejtave në procese gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, ii) ofrimin e këshillimit, iii) këshillat mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe mënyrat alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, iv) ofrimin e ndihmës në hartimit dhe nxjerrjen e dokumentacionit për vënien në lëvizje të administratës publike ose kërkimin e ndihmës juridike dytësore, v) përfaqësimin përpara organeve administrative, dhe vi) ofrimin e të gjitha formave të tjera të mbështetjes juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

“**Qendër e ndihmës juridike parësore**” është shërbim publik i ndihmës juridike që ofron shërbime të ndihmës juridike parësore. Ajo organizohet si ‘njësi e ofrimit të shërbimit drejtpërdrejt publikut’.

“**Asistencë juridike pro bono (pa pagesë)**” është këshillimi, ndihma dhe përfaqësimi ligjor nga ana e profesionistëve të fushës së drejtësisë dhe të tjerëve, përfshirë organet publike dhe jopublike. Ky term nuk duhet të ngatërrohet me “ndihmën juridike falas”. “Ndihma juridike falas” është ofrimi i shërbimeve juridike një individi që nuk është në gjendje të paguajë për shërbimin. Profesionistët që ofrojnë këtë shërbim paguhen nga shteti për punën që bëjnë. Shërbimet Pro Bono “pa pagesë” i referohen ofrimit të shërbimeve juridike pa pagesë individëve që nuk janë në gjendje të paguajnë për to. Profesionistët që ofrojnë këto shërbime veprojnë në interesin publik, që do të thotë se ata nuk paguhen për punën që bëjnë.⁵²

“**Ndihmë juridike dytësore**” në përgjithësi nënkupton ndihmën juridike për mbulimin e kostove që lidhen me përfaqësimin në gjykatë. Në Shqipëri, ndihma juridike dytësore i referohet shërbimit juridik që ofrohet për hartimin e akteve juridike të nevojshme për vënien në lëvizje të gjykatës, ofrimit të këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes në gjykatë për çështje administrative dhe civile, si dhe për çështje penale në të cilat nuk gjen zbatim mbrojtja e detyrueshme sipas legjislacionit të procedurës penale.

“**Klinikë ligjore universitare**” në përgjithësi nënkupton ofrimin e shërbimeve juridike (faktike ose të simuluar) që përfshijnë pjesëmarrjen e studentëve dhe mundësisht individëve të tjerë që veprojnë nën mbikëqyrje profesionale kur është e nevojshme.⁵³ Në Shqipëri, klinikë ligjore universitare i referohet njësisë organizative në institucionet e arsimit të lartë, të organizuara dhe që funksionojnë në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, dhe që ofrojnë ndihmë juridike parësore me qëllim jofitimprurës, në përputhje me përcaktimet e statutit të institucionit të arsimit të lartë.

“**Viktimë**” nënkupton individin që ka pësuar dëm vetëm ose kolektivisht, përfshirë dëmin fizik ose mendor, vuajtjen emocionale, humbjen ekonomike ose dëmtimin përmbajtësor të të drejtave të tyre themelore, përmes veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë shkelje të legjislacionit penal.⁵⁴

“**Grup i cenueshëm**” i referohet grupeve të veçanta të individëve të cilët marginalizohen si pasojë e praktikave negative sociale, ekonomike dhe kulturore të pranishme në shoqëri.⁵⁵

52. Shihni për shembull, Shoqëria e të Drejtës në Angli dhe Uells (2019) “Hyrje në shërbimet pa pagesë”. *The Law Society of England and Wales*, September 10. <https://www.lawsociety.org.uk/topics/pro-bono/introduction-to-pro-bono>.

53. Linden Thomas dhe Nick Johnson (2020) *The clinical legal education handbook* (London, University of London Press). fq. 7.

54. Deklarata e OKB-së për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Detyrës, UN Doc A/RES/40/34 (29 nëntor 1985) parimi 1.

55. OHCHR (2021) “Non-discrimination: groups in vulnerable situations” [Mosdiskriminimi: grupet në situata të cenueshme]. OHCHR. <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Health/Pages/GroupsInVulnerableSituations.aspx>; OKB (2023) „Vulnerable Groups: [Grupet e Cenueshme] Who are They?“ [Kush janë?] UN. <https://www.un.org/en/fight-racism/vulnerable-groups>.

REFERENCAT

- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2018) *Sigurimi i Qasjes në Drejtësi për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kuadrin Ligjor Shqiptar: Raport Monitorimi* (Tiranë, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara).
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit (2019) *Studimi Mbi Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti dhe Respektimin e Standardit të Aksesit në Drejtësi të Grupeve Vulnerabël* (Tirana, Komiteti Shqiptar i Helsinkit).
- Civil Rights Defenders (2018). *The Wall of Antigypsyism: Roma and Egyptians in Albania* (Stockholm, Civil Rights Defenders).
- Këshilli i Evropës (2021) *The Efficiency and the Effectiveness of Legal Aid Schemes in the Areas of Civil and Administrative Law: Guidelines and Explanatory Memorandum* (Strasburg, Këshilli i Evropës).
- --- (2023) ‘Albania’. *Council of Europe*. <https://www.coe.int/en/web/portal/albania>.
- --- Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (2020) ‘Dynamic database of European judicial systems: Albania’. <https://public.tableau.com/app/profile/cepej/viz/OverviewEN/Overview>.
- Komisioni Evropian (2023) ‘Screening Report Albania’. *European Commission*. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en.
- Këshilli Evropian (2023) ‘EU Enlargement Policy: Albania’. *European Council*. <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/enlargement/albania/>.
- Law Society of England and Wales (2019) ‘Introduction to pro bono’. *The Law Society of England and Wales*, September 10. <https://www.lawsociety.org.uk/topics/pro-bono/introduction-to-pro-bono>.
- Lemke Stefanie (2024) ‘Equal Access to Justice for Women: Is Legal Technology the Answer?’ in: Anne Wagner and Angela Condello (eds.), *(In)Visible Signs of Gender-Based Violence* (Cham, Springer). [pritet në 2024]
- --- (2023) The Role of Legal Technology to Strengthen the Access to Justice for Disadvantaged Groups: An Overview of Best Practices from Asia and Europe, in: Association for Monitoring Equal Rights (ed.), *International Conference on Access to Justice: Strengthening Access to Justice for Disadvantaged Groups* (Brussels and Ankara, European Commission and Association for Monitoring Equal Rights).
- Linden Thomas and Nick Johnson (2020) *The clinical legal education handbook* (London, University of London Press).
- Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë, Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- Minority Rights Group International (2022) *World Directory of Minorities and Indigenous Citizens: Albania*. <https://minorityrights.org/country/albania/>

- Fondacioni Së Bashku (2024) *Raport Alternativ për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara* (Tiranë, Fondacioni Së Bashku).
- Kombet e Bashkuara (2022) 'Sustainable Development Goals: Knowledge Platform: Albania'. *Kombet e Bashkuara*. <https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/albania>.
- --- (2023) 'Vulnerable Groups: Who are They?'. *United Nations*. <https://www.un.org/en/fight-racism/vulnerable-groups>.
- --- Committee the Elimination of All Forms of Discrimination (2023) *Concluding observations on the fifth periodic report of Albania* (Gjenevë, Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit).
- --- Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power, UN Doc A/RES/40/34 (29 nëntor 1985).
- --- Development Programme (2017) *Survey on Access to Justice in Albania* (Tiranë, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara),
- --- General Assembly (2015) *Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development*, 21 tetor 2015, A/RES/70/1.
- --- Human Rights Office of the High Commissioner (2021) 'Non-discrimination: groups in vulnerable situations'. *Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut*. <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Health/Pages/GroupsInVulnerableSituations.aspx>.
- --- International Principles and Guidelines on Access to Justice for Persons with Disabilities (2020).
- --- Zyra për Drogën dhe Krimin (2019) *UN principles and guidelines on access to legal aid in criminal justice systems* (Vienë, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin).
- --- Fondi për Popullsinë (2023) 'World Population Dashboard: Shqipëri'. *UNFPA*. <https://www.unfpa.org/data/world-population/AL>.
- --- Relatori i Veçantë i OKB-së për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve (2013) 'Legal aid, a right in itself'. *Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut*. <https://www.ohchr.org/en/press-releases/2013/05/legal-aid-right-itself-un-special-rapporteur>.
- Projekti i Drejtësisë Botërore (2023) *Rule of Law Index: Albania*, <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/factors/2023/Albania/Civil%20Justice/>.

